
RAPORT VJETOR

2020

PARATHËNIE.....	4
MISIONI	5
OBJEKTIVA	6
I. PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR	8
1. Akte nënligjore të miratuara	8
2. Akte nënligjore në proces miratimi	9
3. Procesi i përafrimit të legjislacionit në kuadër të integritimit evropian	10
4. Përgatitja, planifikimi dhe përballimi i fatkeqësive natyrore dhe njerëzore.....	10
II. PROGRAME SHTETËRORE DHE NDËRKOMBËTARE NË TRASHËGIMI KULTURORE	11
1. Programet e procesit të rindërtimit.....	12
2. Programi EU4CULTURE	13
3. Programi Fondi i Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore (AFCP)	14
4. Programi për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik - PZHIUT	15
5. Programi “Itinerari kulturor - Gjurmet fishtiane”	21
6. Programi "Edukimi mbi dhe përmes kulturës"	22
7. Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020	23
8. Programi Balkan Mediterranean 2014-2020	23
9. Programi “IPA II 2018 Action Programme for Albania - EU Economic Development – Tourism – led local economic development with focus on cultural heritage“	24
III. PARTNERITETE DHE MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI	25
1. Bashkëpunimi me UNESCO-n gjatë vitit 2020	25
2. Bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, AADF.....	26
3. Memorandum Mirëkuptimi me CHwB	29
4. Bashkëpunimi me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA).....	29
5. Protokoll Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Turqisë	30
6. Bashkëpunimi me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (KOASH)	31
7. Bashkëpunimi me Trans Adriatic Pipeline AG (TAP)	31
8. Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Planifimit të Territorit (AKPT).....	31
9. Bashkëpunimi me Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës – FAU	32
IV. AKTIVITETI I IKTK-SË NË PËRPUTHJE ME PLANIN E PUNËS 2020	33
1. Projekte në kuadër të Programit të Rindërtimit.....	33
2. Projekte me Partnerin Cultural Heritage without Borders (CHwB)	38
3. Projekte me Fonde të BE-së nëpërmjet instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit IPA ku IKTK merr pjesë në cilësinë e Partnerit në Projekte	39

4.	Projekte të ndjekura në partneritet me TIKA	45
5.	Projekte me Partnerin Kisha Orthodokse Autoqefale e Shqipërisë (KOASH)	46
6.	Projekte në kuadër të programit “Itinerari kulturor- Gjurmët fishtiane”	47
7.	Hartim projektesh restaurimi nga IKTK	47
8.	Ndërhyrje konservuese – restauruese të realizuara në laboratorin e IKTK-së dhe në terren	51
9.	Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të konservimit dhe restaurimit të ndjekura nga IKTK-ja	51
10.	Hulumtime arkeologjike	54
11.	Baza e të dhënave dhe përditësimi mbi pasuritë kulturore	56
a)	Përditësimi i Listës Zyrtare të Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore për vitin 2020	56
b)	Platforma digjitale WebGIS	59
V.	KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE (KKTKM)	66
VI.	SHËRBIMET TË OFRUARA NGA IKTK-ja	67
1.	Shërbime online	67
2.	Sporteli Unik i IKTK-së	67
3.	Sistemi e-Lejet	69
4.	Protokolli i IKTK-së	70
5.	Arkiva e IKTK-së	70
6.	Biblioteka e IKTK-së	70
VII.	PROGRAME PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE PROFESIONALE	72
1.	Trajnime për forcimin e kapaciteteve realizuar nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore (QRKREJ)	72
2.	Pjesëmarrja e stafit të IKTK-së në programe për forcimin e kapaciteteve profesionale (Konferenca, Trajnime, Takime) ..	73
VIII.	BOTIME DHE PROMOVIME	75
1.	Revista “Monumentet”, organ shkencor i IKTK-së	75
2.	Promovim, komunikim	76
IX.	BUXHETI I IKTK-së	79
X.	PLANIFIKIM PËR VITIN 2021	83
XI.	PROBLEME ADMINISTRATIVO-JURIDIKE TË HASURA GJATË ADMINISTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2020.	86
	Shtojca 1: Lista Zyrtare e Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore në territorin e Shqipërisë e përditësuar me të dhënat për vitin 2020.	86
	Shtojca 2 – Projektet e miratuara dhe aktiviteti i KKTKM-së	86

PARATHËNIE

Viti 2020 u shenjua nga dy ngjarje të rëndësishme për Shqipërinë dhe për mbarë botën. Ky vit nisi pas tërmetit shkatërrues që goditi Shqipërinë në datën 26 nëntor 2019 dhe duke filluar nga muaji mars e në vijim deri në fund të vitit, jeta në Shqipëri, ashtu si dhe në gjithë botën u shoqërua nga pandemia globale e shkaktuar nga virusi Covid 19.

Vlerësimi i dëmeve që shkaktoi tërmeti dhe i nevojave të objekteve të dëmtuara të trashëgimisë kulturore ka qenë një nga prioritetet kryesore të punës së IKTK-së gjatë vitit 2020. Puna institucionale gjatë këtij viti është zhvilluar në përputhje me masat ligjore kundër përhapjes së pandemisë. Puna ka vazhduar edhe gjatë periudhës së karantinës totale duke organizuar punën me rotacion pjesërisht në zyra dhe pjesërisht online.

Përdorimi i mjeteve dhe platformave online për vijimin e punës ka përbërë sfidë, por gjithsesi është përqafuar lehtësisht nga stafi i IKTK-së.

MISIONI

Detyra themelore e **Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK)** është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK-ja ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK-ja merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, hulumtimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK-ja, aktivitetin e saj e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat, bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e saj.

OBJEKTIVA

Përmirësimi i kuadrit ligjor

- Të përditësojë kuadrin ligjor për mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore në territorin e Shqipërisë, me qëllim përmirësimin e tij, në përputhshmëri me legjislacionin e sektorëve të tjerë në Shqipëri, si dhe t'a përafrojë me atë të BE-së;
- Të marrë të gjitha masat në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përgatitjen, planifikimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore dhe njerëzore.

Partneritete dhe Marrëveshje bashkëpunimi

- Të krijojë dhe forcojë partneritete, marrëveshje apo protokolle bashkëpunimi me palë të ndryshme interesi në funksion të përmbushjes së misionit të tij;
- Të hartojë dhe/apo koordinojë projekte në kuadër të zbatimit të detyrimit dhe përgjegjësive që rrjedhin nga këto partneritete.

Programe shtetërore dhe ndërkombëtare në trashëgimi kulturore

- Të zbatojë programe shtetërore dhe ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore në kuadër të përmbushjes së misionit të tij;
- Të hartojë dhe/apo koordinojë projekte në kuadër të zbatimit të programeve shtetërore dhe ndërkombëtare ku Ministria e Kulturës është përfitues.

Aktiviteti i IKTK-së në përputhje me Planin e punës 2020

- Të propozojë vënien në mbrojtje të shtetit të objekteve, grupeve të objekteve dhe zonave nëpërmjet deklaramit të tyre pasuri kulturore në bazë të studime të thelluara kërkimore - shkencore;
- Të kontrollojë gjendjen e konservimit të monumenteve dhe të ndjekë zbatimin e legjislacionit në fushën e monumenteve të kulturës, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK);
- Të hartojë dhe ndjekë zbatimin e kritereve për ruajtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore;
- Të zbatojë detyrimet që lidhen me Konventën e Trashëgimisë Botërore lidhur me mbrojtjen dhe menaxhimin e siteve kulturore apo mikse me status Pasuri Botërore në Shqipëri;
- Të hartojë projekte mbi ndërhyrjet në pasuritë kulturore si dhe kontrollojë zbatimin e tyre nga Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, apo nga subjekte të licencuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- Të planifikojë, drejtojë apo mbikëqyrë dhe kolaudojë nga ana shkencore punimet konservuese dhe restauruese të pasurive kulturore;

- Të ushtrojë veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si dhe të sigurojë mbarëvajtjen e proceseve arkeologjike si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë;
- Të ndjekë gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimorë ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe të marrë masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- Të mbikëqyrë proceset arkeologjike në terren e të ecurisë së punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projekteve zhvillimorë, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale;
- Të koordinojë mbikëqyrjen e subjekteve private të licencuara gjatë kryerjes së proceseve arkeologjike të shpëtimit, në zbatim të vendimeve të KKTKM;
- Të sigurojë hartimin sipas kriterëve të caktuara dhe dorëzimin në arkivën teknike të dokumentacionit të rregullt për të gjitha studimet dhe ndërhyrjet që kryhen mbi pasuritë kulturore;
- Të krijojë dhe përditësojë bazën e të dhënave mbi pasuritë kulturore dhe listën kombëtare të monumenteve të kulturës dhe zonave të trashëgimisë kulturore.

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale – KKTKM

- Të shqyrtojë dhe miratojë të gjitha ndërhyrjet në pasuritë dhe zonat e trashëgimisë kulturore të hartuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore dhe subjektet e licensuar në këtë fushë;
- Në bashkëpunim me organet e njësisve vendore, të studiojë kërkesat për ndërtime të reja në zonat e mbrojtura dhe të argumentojë pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) mbi miratimin ose jo të tyre.

Shërbime të ofruara nga IKTK-ja

Programe për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe Kërkimi Shkencor

- Të hartojë dhe zbatojë programe për forcimin e kapaciteteve profesionale në fushën e konservimit të trashëgimisë kulturore materiale, nën koordinimin e UNESCO-s, nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim të Evropës Juglindore;
- Të inkurajojë forcimin e kapaciteteve profesionale të stafëve të sistemit të trashëgimisë kulturore përmes kualifikimit dhe formimit të vazhdueshëm.

Botime dhe Promovime

- Të krijojë dhe ndjekë një plan strategjik komunikimi me qëllim promovimin e punës, njohjen e publikut me trashëgiminë kulturore, evidentimin dhe sensibilizimin e publikut në lidhje me të gjitha çështjet të cilat prekin trashëgiminë kulturore materiale;
- Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike “Monumentet” organ i IKTK-së, si dhe të realizojë dhe mbështesë botime mbi fushën e trashëgimisë kulturore.

I. PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR

Në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, IKTK-ja është pjesë e procesit të hartimit, përditësimit, konsultimit për aktet nënligjore të nevojshme në fushën e trashëgimisë kulturore. IKTK-ja, në bazë të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP), nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës (MK) dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK), gjatë vitit 2020, kanë propozuar rishikimin e kufijve të pasurive kulturore në grup dhe rregulloreve përkatëse për administrimin e tyre.

Në këtë kuadër është përfunduar procesi për hartimin e akteve nënligjore, si dhe janë në proces hartimi si më poshtë:

	VKM	Udhëzime	Urdhër Ministri
Akte nënligjore të miratuara	10	1	1
Akte nënligjore në proces miratimi	11	15	3

1. Akte nënligjore të miratuara

1. VKM Nr. 60, datë 29.1.2020 “Për deklarimin pasuri kulturore “Ansambël Historik Urban”, zonës mbrojtëse të tij, dhe zonës arkeologjike “B”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”.
2. VKM Nr. 771, datë 30.09.2020 “Për deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”.
3. VKM Nr. 729, datë 16.9.2020 “Për deklarimin pasuri kulturore “Qendër Historike” të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj, dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”.
4. VKM Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.
5. VKM Nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” (ndryshuar me VKM Nr. 560, datë 15.7.2020).
6. Urdhër Nr. 223, datë 3.7.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”.
7. Udhëzim Nr. 269, datë 11.8.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë, për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” (ndryshuar me Udhëzimin Nr. 285, datë 27.08.2020).
8. VKM Nr. 737, datë 17.9.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

9. VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”.
10. VKM Nr. 793, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”.
11. VKM Nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”.
12. VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit”.

2. Akte nënligjore në proces miratimi

1. Projekt vendim: “Për miratimin e masave ruajtëse të trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”.
2. Projekt vendim: “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore”.
3. Projekt vendim: “Për përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin”.
4. Projekt vendim: “Procedura për hulumtimet arkeologjike”.
5. Projekt vendim: “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të bazës së të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në RSH”.
6. Projekt vendim: “Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”.
7. Projekt vendim: “Për përcaktimin e zonave arkeologjike nënujore”.
8. Projekt vendim: “Për procedurën e shpalljes publike të pasurive kulturore që zbulohen në det”.
9. Projekt vendim: “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore si dhe të aktiviteteve të tjera që prekin direkt ose indirekt tërësinë e vlerave arkeologjike dhe historike nënujore”.
10. Projekt vendim: “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së “Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim” (QRKR).
11. Projekt vendim: “Hartimi i Planit Kombëtar të Peizazhit”.
12. Projekt Udhëzim: “Për mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale”.
13. Projekt Udhëzim i përbashkët MK dhe MF për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKTK.
14. Projekt Udhëzim: “Për mënyrën e funksionimit të komisionit këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jomateriale”.
15. Projekt Udhëzim: “Për kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim, metodologjinë e tarifave, organet këshillimore, kriteret për marrjen e vendimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të aplikimit”.
16. Projekt Udhëzim: “Për rregullat për përdorimin e drejtpërdrejtë dhe riprodhimin e pasurive kulturore”.
17. Projekt Udhëzim: “Për termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme”.
18. Projekt Udhëzim: “Për mënyrat e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse”.

19. Projekt Udhëzim i përbashkët për: “Parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin”.
20. Projekt Udhëzim: “Për mënyrën e vlerësimit të gjetjeve rastësore të objekteve arkeologjike”.
21. Projekt Udhëzim: “Për rregullat e hollësishme mbi lejen për hulumtime arkeologjike”.
22. Projekt Udhëzim: “Për kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues të personave të pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe me licencë për kryerjen e veprimtarive arkeologjike”.
23. Projekt Udhëzim: “Për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshme”.
24. Projekt Udhëzim: “Për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së”.
25. Projekt Udhëzim: “Për kriteret e përpilimit të listave të pasurive të paluajtshme në pronë shtetërore, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruese dhe dërgimin e tyre për verifikim”.
26. Projekt Udhëzim: “Për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore”.
27. Urdhër Ministri: “Për miratimin e formatit të kërkesës dhe dokumentacionin shoqërues për lëshimin e lejes për ndërhyrje në pasuritë kulturore”.
28. Urdhër Ministri: “Ngritja pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së e komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale”.
29. Urdhër Ministri: “Komisioni i vlerësimit për gjetjet rastësore arkeologjike”.

3. Procesi i përafrimit të legjislacionit në kuadër të integritit evropian

Gjatë vitit 2020 në kuadër të Grupit Ndërmintor për Integrimin Evropian për Kapitullin e tretë, ku IKTK-ja përfaqësohet me një anëtar është dhënë kontribut për hartimin e dokumentit të mangësive ligjore dhe institucionale LGA dhe IAGA, si dhe është dhënë kontribut për hartimin e PKIE 2021-2023.

4. Përgatitja, planifikimi dhe përballimi i fatkeqësive natyrore dhe njerëzore

“Plani për Përgatitjen për Emergjencat Civile për IKTK-në” u hartua në fund të vitit 2019 dhe ka për qëllim krijimin e kushteve për të zvogëluar risqet e fatkeqësive duke filluar nga parandalimi, përgatitja, përballimi i fatkeqësive dhe rimëkëmbja. Në kuadër të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, IKTK-ja përfaqësohet në Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile” të ngritur me urdhër të Ministrit të Kulturës (nr. 410, datë 09.07.2019).

Gjatë vitit 2020 ka funksionuar ky komision i cili ka dhënë kontribut në hartimin e Projekt Vendimit “Për miratimin e masave ruajtëse të trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”.

II. PROGRAME SHETETËRORE DHE NDËRKOMBËTARE NË TRASHËGIMI KULTURORE

IKTK-ja në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës ka bashkërenduar dhe vijon punën në disa programe të rëndësishme të Ministrisë së Kulturës, ndërministrore dhe ndërkombëtare:



1. Programet e procesit të rindërtimit:

Procesi i rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, i cili koordinohet nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin.

Programet e procesit të Rindërtimit:

- Programi i zhvillimit të objekteve të reja
- Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike
- Programi i krijimit të fondit të banesave
- Programi i granteve të rindërtimit
- Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike

Me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të 26 nëntorit 2019, të ndodhur në një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, është miratuar Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”. Ky akt normativ është miratuar në zbatim të verifikimit dhe rregullimit të pasojave të gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, që shpallet në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

Me Vendim Nr. 213, datë 11.3.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si Njësi Zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, IKTK-ja u caktua si **njësi zbatuese** për administrimin e fondit në vlerën **236 627 069** (dyqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**, për restaurimin/rindërtimin e pasurive kulturore në njësitë territoriale të bashkive Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Rrogozhinë e Vorë.

Nga të cilat:

- Vlerën prej 197 500 584 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH, për:
 - i. hartimin e projekteve të detyruara për restaurimin/rindërtimin e pasurive kulturore, të dëmtuara;
 - ii. rishikimin e projekteve të hartuara për restaurimin/rikonstrukcionin e objekteve pasuri kulturore, të dëmtuara;
 - iii. realizimin e studimeve të thelluara komplekse, përfshirë studime gjeologjike, rievime me aparatura bashkëkohore, sisteme monitorimi të strukturave, të objekteve pasuri kulturore, të dëmtuara.
- Vlerën prej 39 126 485 (tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për realizimin e veprimtarive arkeologjike (vëzhgim sipërfaqësor, sondazhe arkeologjike dhe monitorim) në zonat e përcaktuara për hartimin e planeve të detyruara vendore.

Informacion i detajuar për projektet e hartuara në kuadër të këtij programi, paraqitet në Kapitullin IV, pika 1.

2. Programi EU4CULTURE

Programi “EU4CULTURE Revitalizing Albania’s Cultural Heritage in Response to the 2019 Albania Earthquake” (Rijetëzimi i Trashëgimisë Kulturore në Përgjigje të Tërmetit të Shqipërisë të Vitit 2019), financohet nga Delegacioni Europian për projekte të restaurimit dhe rehabilitimit të siteve të trashëgimisë kulturore të prekuara nga tërmeti i vitit 2019 me vlerë deri në **40 milion Euro**.

Palët kryesore të përfshira në këtë program janë Delegacioni i Bashkimit Europian (investitori), Ministria e Kulturës (përfituesi), Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (organ teknik këshillues) dhe UNOPS *njësi zbatuese* e Delegacionit të Bashkimit Europian (EU). UNOPS-i do të ofrojë mbështetje teknike, menaxhim projekti dhe prokurime.

Programi “EU4CULTURE” synon të rigjallërojë sitet e trashëgimisë kulturore dhe monumentet në Shqipëri të dëmtuara nga tërmeti i nëntorit 2019. Së bashku me riparimin dhe rehabilitimin e ndërtesave të dëmtuara, programi kërkon të përmirësojë potencialin social dhe ekonomik të këtyre vendeve si atraksione turistike. Programi ka gjithashtu për qëllim aftësimin e Ministrisë së Kulturës në administrimin e trashëgimisë kulturore dhe maksimizimin e të ardhurave socio-ekonomike për qytetarët shqiptarë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për rolin e kulturës në zhvillimin socio-ekonomik.

Programi ka për qëllim arritjen e tre rezultateve kryesore që ndjekin qeverisjen e mirë dhe parimet përfshirëse si një aspekt ndërsektorial:



IKTK-ja merr pjesë në këtë Program duke ofruar asistencë teknike në trashëgimi kulturore materiale si dhe siguron ndjekjen e procedurave administrative deri në përfundim të projekteve. Gjatë vitit 2020, nga ana e IKTK-së është vënë në dispozicion të UNOPS i gjithë dokumentacioni i nevojshëm si:

- Formularët e Inspektimit pas tërmetit për çdo sit;
- Materiale Arkivore, Rilevime të objekteve;
- Kartelat e Pasurive Kulturore;
- Projektet e miratuara për ndërhyrje emergjente dhe stabilizimi pas tërmetit të Nëntorit 2019.

Më pas është vijuar me inspektimin e objekteve në terren nga grupe të përbashkëta me përfaqësues nga UNOPS-i, IKTK-ja dhe DRTK-të. Deri më dhjetor 2020 janë kryer 3 misione inspektimi dhe janë hartuar raportet përkatëse.

Puna ka vijuar me takime dhe workshop-e ndërmjet përfaqësuesve të EU Delegation, Ministrisë së Kulturës, UNOPS dhe IKTK-së me qëllim hartimin e kriterëve për përcaktimin e listës prioritare nga të cilat do të vijojë puna. Lista paraprake e kriterëve dhe e siteve u miratua nga Komitetit Drejtues (Steering Committee), në mbledhjen e datës 15.12.2020. Komiteti Drejtues përbëhet nga përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ministri i Kulturës dhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin.

Lista prej 10 projektesh e miratuar i është dërguar për rishikim nga trupat teknik të brendshëm të UNOPS, me qëllim më pas vijimin e procedurave për zbatimin e punimeve restauruese.

Tab. 1 - Lista e projekteve dërguar UNOPS-it për zbatim të punimeve restauruese

Nr.	Objekti	Bashkia
1	Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras	Kurbin
2	Ish Arqipeshkëvia e Durrësit në Delbnisht,	Kurbin
3	Kalaja e Ishmit dhe banesa pranë mureve të kalasë	Durrës
4	Porto Romano	Durrës
5	Ura e Kurcajt në përroin e Zerzës	Krujë
6	Godina e “Vettingut” (Ish Lidhja e Shkrimtarëve), Kodi (II-085)	Tiranë
7	Akademia Kombëtare e Shkencave, Kodi (II-044)	Tiranë
8	Godina e Ish të përndjekurve politikë, Kodi (II-049)	Tiranë
9	Biblioteka Kombëtare "Fondi"	Tiranë
10	Godina e Ish Kinostudios	Tiranë

3. Programi Fondi i Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore (AFCP)

Ambasada e Shteteve të Bashkuara mbështet Fondin e Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore (AFCP) që prej krijimit të tij në vitin 2001. Ky program është një mënyrë e partneritetit me Shqipërinë për ruajtjen e trashëgimisë së saj unike kulturore. Nëpërmjet këtij programi, Departamenti i Shtetit Amerikan mbështet projektet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në tri fushat e mëposhtme:

- **Vendet kulturore**, si ndërtesat historike ose site arkeologjike, por jo domosdoshmërisht të kufizuara vetëm në këto kategori;
- **Objektet kulturore dhe koleksionet**, nga një muze, vend, ose institucion i ngjashëm – që përfshin por nuk kufizohet në objekte arkeologjike dhe etnografike, piktura, skulptura, dorëshkrime, dhe nevoja të përgjithshme për ruajtjen muzeale;
- **Forma tradicionale të shprehjes kulturore**, si muzikë tradicionale, gjuhët indigjene dhe zanatet.

Aplikantët që kualifikohen për përfitim granti, duhet të jenë entitete të njohur dhe të përgjegjshëm, jo-komerciale, si organizatat jo qeveritare, ose institucione dhe organizata të ngjashme të afta të tregojnë se kanë përvojën e duhur dhe kapacitete për të menaxhuar projekte për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Duke qenë se institucionet shtetërore **nuk** kualifikohen për përfitim të granteve në këtë program, Ministria e Kulturës aplikoi për këtë fond në vlerën rreth **800 000 USD** nëpërmjet organizatës jo-fitimprurëse CHwB e cila bashkëpunoi ngushtë me IKTK-në për hartimin e këtij aplikimi për restaurimin e fortifikimeve në Krujë, Durrës, dhe Prezë, të cilat u dëmtuan nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Ky fond u miratua për zbatimin e ndërhyrjeve konservuese/restauruese në objektet:



Informacion i detajuar për projektet e hartuara në kuadër të këtij programi, paraqitet në Kapitullin IV, pika 2.

4. Programi për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik - PZHIUT

Programi për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik (PZHIUT) përfshin 3 qarqe (Vlorë, Berat, Gjirokastrë); 4 bashki (Sarandë, Gjirokastrë, Berat, Përmet) dhe korridori turistik që kalon në këtë rajon. Ky program me kohëzgjatje 2017-2022 financohet nga Banka Botërore dhe menaxhohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) si *njësi zbatuese*, me vlerë totale deri **63.8 milion Euro**

Programi mbështet Qeverinë Shqiptare për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në rajonin jugor, nëpërmjet financimit të projekteve infrastrukturore në:

- **Komponenti 1. Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës**

Financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe përmirësimin e infrastrukturës bashkiake. Ky komponent financon gjithashtu përgatitjen e projekteve urbane, studimeve të fizibilitetit, projekteve inxhinierike, dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.

- **Komponenti 2. Përmirësimi i siteve turistike**

Financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike që do të përzgjidhen përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut. Investimet përfshijnë restaurimin e objekteve të trashëgimisë dhe aseteve kulturore, përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planit e menaxhimit të siteve, projektet inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.

- **Komponenti 3. Tregu i turizmit dhe zhvillimi i produkteve**

Ky komponent do të financojë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar menaxhimin bashkiak dhe zhvillimin ekonomik lokal të bazuar në turizëm.

Projektet në fazë konsultimi:

- *Identifikimi, hartimi dhe mbikëqyrja e masave urgjente të sigurisë dhe parandalimit e humbjes së strukturave të trashëgimisë në Kalanë e Gjirokastrës*

Ministria e Kulturës (MK) dhe Bashkia Gjirokastrë kanë kërkuar mbështetje me situatën emergjente në lidhje me kalanë e Gjirokastrës (çarje në pjesë të caktuara të mureve të kalasë dhe çështje me stabilitetin e shpateve të kalasë) në kuadër të programit PZHIUT.

Reshjet e rrëmbyeshme të rëna gjatë muajit shkurt 2018 krijuan një situatë të pazakontë, e cila shkaktoi dëme të shumta dhe shkarje dherash në të gjithë zonën juglindore të vendit. Kjo situatë solli probleme edhe në kalanë e Gjirokastrës monument kulture i kategorisë të parë, pjesë e Qendrës Historike të Gjirokastrës, pasuri botërore në Listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Më datë 09.02.2018 një grup specialistësh të Ministrisë së Kulturës, Institutit të Monumenteve të Kulturës, Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë si dhe specialistë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Drejtoria e Gjeologjisë Inxhinierike-Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, realizuan inspektimin në terren për vlerësimin e situatës së krijuar në Kalanë e Gjirokastrës, në të cilën u konstatua se shkak i problematikave në muret e Kalasë lidhet me qëndrueshmërinë e dobët të shpateve ku është mbështetur monumenti.

Gjatë gjithë kësaj periudhe janë organizuar një sërë takimesh ndërmjet të gjithë aktorëve. Në përfundim të këtyre takimeve Ministria e Kulturës propozoi ngritjen e grupit të punës ndërministror për zhvillimin e hapave të mëtejshëm në funksion të zgjidhjes së problematikave të krijuara, e cila konkludoi me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 52, datë 16.03.2018 “Për ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme mbi situatën emergjente në Kalanë e Gjirokastrës”. Në zbatim të këtij Urdhëri u realizua takimi më datë 30.03.2018 në të cilin ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Arsimit, ku u vendos që të punohet në dy faza.

Në zbatim të fazës së parë, ekspertët kanë inspektuar kalanë e Gjirokastrës në të gjithë ambientet e saj dhe kanë përcaktuar problematikat sipas fushave që mbulohen nga secili institucion. Çdo grup pune ka dërguar zyrtarisht pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës sot IKTK (Sekretariati teknik i grupit ndërministror), Termat e Referencës për hartimin e studimit të plotë mbi gjithë problematikat që paraqet situata në Kalanë e Gjirokastrës si dhe një vlerë financiare të përafërt.

Gjithashtu, Banka Botërore ka dërguar pranë Ministrisë së Kulturës me Nr. 1713/1 Prot., datë 03.05.2018 raportin “Vlerësimi i shpejtë dhe ndërhyrjet emergjente në Kalanë e Gjirokastrës” (“Gjirokastra Castle Rapid Assessment and Emergency Response Report”). Ky raport është përgatitur nga një grup ekspertësh nga Britania e Bashkuar, “Ove ARUP & Partners International Ltd.”, pas një inspektimi disaditor të çdo ambienti të Kalasë. Pas studimit të këtij raporti, u dol në përfundimin se rekomandimet e tyre përputhen plotësisht me rekomandimet e grupit ndërministror, prandaj MK iu drejtua përsëri BB me kërkesën për suport financiar me shkresën Nr. 3812, datë 04.06.2018.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të FSHZH-së dhe me konsulencën teknike të vazhdueshme të Institutit të Monumenteve të Kulturës (sot IKTK) hartuan Termat e Referencës për projektin: “Consultant firm for identification, design and supervision of prioritized measures to address urgent safety concerns and prevent loss of heritage structures in the castle of Gjirokastra”. Pas miratimit të Termave të Referencës nga grupi i Bankës Botërore, u vazhdua me procesin e tenderimit për përcaktimin e firmës konsulente. Kontrata u lidh me konsulentin bashkim i operatorëve Proskena Conservation & Cultural Heritage dhe Cultural Heritage without Borders.

Në Janar 2020 është mbajtur takimi i parë ndërmjet përfaqësuesve të FSHZH-së, konsulentëve dhe grupeve të tjera të interesit. Fazat e dorëzimeve të projektit sipas detyrave:



Deri më tani janë miratuar dy fazat e para, Analiza paraprake dhe Plani i konservimit. Faza e tretë, Projekt- ideja paraprake është dorëzuar nga konsulenti dhe ka marrë komentet paraprake nga ana e IKTK-së. Në vijim konsulenti do bëjë aplikimin online për shqyrtim të kësaj detyre në KKTKM.

▪ *Rrjeti i muzeve në Gjirokastrë*

Zhvillimi i Sistemit të Muzeve të Gjirokastrës përfshin aspekte dhe aktorë të ndryshëm, si dhe ndërhyrjeve në shkallë të ndryshme që mund të zgjidhin shumë probleme urgjente të lidhura me ruajtjen e monumenteve historike dhe të trashëgimisë kulturore. Gjithashtu ofron shumë mundësi për të fuqizuar brandin kulturor të Gjirokastrës, duke nxitur zhvillimin turistik të qytetit.

Kontraktor: Casanova+Hernandez architects / Cultural Heritage without Borders

Kohëzgjatja: 13 muaj

Vizioni i përgjithshëm i prezantuar në analizën e mëparshme të Sistemeve të Muzeve të Gjirokastrës është bazuar në vendosjen e lidhjeve të reja midis muzeve që operojnë, hapësirave publike, monumentet që nuk janë në funksion, tematikat kulturore dhe koleksionet e ekspozuara ose të pa ekspozuara. Ky vizion është organizuar bazuar të 3 rrjete kulturore:

- Rrjeti i Shtëpive Historike;
- Rrjeti i shtigjeve Tematike;
- Rrjeti i Kalasë.

Rrjeti komplementar i Pazarit, nuk është konsideruar si pjesë e këtij projekti.

Faza e parë e ndërtimit të ndërthurjes së tre rrjeteve të kulturës, që formojnë Sistemin e Muzeve të Gjirokastrës konsiston në realizimin e një serie ndërhyrjesh “materiale” të klasifikuara në:

- Rinovimin ose zgjerimin e funksionit të një muzeu ekzistues dhe përbajtjes muzeologjike;
- Restaurimin e një ndërtese pa funksion ose hapësire për aktivizimin e një programi apo aktiviteti muzeologjik;
- Restaurimin dhe interpretimin e hapësirave publike.

Që të formohen rrjetet, ndërhyrjet “materiale” duhet të lidhen me dy pjesët e tjera të ndërhyrjes “jo-materiale”: Menaxhimi i rrjeteve dhe paraqitja (brandimi) i rrjeteve.

Tab. 2 - Lista prioritare e projekteve

Nr.	Objekti	Preventiv paraparak
1	Muzeu Etnografik	459.859,08 Euro
2	Shtëpia Kadare	193.850 Euro
3	Itinerari Kronikë në Gur	130.020 Euro
4	Itinerari Lear	304.500 Euro
5	Faqe web	

Projektet e Zbatimit janë miratuar me Vendim të KKTKM Nr. 235, datë 24.07.2020.

▪ *Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës urbane për qytetin e Beratit dhe Përmetit*

Qëllimi i kësaj detyre është të kontribuojë në zbatimin e komponentit 1 të PZHIUT në dy qytete, Berat dhe Përmet, duke zhvilluar Koncepte të Integruara Projekti Urban (KIPU), me fokus në zonat në studim të qyteteve, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve vendas dhe rritjen ekonomike bazuar në zhvillimin e turizmit lokal në zonat urbane.

Kontraktor: Keios (Itali) / Atelier 4 (Shqipëri)

Bashkia Berat

Pas vlerësimit të Konceptit të Integruar të Projektit Urban për Beratin dhe të Programit të Investimeve të zonës së projektit, Nënprojekt-investimet e përzgjedhura për zbatim në Berat janë:

Tab. 3 - Lista e projekteve të përzgjedhura për zbatim në bashkinë Berat

Nr.	Kodi	Objekti	Kohëzgjatja	Preventiv paraprak (Lekë)
1	P01	Restaurimi i peizazhit historik urban të lagjes Goricë	37 muaj	449.670.647
2	P03	Rehabilitimi i shtegut të Kalasë së Goricës dhe krijimi i potencialeve turistike pranë monumentit	17 muaj	12.029.535
3	P04	Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës	20 muaj	82.830.472
4	P06	Restaurimi dhe përdorimi me përshtatje i ish Selamllëkut të Vrionasve dhe zonës përreth	20 muaj	177.505.748
5	P09	Rigjenerim i zonës përreth Muzeut Etnografik dhe rrugës Mihal Kommeno	20 muaj	260.303.304
6	P11	Përmirësim pamor i siluetës urbane përgjatë rrugës Antipatrea në Qendër të Qytetit	20 muaj	441.686.829
7	P12	Rehabilitim urban i sheshit Iliaz Vrioni	20 muaj	234.617.544
8	P15	Sinjalistika turistike dhe tabelat informuese	15 muaj	11.458.746
			Total:	1.670.102.825

Bashkia Përmet

Pas vlerësimit të Konceptit të Integruar të Projektit Urban për Përmetin dhe të programit të investimeve të zonës së projektit, Nënprojekt-investimet e zgjedhura në Përmet për zbatim janë:

Tab. 4 - Lista e projekteve të përzgjedhura për zbatim në bashkinë Përmet

Nr.	Kodi	Objekti	Kohëzgjatja	Preventiv paraprak (Lekë)
1	P01	Rigjenerimi i lagjes së vjetër historike	13 muaj	261.548.301
2	P02	Rehabilitimi i kanalit Përroi i Bardhë	6 muaj	24.689.032
3	P04	Përmirësimi i sferës publike dhe hapësirave në qytetin modern (faza 1)	6 muaj	169.016.303
4	P016	Sinjalistika turistike dhe tabelat informuese	3 muaj	9.266.418
			Total:	464.520.054

Projekt-ide “Koncepti paraprak, udhëzimet dhe Preventivi paraprak për projekt Investimet e përzgjedhura në Berat.”, të rishikuar, pjesë e “Projekt Ide, Projekt Zbatim dhe Supervizim për Rigjenerimin e Integruar Urban” për qytetin e Beratit dhe Përmetit”, hartuar nga “Atelier 4” sh.p.k është miratuar me Vendim KKTKM Nr. 162, datë 09.06.2020 dhe Nr. 199, datë 02.07.2020.

Projekti zbatimit P01 “Restaurimi i peisazhit historik urban të Lagjes Goricë” dhe P03 “Rehabilitimi i shtegut të Kalasë së Goricës dhe krijimi i potencialeve turistike pranë monumentit”, pjesë e projektit “Koncepti paraprak, udhëzimet dhe Preventivi paraprak për projekt Investimet e përzgjedhura në Berat, hartuar nga “Atelier 4” dhe “KEIOS”, me aplikues FSHZH, është miratuar me Vendim KKTKM Nr. 333, datë 14.09.2020.

Projekt zbatimi për Bashkinë e Përmetit, pjesë e projektit për zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik (PZHIUT) për Bashkitë Berat dhe Përmet, për “Projekt Ide, Projekt zbatim dhe Supervizim për Rigjenerim të integruar urban” me projektues “Atelier4” sh.p.k. dhe “KEIOS”, është miratuar me Vendim KKTKM Nr. 274, datë 17.08.2020.

- *Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimi dhe eksperiencia turistike për sitet turistike Zvërnec – Nartë & Ujrat Termal të Bënjës*

Siti: Zvërnec - Nartë

Ky projekt ka si objektiv listimin e projekteve më prioritare për zhvillimin e këtij siti, të kombinuara ato përpiqen të ndërtojnë një itinerar të fortë brenda zonës, që lidh së bashku destinacionet e ndryshme të zonës, qofshin ato natyrore apo vepër e njeriut.

Kontraktor: Abkons/Metropolis

Preventiv Paraprak: **483.198** Euro

Kohëzgjatja: 11 muaj

Ky itinerar do të pasurohet me *Shenja*, që do të nxisin rritjen e perceptimit të tij edhe më tej. Këto ndërhyrje janë qendra pamore, terheqëse të flukseve të vizitorëve. Brenda kësaj kategorie projektesh janë: Totemi, Qendra e Parkut. Struktura për Vrojtim. Ndërhyrjet e propozuara do t’i japin disa Shërbime këtij itineari, që kanë një vendndodhje dhe shtrirje të mirëpërcaktuar. Këto ndërhyrje do të jenë të qarta dhe të identifikueshme gjatë itinerarit të vizitorëve, duke ndihmuar në shmangien e përdorimit informal të territorit po për të njëjtat shërbime. Brenda kësaj kategorie janë: Pika e kontrollit; Parkimi; Zona për Kamper; Tualete, Dhoma Ndërrimi.

Lista e projeteve plotësohet nga ndërhyrje të tjera plotësuese; që së bashku janë gjithashtu shenja që akomodojnë nevojat e vizitorëve për lëvizje më të lehtë, të sigurtë dhe tërheqëse nëpër zonë. Këto ndërhyrje janë: Belvederet; Shtigjet për Hiking, Pista për Biçikleta; Ura, Rrethrotullimi.

Siti: Ujrat Temale Bënjë

Ky projekt ka si objektiv listimin e projekteve më prioritare për zhvillimin e këtij siti. Të kombinuara ato përpiqen të ndërtojnë një itinerar të fortë brenda zonës, që lidh së bashku destinacionet e ndryshme të zonës, qofshin ato natyrore apo vepër e njeriut.

Kontraktor: Abkons/Metropolis

Preventiv Paraprak: **420.378,36** Euro

Kohëzgjatja: 11 muaj

Ky itinerar do të pasurohet me *Shenja*, që do të nxisin rritjen e perceptimit të tij edhe më tej dhe do ta veshin atë me rëndësi. Këto ndërhyrje janë qendra pamore, terheqëse, të flukseve të vizitorëve. Brenda kësaj kategorie projektesh janë: Totemi, Qendra e Parkut.

Ndërhyrjet e propozuara do t'i japin disa *Shërbime* këtij itineari, që kanë një vendndodhje dhe shtrirje të mirëpërcaktuar. Këto ndërhyrje do të jenë të qarta dhe të identifikueshme gjatë itinerarit të vizitorëve, duke ndihmuar në shmangien e përdorimit informal të territorit po për të njëjtat shërbime. Brenda kësaj kategorie janë: Pika e kontrollit; Parkimi; Zona për Kamper; Tualete, Dhoma Ndërimi.

Lista e projeteve plotësohet nga ndërhyrje të tjera *Plotësuese*; që së bashku janë gjithashtu shenja që akomodojnë nevojat e vizitorëve për lëvizje më të lehtë, të sigurtë dhe tërheqëse nëpër zonë. Këto ndërhyrje janë: Tarracat (përfshirë tarracën para shpellës); Lidhja dhe aksesit i Vaskave; Itineraret për Hiking; Ura.

Projekti i Zbatimit në kuadër të projektit “Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimin dhe eksperiencën turistike për sitet turistike Zvërnec – Nartë & Ujrat Termal të Bënjës (FSHZH - Banka Boterore)” është shqyrtuar në Këshill teknik, por është shtyrë vendimmarrja pasi Raporti i Vëzhgimit Arkeologjik nuk ishte i firmosur nga person i licencuar në arkeologji.

Projektet të përfunduar (në pritje për zbatim):

▪ *Ndriçimi i Qendrës Historike të qytetit të Gjirokastrës*

Instalimet elektrike do të përmbajnë kryesisht infrastrukturën për rrjetin elektrik të zonës, e cila do të shërbejë për shtrimin e linjave elektrike të furnizimit nëpërmjet tubave dhe pusetave të kontrollit gjatë gjithë gjatësisë së rrugës. Kështu do të përgatitet edhe infrastruktura e veçantë për shtrimin e linjave për furnizim me energji në rrjetin elektrik të ndriçimit.

Kontraktor: “A & E Engineering” shpk

Preventiv: 63.281.362 Lekë

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i këtij projekti është përmirësimi i rrjetit të ndriçimit rrugor i cili do të konceptohet sipas idesë arkitektonike të rrugës dhe të zonës në veçanti. Kështu do të sigurohet një ndriçim i mjaftueshëm dhe homogjen duke eliminuar zonat e errëta dhe duke theksuar më shumë zonat e mbipopulluara apo delikate siç janë sheshet, kryqëzimet, shtëpitë muze etj.

Zona e ndërhyrjes përse i përket të gjitha këtyre rrugëve në përgjithësi, në ato pjesë ku do të ndërhyhet, do të konsistojë në shtrirjen e linjave tokësore dhe jo duke ndjekur modelin ekzistues ku shtrirja e linjave është ajrore e cila nuk plotëson kushtet teknike të instalimit, nuk është një rrjet i sigurtë dhe jep impakt negativ në zonë.

Pas inspektimit në vend të rrugëve historike të qytetit të Gjirokastrës ku do të ketë ndërhyrje, më poshtë renditen sipas prioriteteve që ato do të kenë:

- Rruga "Alqi Kondi"
- Rruga "Lufta e Mashkullorës"
- Rruga "Jonuz Cuci"
- Rruga "Pllakë-Pazari i Vjetër"

- Rruga "Ismail Kadare"
- Rruga "Pertef Kokona"
- Rruga "Hysen Hoxha"
- Rruga "Bule Naipi"
- Rruga "Hysen Koci"

Stabilizimi i rrjeteve elektrike të furnizimit me energji do të sjellë një impakt pozitiv në performancën e këtij sistemi si dhe do të krijojë mundësinë për të eliminuar në të ardhmen linjat ajrore të cilat përshkojnë rrugët dhe janë të pasigurta si për kalimtarët ashtu edhe për sigurinë e këtyre shërbimeve.

Projekti i zbatimit është miratuar më Vendim KKR Nr. 66, datë 01.02.2018.

5. Programi “Itinerari kulturor - Gjurmët fishtiane”

Ministria e Kulturës në zbatim të programit të saj në fushën e kulturës, me fokus ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të saj, ka iniciuar prej korrikut 2019 realizimin e programit “Itinerari Kulturor - Gjurmët Fishtiane”, dedikuar figurës së shquar të kombit shqiptar At Gjergj Fishtës. Referuar veprimtarisë dhe jetës së tij plot ngjarje të rëndësishme dhe për historinë e Shqipërisë, e bëjnë Fishtën një figurë me përmasa dhe përtej kufijve gjeografikë të vendit.

Ky program është konceptuar si një itinerar i jetës së At Gjergj Fishtës dhe lidhet me vende/stacione ku ai ka jetuar, punuar, vepruar dhe projektuar, të vendosura në mënyrë kronologjike. Nëpërmjet këtyre stacioneve do të promovohet jeta dhe veprimtaria e At Gjergj Fishtës, ku pjesë të konsiderueshme të këtyre stacioneve vetë Fishta i ka përshkruar dhe vargëzuar në veprat e veta. Pjesë e stacioneve do të jenë dhe ndërtesat që Fishta ka projektuar pas identifikimit dhe studimit të tyre.

Ky program ka për qëllim:

- realizimin e katalogut të botimeve dhe bibliografisë on-line të Fishtës;
- krijimin e Klubit të donatorëve “Miqtë e Fishtës”;
- ndërtimin e website “Itinerari kulturor Fishtian”;
- realizimin e sinjalistikës “Itinerari kulturor Fishtian” dhe restaurimin e disa prej ndërtesave pjesë të këtij itinerari;
- ndërtimin e Memorialit në vendin e banesës ku ka lindur At Gjergj Fishta;
- restaurimin e "Banesës ku ka banuar vitet e para të jetës At Gjergj Fishta", Lezhë.

IKTK-ja përfaqësohet me dy anëtarë në Grupin e punës së ngritur me urdhrer të Ministrit të Kulturës për realizimin e projekt-idesë mbi këtë itinerar. Gjatë vitit 2019 është hartuar Koncept-ideja e këtij projekti. Pas ngritjes së grupit të punës për këtë qëllim, nga ana e këtij grupi pune u punua mbi koncept idenë e këtij itinerari, i cili ka marrë miratimin e Ministrit të Kulturës.

Vlera e përafërt e përlogaritur për realizimin e këtij Programi është **52 650 000** lekë.

Informacion i detajuar për projektet e hartuara në kuadër të këtij programi, paraqitet në Kapitullin IV, pika 6.

6. Programi "Edukimi mbi dhe përmes kulturës"

Programi "Edukimi mbi dhe përmes Kulturës" është ngritur në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar në janar 2016 midis Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Arsimit dhe Sporteve. Programi është në përputhje të plotë me Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, e cila përfaqëson standardet kryesore ndërkombëtare të Politikave Kulturore në Evropë për të nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm të kulturës dhe artit në fushën e arsimit, pasi edukimi përmes kulturës "nxit vetëdijen kulturore dhe shprehjes, krijimtarinë dhe diversitetin, si edhe si kontribuon në zhvillimin njerëzor, social-kulturor në mirëqenien dhe kohezionin social".

Gjatë vitit 2020, IKTK-ja ka ideuar dhe zbatuar aktivitete të ndryshme të dedikuara për moshat e reja, të cilat kanë patur për qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Nëpërmjet lojrave, aktiviteteve praktike, ilustrimeve krijuese, arteve dhe zbavitjes, fëmijët dhe të rinjtë e përfshirë në këto organizime kanë mundur të mësojnë mbi vlerat e pasurive kulturore. Ndër aktivitetet e organizuara gjatë vitit 2020 përmenden aktiviteti "Preke Trashëgiminë", 29 shtator 2020 në Parkun Arkeologjik të Apolonisë, aktiviteti "Rrugëtimi fantastik i Junia Rufinës", që përfshinte lojë me role dhe punishten e mozaikëve, 4 tetor 2020 në Butrint. Aktivitetet janë zhvilluar në përputhje me rekomandimet për masat anti Covid-19.

Në kushtet e karantinës së përgjithshme stafi i IKTK-së është angazhuar për të qenë prezent nëpërmjet rrjeteve sociale përmes videove informuese me karakter edukimi mbi pasuritë kulturore. Videot promovuese të aktiviteteve të sipërpërmendura si dhe një sërë videosh të tjera edukuese dhe informuese si psh.: mbi Monumentin e Agonotetëve, Apoloni, Kishën e Ristozit në Mborje, Korçë, Ditën Botërore të Artit etj. janë materiale të përshtatshme dhe të kënaqshme për të gjitha moshat të cilat janë pritur shumë mirë nga ndjekësit e faqes zyrtare të IKTK-së.

Duke qenë se pjesë e mirë e këtyre aktiviteteve janë realizuar në kuadër të projekteve me fonde të BE-së ku IKTK-ja është partner si projekti 3D-IMP-ACT dhe projekti Mo.Na, informacion më i hollësishëm mbi këto aktivitete jepet në Kapitullin IV – pika 3. Materialet e tjera audio-visuale të realizuara me qëllim promovimi paraqiten në Kapitullin VIII – pika 2.

7. Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020

Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA II), ka një buxhet të përgjithshëm prej **92.707.558,00 Euro** (përfshirë 15% bashkëfinancim kombëtar). Programi menaxhohet nga Rajoni i Pulias, i cili merr pjesë së bashku me një Rajon tjetër Italian - Molise, si dhe Shqipërinë dhe Malin e Zi të cilat marrin pjesë me të gjithë territorin e tyre. Objektivi i këtij programi është të promovojë rritjen ekonomike dhe të intensifikojë bashkëpunimin në zonën e ulët të Adriatikut, duke zbatuar veprime të përbashkëta midis aktorëve institucionalë dhe jofitimprurës kombëtarë dhe rajonalë dhe duke nxitur një zhvillim të zgjuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

IKTK-ja është duke zbatuar dy projekte nën këtë program në:



Aksi Prioritar PA2 – Turizmi dhe Kultura.

Seksioni - SO 2.1

Rritja e atraktivitetit të pasurive natyrore dhe kulturore për të përmirësuar një zhvillim ekonomik të zgjuar dhe të qëndrueshëm



Informacion më i detajuar mbi këto projekte dhe produktet që IKTK-ja ka realizuar gjatë vitit 2020, jepen në Kapitullin IV – Pika 3.

8. Programi Balkan Mediterranean 2014-2020

“Balkan-Mediterranean 2014-2020”, është një Program bashkëpunimi, që bashkon pesë (5) vende, tre (3) shtete anëtare të BE (Bullgaria, Qipro dhe Greqia) dhe dy (2) vende kandidatë, Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

Ky Program bashkëpunimi është bashkëfinancuar nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF) me vlerë prej 28.330.108,00 Euro. Mbështetja totale nga fondi i Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA) llogaritet në 5.126.138,00 Euro. Për fushën e bashkëpunimit të përgjithshëm, zbatohet një normë e bashkëfinancimit prej 85%. Prandaj, buxheti i përgjithshëm i Programit, duke përfshirë bashkëfinancimin kombëtar, është **39.727.654,00 Euro**.

IKTK-ja është duke zbatuar projektin Mo.Na nën këtë program:



Informacion më i detajuar mbi këto projekte dhe produktet që IKTK-ja ka realizuar gjatë vitit 2020, jepen në Kapitullin IV – Pika 3.

9. Programi “IPA II 2018 Action Programme for Albania - EU Economic Development – Tourism – led local economic development with focus on cultural heritage“


“IPA II 2018 Action Programme for Albania - EU Economic Development – Tourism – led local economic development with focus on cultural heritage”, është një program që financohet nga BE. Qëllimi i këtij programi është mbrojtja, ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore, përmirësimi i turizmit të qëndrueshëm në këto zona, duke rivitalizuar zhvillimin ekonomik dhe mjedisor lokal. Shtimi i atraksioneve turistike do të mundësojë rritjen e të ardhurave duke e zgjatur sezonin turistik dhe duke ofruar vende pune për popullsinë vendase.

Ky program e ka fushën e zbatimit në zonat Berat, Fier-Mallakastër, Korçë dhe Shkodër.

Vlera totale e programit është **6 milion Euro** dhe do të jetë i destinuar për implementim, asistencë teknike, promovim dhe rritje kapacitetesh. Njësi zbatimi e këtij programi është “Italian Agency for Development Cooperation – Tirana’s Office (AICS)”.

Ky program do të fokusohet në:

- Ngritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës për përgatitjen e dosjes për nominim të Parkut Arkeologjik të Bylisit (PAB) si pasuri botërore UNESCO;
- Përgatitjen e një studimi mbi zonën e Njësinë Administrative Hekal dhe ekonomisë së këtyre zonave (ekonomi familjare) të lidhura me Planin e Menaxhimit të PAB;
- Rrjetëzimin e parqeve arkeologjike dhe krijimi i networking-rrjetit në drejtim të rrugëve turistike kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rural në kuadrin e Programit 100 Fshatrat.
- Planifikimin dhe programimi - në planin afatmesëm dhe afatgjatë - të aktiviteteve të trashëgimisë kulturore në nivel kombëtar dhe lokal, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Kulturë 2019-2025;
- Ideimin, prodhimin dhe planin mediatic të një fushate marketingu që promovon ruajtjen dhe rritjen e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sipërmarrjes turistike lokale.



Në kuadër të këtij programi dhe objektivave të tij, gjatë vitit 2019 IKTK-ja në bashkëpunim me IA, ASHA, ZAKPA Bylis si dhe Delegacioni i BE-së ka rishikuar ToR’s mbi Hartimin e projektit dhe dosjes së tenderit për “Punime Konservimi dhe Restaurimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Turistike për Parkun Arkeologjik të Bylisit”, të hartuara më herët nga IKTK-ja. Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka vijuar komunikimin për këtë Program duke ofruar asistencë teknike mbi ToR’s të hartua nga AICS në kuadër të një studimi paraprak të situatës mbi këto site dhe strategjisë që do të ndiqet më tej për zbatimin e këtij programi.

III. PARTNERITETE DHE MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

IKTK-ja ushtron aktivitetin e saj edhe në bashkëpunim me partnerë dhe donatorë të huaj apo vendas. Partnerët e IKTK-së gjatë vitit 2020 janë:

EU	European Union - Zyrat e Delegacionit European në Shqipëri
UNOPS	The United Nations Office for Project Services
UNESCO	The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
AAAF	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
CHWB	Cultural Heritage without Borders (OJF)
TIKA	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim
KOASH	Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë
TAP	Trans Adriatic Pipeline AG
FSHZH	Fondacioni Shqiptar për Zhvillim
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifimit të Territorit
FAU	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

1. Bashkëpunimi me UNESCO-n gjatë vitit 2020

UNESCO është mbështetësi kryesor në ruajtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale të pasurive botërore në Shqipëri. Gjatë vitit 2020 bashkëpunimi me UNESCO-n ka konsistuar në:

- Asistencë teknike në hartimin e dokumenteve strategjike dhe programet në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Mbështetje në realizimin e projekteve në fushën e kulturës;
- Mbështetje për forcimin e kapaciteteve në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Mbështetje në ruajtjen e vlerës së veçantë universale të pasurive botërore në Shqipëri, nëpërmjet rekomandimeve teknike dhe raporteve periodike për gjendjen e konservimit.

Asistenca Ndërkombëtare Nr.2932

Asistenca Ndërkombëtare Nr. 2932 mbi “Zhvillimin e Planit të menaxhimit të integruar për Qendrat Historike Berat – Gjirokastrë” është aprovuar nga Qendra e Trashëgimisë Botërore (QTB) në vitin 2019. Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka dakordësuar termat e kontratës me vlerë **30,460\$** dhe ka firmosur kontratën me QTB-në. Projekti parashikohet të zhvillohet gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 dhe do të përfshijë angazhimin e 2-3 ekspertëve ndërkombëtarë nga ICOMOS dhe ICCROM, të cilët do të kontraktohen nga QTB.

Raportet mbi gjendjen e konservimit të siteve të pasurisë Botërore - Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Liqenit të Ohrit

Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka qenë pjesë e grupit teknik për organizimin dhe pritjen e Misionit të përbashkët reaktiv të monitorimit për Trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të liqenit të Ohrit. Misioni u zhvillua në janar 2020 dhe përbëhej nga tre ekspertë ndërkombëtarë, përkatësisht nga IUCN, ICOMOS dhe QTB. Misioni konsistoi në takime me të gjitha palët e interesit si dhe vizita në terren për të verifikuar të gjitha çështjet e përmendura në Vendimin e Komitetit të

Trashëgimisë Botërore. Shteti palë ka marrë raportin e Misionit në dhjetor 2020 dhe priten komente deri në datën 15 janar 2021.

Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka qenë pjesë gjithashtu e hartimit të raportit për gjendjen e konservimit të pasurisë botërore "Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Liqenit të Ohrit" në përgjigje të Vendimit 43 COM 8B.9 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore. Raporti është dorëzuar nga ana e shtetit palë nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit dhe Ministrisë së Kulturës, brenda datës 1 shkurt 2020.

📁 Raportet mbi gjendjen e konservimit të siteve të pasurisë Botërore – Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë

Gjatë vitit 2020, IKTK-ja ka qenë pjesë e grupit teknik për hartimin e raportit për gjendjen e konservimit të qendrave historike Berat dhe Gjirokastrë. Raporti hartohet bazuar në Udhëzuesin Operacional dhe në përgjigje të Vendimit 43 COM 7B.79 të komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe është dorëzuar brenda datës 1 dhjetor 2020.

📁 Digjitalizimi i Arkivës teknike të IKTK-së

IKTK-ja do të jetë përfituese e digjitalizimit të arkivit teknik nëpërmjet projektit *“Digjitalizimi i arkivit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokollit për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence”*, i cili financohet nga Qeveria Zviceriane, në kuadër të Fondit të Emergjencës për Trashëgiminë. Fondi prej **80,000 \$** do të menaxhohet dhe prokurohet nga zyra e UNESCO-s në Venecia me koordinimin e IKTK-së. Zbatimi i projektit do të vijojë gjatë vitit 2021 nga IKTK-ja.

Gjatë vitit 2020 është ngritur me Urdhër Nr. 1778, datë 28.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të IKTK-së grupi i punës për mbarëvajtjen e projektit. IKTK-ja është angazhuar për përgatitjen e materialeve bazë mbi raportin e gjendjes ekzistuese të arkivës dhe nevojave, legjislacionit përkatës, termat e referencës për pajisjet e nevojshme dhe termat e referencës për hartimin e databazës.

Aktualisht janë blerë pajisjet për procesin e digjitalizimit, pajisje të cilat kompletojnë sektorin e arkivës teknike të IKTK-së, si dhe është duke u punuar me aplikacionin “soft” të databazës së arkivit.

2. Bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, AADF

📁 Plani i Menaxhimit të Integruar (PMI) të Zonës Arkeologjike “A” & “B”, Durrës

Ky projekt zhvillohet në kuadër të *Memorandumit të Mirëkuptimit* për "Planin e Menaxhimit të Integruar të Zonës Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit" si dhe krijimin e "Zonës TID Durrës", të lidhur në datën 9 qershor 2020 midis Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Durrës dhe partnerit strategjik AADF.

Ky do të jetë plani i parë i menaxhimit të sitit dhe synon të mbulojë një periudhë kohore 7-vjeçare, si dhe të ofrojë rekomandime për vizionin afatgjatë të sitit. PMI-ja do të hartohet sipas kuadrit të përcaktuar në Termat e Referencës të hartuar nga AADF-ja ku IKTK-ja dhe MK-ja kanë dhënë kontributin e vet dhe i kanë miratuar paraprakisht, si dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke përfshirë Ligjin Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Vendimin e Këshillit

të Ministrave Nr. 169, datë 20.02.2020 për "Qëllimin, Strukturën, Përmbajtjen, Metodologjinë e Zhvillimit dhe Procedurën e Diskutimit Publik të Planeve të Menaxhimit për Pasurinë Kulturore të Paluajtshme", Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 786, datë 26.12.2018, "Për Shpalljen e Zonave Arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe plani për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre".


Qëllimi i përgjithshëm i planit të menaxhimit të integruar është të përmirësojë mbështetjen për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore në qytetin e Durrësit duke e bërë atë më të dukshëm për publikun vendas dhe vizitorët, si dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik vendas.

Përfituesit: Ministria e Kulturës dhe Bashkia Durrës.

IKTK-ja, si përfaqësues i përfituesit, ofron asistencë teknike gjatë gjithë fazave të projektit dhe ndjek procedurat deri në miratimin e tij.

➤ *Aktualisht:*

Pas miratimit të Termave të Referencës me *vendim KKTKM Nr. 252, dt.29.07.2020*, AADF-ja ka vijuar me kontraktimin e konsulentit "A.R.S. Progetti S.P.A." dhe konsulentë z. Neritan Ceka dhe z. Luan Përzhita për hartimin e PMI të zonës Arkeologjike A dhe B Durrës. Nga konsulenti është hartuar Inception Report – Raporti paraprak mbi PMI, ku IKTK-ja ka ofruar asistencën e saj, ka ofruar informacione mbi gjendjen aktuale të sitit dhe projektet paralele të zhvilluara në të, si dhe ka kontribuar me komente në dokumentin e hartuar.



📁 **Projekti "Restaurimi dhe Rikualifikimi Urban i Parkut Arkeologjik Durrës" – TID Durrës**

Ky projekt gjithashtu zhvillohet në kuadër të *Memorandumit të Mirëkuptimit* për Planin e Menaxhimit të Integruar të Zonës Arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit si dhe krijimin e Zonës TID Durrës, të lidhur në datën 9 qershor 2020 midis Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Durrës dhe partnerit strategjik AADF.


Qëllimi kryesor i projektit është "restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës së ardhshme TID Durrës", e cila ndodhet brenda zonës arkeologjike A të qytetit të Durrësit. Nëpërmjet restaurimit, konservimit, rehabilitimit dhe rikualifikimit të të vendbanimeve tradicionale dhe i zonave të trashëgimisë kulturore do të rritet turizmi dhe si rrjedhojë zhvillimi ekonomik i zonës.

Përfituesit: Ministria e Kulturës dhe Bashkia Durrës.

IKTK-ja, si përfaqësues i përfituesit, ofron asistencë teknike gjatë gjithë fazave të projektit dhe ndjek procedurat deri në miratimin e tij.

➤ *Aktualisht:*

AADF-ja ka hartuar Termat e Referencës për këtë shërbim, të cilat janë miratuar paraprakisht nga IKTK-ja dhe Ministria e Kulturës dhe KKTKM me vendim Nr.208, dt.02.07.2020. AADF-ja ka vijuar me kontraktimin e konsulentit "Illyrian Consulting Engineers", "Studio Amatti Architetti" dhe "Architectural Gate", të cilët kanë hartuar "Pre-Feasibility Study TID Durrës", produkt për të cilin IKTK-ja ka kontribuar me materiale dhe komente, si dhe po vijon me hartimin e projektit.



📁 **Plani i Menaxhimit të Integruar (PMI) i Parkut Kombëtar të Butrintit**

Procesi i hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit ka filluar në vitin 2018 me financim të Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe do të përgatitej nga kompania britanike Prince + Pierce në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e tjera partnere si IKTK, AKZM, Instituti i Arkeologjisë, AdZM Vlorë, Porti i Sarandës, agjenci dhe udhërrëfyes turistikë, si dhe përfaqësues të komunitetit lokal.

PMI Butrint 2020-2030 u hartua në referencë të plotë me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (27/2018), Ligjin për Zonat e Mbrojtura (81/2017) dhe strategji të ndryshme zhvillimi të miratuara nga shteti shqiptar. Plani është në përputhje me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe me rekomandimet e Vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe organeve këshillimore të Qendrës së Trashëgimisë Botërore/UNESCO.

Qëllimi në terma afatgjatë është që ky dokument të ofrojë një qasje të re në sitet e trashëgimisë kulturore në vend, duke adresuar çështjet që lidhen me kufizimet e instrumenteve të menaxhimit, zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e turizmit kulturor, ngritjen e kapaciteteve në menaxhim dhe qasjen ndaj komuniteteve lokale.

Përfituesit: Ministria e Kulturës, Bashkia Sarandë, Parku Kombëtar i Butrintit.

IKTK-ja, si përfaqësues i përfituesit, ka ofruar asistencë teknike gjatë gjithë fazave të projektit dhe ka ndjekur procedurat deri në miratimin e tij.

➤ *Aktualisht:*

Pas miratimit të Termave të Referencës, AADF-ja kontraktoi konsulentin kompaninë britanike Prince + Pierce për hartimin e PMI, plan i cili pas konsultimeve teknike me të gjithë partnerët, UNESCO-n, si dhe konsultimit publik, mori miratimin në datën 22 korrik 2020 nga Qeveria Shqiptare.



📁 **Njësia për Digjitalizimin e Trashëgimisë Kulturore**

Në vijim të *Memorandumit të Mirëkuptimit* ndërmjet AADF-së dhe Ministrisë së Kulturës për ngritjen e Njesisë për Digjitalizimin e Trashëgimisë Kulturore në kuadër të projektit të financuar nga AADF “Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë, për një qasje më të gjerë për të gjithë” 2019, u hartua projekti për rikonstruksionin e njësisë së digjitalizimit në ambientet e godinës së ish-Kinostudios, nga studio e licesuar në restaurim "Atelier 4".

Qëllimi është ngritja e një zyre për digjitalizimin e koleksioneve muzeale dhe trashëgimisë kulturore, me hapësirë të dedikuar, pajisje teknologjike të standardeve të larta dhe personel të kualifikuar.

AADF-ja financoi gjithashtu zbatimin e punimeve gjatë vitit 2020 me vlerë **7.371.226,2 lekë (pa TVSH)**. Me rikonstruksionin e objektit është rritur siguria ndaj zjarrit, siguria në përdorim, siguria ndaj zhurmave si dhe krijimi i kushteve hermetike të zhurmave në objekt.

Mbikëqyrja e punimeve është kryer nga IKTK-ja dhe AADF-ja.

➤ *Aktualisht:*

Njësia e digjitalizimit funksionon si sektor i IKTK-së.

Parkimi nëntokësor dhe rijetëzimi i sheshit Çerçiz Topulli në Pazarin e Gjirokastrës

Në kuadër të projektit TID Gjirokastra dhe të Programit të Sipërmarrjes, AADF-ja po punon për shndërrimin e Rajonit të Gjirokastrës në një destinacion turistik të zhvilluar, përmes modeleve të zhvillimit të turizmit, të larmishme dhe të qëndrueshme, me qëllim rritjen e numrit të turistëve në zonë dhe në destinacionet e tjera të afërta lokale. Për të përballuar kërkesën në rritje për parkim si pasojë e rritjes së turizmit në Gjirokastrë veçanërisht në muajt e sezonit turistik, është e nevojshme të sigurohen hapësira jashtë rrugës, në afërsi të zonave më të vizituara, ku drejtuesit të mund të arrijnë sa më shpejt në destinacionin e dëshiruar.

Hartimi i projektit u realizua me investim të AADF-së dhe konsulent Dea studio. Gjatë hartimit të projektit, parimi kryesor ishte ruajtja e vlerave universale të qendrës historike të Gjirokastrës, si një zonë e trashëgimisë botërore, e mbrojtur nga UNESCO. Projekti u miratua me vendim KKTKM Nr. 302 datë 21.08.2020

Objektivi kryesor i projektit është rivitalizimi i sheshit të Çerçizit, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i fasadës së Hotel Çajupit dhe ndërtimi i parkimit nëntokësor në sheshin Çerciz Topulli, për të akomoduar dhe ndihmuar menaxhimin e rritjes së flukseve turistike, njëkohësisht duke sjellë koherencë në hapësirat urbane pa ndryshuar trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës.

➤ *Aktualisht:*

Ka filluar zbatimi i punimeve për rijetëzimin e sheshit dhe ndërtimin e parkimit me investim të FSHZH-së, me fond rreth **419 milionë lekë**.

3. Memorandum Mirëkuptimi me CHwB

Memorandumi i mirëkuptimit mbi Kurse profesionale në Teknika Tradicionale në Ndërtim nënshkruar fillimisht në vitin 2017 dhe i rinovuar në mënyrë të përvitshme, ka për qëllim zhvillimin e trajnimeve për aftësimin në ndërhyrje në ndërtime të trashëgimisë kulturore, ruajtja e mjeshtërive dhe teknikave tradicionale, kualifikimi i personave që zhvillojnë aktivitet në këtë fushë, rritja e cilësisë së punimeve si dhe pajisja me më shumë mundësi punësimi për të rinjtë dhe emigrantët që vendosin të kthehen për të punuar dhe jetuar në Shqipëri. Gjatë vitit 2020, Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në datë 09.06.2020 midis organizatës Trashëgimia Kulturore pa kufij, Shqipëri (CHwB Albania), Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Stiliano Bandilli” Berat. Ky memorandum përfshin periudhën qershor-dhjetor 2020, që përkon me fazën e pestë të Programit për Aftësimin Profesional në Ndërtime Tradicionale.

4. Bashkëpunimi me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA)

Marrëdhëniet e bashkëpunimit me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, vijnë në kuadër të *Protokollit të Bashkëpunimit* për Projektimin dhe Restaurimin e Monumenteve Kulturore në Shqipëri, firmosur në datë 16.02.2010 midis Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve së Republikës së Shqipërisë, Institutit të Monumenteve të Kulturës sot IKTK, Kryesisë së Administratës Turke për zhvillim dhe Bashkëpunim e Kryeministrisë së Republikës së Turqisë (TIKA) dhe Komunitetit Mysliman i Republikës së Shqipërisë, me qëllim forcimin e lidhjeve historike tradicionale si dhe zhvillimin e mundësive të bashkëpunimit teknik.

Zbatimi i këtij bashkëpunimi fillon në vitin 2012 me hartimin e projekteve të restaurimit dhe më tej me zbatimin e punimeve të tyre për objektet e kultit Mysliman: Xhamia e Plumbit në Berat; Xhamia e

Iljaz Bej Mihrahorit në Korçë; Xhamia e Nazireshtë në Elbasan. Restaurimi i objekteve përfundoi në vitin 2014.

Në vitin 2014 nga TIKA u vijua me hartimin e projekteve të pesë objekteve të kultit mysliman:

- Xhamia e Et'hem Beut, Tiranë;
- Xhamia e Pazarit, Gjirokastër;
- Xhamia e Beqarëve, Berat;
- Xhamia Mbret, Berat;
- Teqeja e Helvetive, Berat.

Gjatë procesit të hartimit të projekteve ka patur një bashkëpunim të ngushtë midis specialistëve të IKTK-së dhe projektuesve nga shteti turk për mbledhjen e materialeve, studimin dhe përshtatjen e zgjidhjeve të duhura në zbatim të legjislacionit për trashëgiminë në fuqi. Procesi u finalizua me miratimin e projekteve në KKR.

Zbatimi i projekteve filloi në vitin 2018, me financim të TIKA-s. Gjatë procesit të zbatimit ka patur një sërë problematikash të cilat me bashkëpunimin e përfaqësuesve të dy palëve janë zgjidhur dhe procesi ka ecur përpara. IKTK-ja është pjesë e procesit të mbikëqyrjes së punimeve të restaurimit.

Me Vendim Nr. 331, datë 14.09.2020 të KKTKM është miratuar “*Projekt-Ide për rehabilitimin e Qendrës Mesjetare, Berat*”, financuar nga TIKA, hartuar nga Shoqëri Turke.

Informacion i detajuar për projektet e hartuara në kuadër të këtij partneriteti, paraqitet në Kapitullin IV, pika 4.

5. Protokoll Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Turqisë

Puna për hartimin dhe finalizimin e Protokollit të Bashkëpunimit për zbatimin e projektit: "Restaurimi i xhamisë së Plumbit dhe ndërtimi i një sistemi pilotash për mbrojtjen nga ujrat", Shkodër, Shqipëri, është ndjekur përgjatë vitit 2020 nga ana e grupit teknik të konsultimit ku IKTK-ja ka qenë pjesë. Projekti “Restaurimi i Xhamisë së Plumbit, Shkodër”, hartuar nga Ecolimarlik dhe investitor Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve Turqi është miratuar në KKR me Vendim Nr.29, datë 10.01.2018. Gjatë vitit 2020 është finalizuar dhe dakordësuar me palën turke Protokollin i cili është ndjekur më pas nga ana e Ministrisë së Kulturës për procesin e nënshkrimit të parashikuar në kuadër të vizitës zyrtare të Kryeministrit dhe disa Ministrave në Turqi në datë 6.01.2021.

Në vijim të këtij Protokollin gjatë vitit 2021 planifikohen të vijojnë të gjithë procedurat e miratimit sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit:

- Rishikim i projektit për evidentimin e gjendjes ekzistuese dhe nevojën për ndërhyrje shtesë;
- Aplikim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- Aplikim në Institutin e Ndërtimit për oponencën teknike;
- Aplikim për Leje Infrastruktura dhe Ndërtimi pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).

6. *Bashkëpunimi me Kishën Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë (KOASH)*

IKTK-ja prej vitesh ka bashkëpunuar me Kishën Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e objekteve të kultit.

Informacion i detajuar për projektet e hartuara në kuadër të këtij partneriteti, paraqitet në Kapitullin IV, pika 5.

7. *Bashkëpunimi me Trans Adriatic Pipeline AG (TAP)*

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, TAP ka lidhur kontratën me studion projektuese « Atelier 4 » për shërbimin « *Hartimi i Projektit të Detajuar për Restaurimin, Rikonstruksionin dhe Rimobilimin e Sallës së Koncertit në Universitetin e Artit në Tiranë* ». Ky projekt është miratuar me Vendim KKTKM Nr. 356, datë 15.10.2020.

8. *Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT)*

Në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, gërma « ë », KKTKM-ja ka kompetencë: “*Të miratojë, të vlerësojë në parim planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore*”.

IKTK-ja merr pjesë në çdo takim apo forum të bashkërendimit të planifikimit në nivel qendror. Pas korrespondencës me AKPT-në, ku dërgohen komente apo sugjerime nga ana e IKTK-së në rastet e hartimit të PPV, PDV, PDyV dhe PDZRK, plane të cilat përfshijnë zona të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, këto plane miratohen në parim nga KKTKM.

▪ PDyV Durrës

Ministria e Kulturës në bashkëpunim me AKPT, kanë hartuar termat e referencës për: “*Shërbim Konsulencë për Hartimin e Planit të Detyruar Vendor (PDYV) për Zonën e Re të Zhvillimit , Zona 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës*”. Kufiri i zonës përfshin një ndër hapësirat më të rëndësishme arkeologjike, arkitektonike dhe historike të qytetit të Durrësit, e cila pësoi dëmtime të konsiderueshme nga tërmeti. Siti i propozuar për rehabilitim ndodhet brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit. Gjithashtu brenda kësaj zone ndodhen disa nga pasuritë kulturore më të rëndësishme kombëtare, si Parku Arkeologjik i Durrësit me Amfiteatrin, Muret e Kalasë, Termat Antike dhe Rotondën, si dhe monumente të kategorisë së parë si Hamami, Xhamia e Fatihut, Pusi i Tophanës, Ndërtesa me Mozaik, e disa banesa të rëndësishme si ajo e Fan Nolit, Aleksandër Moisiut dhe e familjes Manushi e Pali.

Objekti kryesor që kërkohet të arrihet është propozimi për hartimin e një plani të detyruar dhe detajuar për zonën, i cili ka si qëllim përfundimin e një plani të qëndrueshëm për bashkëjetesën harmonike mes trashëgimisë unike të Durrësit dhe vendbanimit në të, si një domosdoshmëri jetike. Ky plan ka për qëllim rindërtimin e objekteve të banimit të dëmtuara nga tërmeti, rikuperimin e dëmeve që kanë pësuar elementë të trashëgimisë kulturore materiale, mbrojtjen e tyre

nga dëmtime të mundshme në të ardhmen dhe gjithashtu rikualifikimin e hapësirës përreth elementëve të trashëgimisë dhe në mënyrë të posaçme përreth Amfiteatrit të Durrësit dhe përcaktimi i kufirit të zonës për rijetëzim, vlerësimin e impaktit ekonomik dhe social të pritshëm, akomodimin brenda zonës të familjeve që mund të zhvendosen për shkak të rijetëzimit.

Hartimi i PDyV-së do ndihmojë gjithashtu edhe hartimin e Planit të Menaxhimit të zonës Arkeologjike Durrës A dhe B, i cili do të ketë në fokus integrimin më të mirë mes trashëgimisë dhe aktivitetit njerëzor. Njëkohësisht mbrojtja e të gjithë vlerave që paraqet kjo zonë dhe promovimi i tyre do t'i kthejë ato në vlera me përfitime ekonomike sidomos për komunitetin lokal, ashtu si ndodh në të gjitha qytetet europiane apo edhe të largëta me pasuri kulturore të ngjashme, të cilat janë kthyer në motorin ekonomik të tyre. Rikualifikimi urban i zonës pritet të ketë një impakt social dhe ekonomik të konsiderueshëm për qytetin e Durrësit.

Në vijim, është kontraktuar konsulenti “SON Engineering & Construction” për hartimin e PdyV.

9. Bashkëpunimi me Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës – FAU

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në funksion dhe të zbatimit sa më të suksesshëm të “Paktit për Universitetin”, IKTK-ja bashkërendon punën për përcaktimin e temave të diplomave të studentëve të FAU-t nëpërmjet grupeve ndërinstucionale të punës.

IKTK-ja mbikëqyr punën e studentëve të masterit për realizimin e temave të diplomave me qëllim hartimin e projekteve të mirëfillta sipas një liste të objekteve konkrete të trashëgimisë kulturore materiale, të përcaktuara nga grupet ndërinstucionale. Projektet hartohen nën drejtimin dhe koordinimin e stafit të FAU-t me përfshirjen e një restauratori nga ana e IKTK-së. Si çdo vit edhe gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka mbikëqyrur praktikën profesionale të masterit të restaurimit.

IV. AKTIVITETI I IKTK-SË NË PËRPUTHJE ME PLANIN E PUNËS 2020

1. Projekte në kuadër të Programit të Rindërtimit

Me qëllim vlerësimin dhe përbalimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të 26 nëntorit 2019 në Trashëgiminë Kulturore, në fillim të vitit 2020 IKTK-ja ka qenë pjesë e hartimit të “Dokumentit për Vlerësimin e Dëmit dhe Nevojave” – PDNA, Kapitulli për sektorin e Trashëgimisë kulturore. Dokumenti është paraqitur nga ana e Shtetit palë në Konferencën e donatorëve në Bruksel në shkurt 2020. Dokumenti u bazua në databazën dhe raportet përmbledhëse mbi inspektimet, dëmin dhe nevojat pas tërmetit për përgatitjen e të cilëve ka kontribuar IKTK-ja dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë dhe Shkodër. Hartimi i databazës u koordinua nga IKTK-ja në kuadër dhe të Komisionit për Planifikim dhe Parandalim të Emergjencave Civile (ngritur me urdhër të Ministrisë të Kulturës nr. 410, datë 09.07.2019) ku IKTK-ja përfaqësohet me një anëtar. Metodologjia e hartimit të databazës së objekteve në risk ishte përgatitur paraprakisht në: “Plani për Përgatitjen për Emergjencat Civile për IKTK-në” të hartuar në fund të vitit 2019. Ky plan ka për qëllim krijimin e kushteve për të zvogëluar risqet e fatkeqësive duke filluar nga parandalimi, përgatitja, përbalimi i fatkeqësive dhe rimëkëmbja.

Në vijim të Konferencës së Donatorëve, trashëgimisë kulturore iu akorduan fonde për rimëkëmbje nëpërmjet programeve të ndryshme si: Programi “EU4CULTURE” me njësi zbatuese UNOPS-in, Fondi Amerikan i Ambasadorit me njësi zbatuese organizatën jofitimprurëse CHwB, Heritage Emergency Funds – Ambasada Zviceriane me njësi zbatuese UNESCO-n, programe në të cilat IKTK-ja koordinon dhe ndjek procesin e rimëkëmbjes dhe ofron asistencë teknike deri në përfundim të procesit.

Në kuadër të Programit të rindërtimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 213, datë 11.03.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, IKTK-ja u caktua si **njësi zbatuese** për administrimin e fondit në vlerën **236 627 069 lekë pa TVSH**, për restaurimin/rindërtimin e pasurive kulturore në njësitë territoriale të bashkive Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Rrogozhinë e Vorë.

Në referencë të VKM nr.425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, të ndryshuar”, IKTK ka zhvilluar procesin e konkurrimit publik për hartimin e projekteve të restaurimit. Pas përfundimit të procedurës janë nënshkruar kontratat me operatorët fitues.

Me shkresën Nr. 2203 Prot., datë 28.10.2020 i janë dërguar për publikim Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin “Formularët e Njoftimit të kontratës së nënshkruar”, për secilën nga procedurat.

Tab. 5 - Kontratat e shërbimit të lidhura ndërmjet IKTK-së dhe operatorëve fitues.

Nr.	Prokurim me konkurim publik me objekt	Kontratë shërbimi	Ndërmjet
1	Hartim projekti: <i>“Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 4 objekte kulti pasuri kulturore”</i>	Nr. 1815/11 Prot., datë 09.10.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE “Focus Architecture” shpk, “Ave Consulting” shpk, “Comfort 96” shpk, “AR-MI Projektim Mbikëqyrje” shpk, “A.L.T.E.A. & Geostudio 2000” shpk.
2	Hartim projekti: <i>“Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 8 objekte pasuri kulturore dhe muze në Bashkinë Durrës”</i>	Nr. 1731/6 Prot., datë 09.10.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE “A& E Engineering” shpk, “SON Engineering & Construction” shpk, “Geo - Eng” shpk, “Fusha” shpk
3	Hartim projekti: <i>“Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 5 objekte pasuri kulturore”</i>	Nr. 1814/11 Prot., datë 09.10.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE “Focus Architecture”, “Ave Consulting”, “Comfort 96”, “AR-MI Projektim Mbikëqyrje” shpk, “A.L.T.E.A. & Geostudio 2000” shpk.
4	Hartim projekti: <i>“Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilituese në 9 objekte institucione publike në Bashkinë Tiranë”</i>	Nr. 1770/6 Prot., datë 09.10.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE “IRI” shpk, “Archispace” shpk, “Fusha” shpk
5	Hartim projekti: <i>“Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 12 objekteve në Bashkinë Tiranë, Krujë, Lezhë, Kavajë, Mirditë”</i>	Nr. 1734/6 Prot., datë 09.10.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE “Gjeokonsult & Co” shpk, “Arifaj” shpk.
6	<i>Hartimi i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 Zonat e Reja të Zhvillimit</i>	Nr. 1819/11 Prot., datë 29.09.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE shoqëria “Met-Engineering shpk”, subjekti Taulant Rama dhe Skënder Muçaj.
7	<i>Kryerja dhe Hartimi i Raporteve të Sondazheve Arkeologjike në 2 Zonat e Reja të Zhvillimit”</i>	Nr. 1819/11 Prot., datë 29.09.2020	IKTK-së si Autoritet Kontraktor dhe BOE shoqëria “Met-Engineering shpk”, subjekti Taulant Rama dhe Skënder Muçaj.

Me anë të shkresës Nr. 2192 Prot., datë 27.10.2020 IKTK-ja i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me kërkesën për miratim ndryshimi të pjesshëm të objekteve pasuri kulturore të Konkurrimit Publik, në kuadër të procesit të rindërtimit. Kjo kërkesë erdhi pasi në muajin shtator 2020 IKTK-ja u vu në dijeni nga subjekti CHëB Albania për objektin e donacionit të katër objekteve pasuri kulturore të cilat mbivendoseshin me objektet pjesë të procedurës së konkurrimit


publik të realizuar nga IKTK-ja dhe tashmë të kontraktuara. Në tetor 2020 nga CHëB Albania u komunikua harta dhe pozicionimi i saktë i objekteve në terren, subjekt i donacioneve. Në vijim, me qëllim evitimin e mbivendosjes së projekteve, si dhe në kushtet ku IKTK-ja ka evidentuar dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente është kërkuar ndryshimi i këtyre objekteve me të tjera për të cilat nevojiteshin të njëjtat ndërhyrje dhe të njëjtat fonde financiare.

Në zbatimin të VKM Nr. 213, datë 11.3.2020, u lidhën kontrata në vlerën **219,074,800 lekë** - 93% të planit (fondit të çelur), nga të cilat u realizuan 87% të fondeve të prokuruar.

Tab. 6 - Të dhënat tabelare mbi zbatimin dhe realizimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020:


Nr.	Artikulli	Objekti	Produkti	Plan Buxhet	Kontrata e lidhur	Realizimi
1	230	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 4 objekte kulti pasuri kulturore"	Projekt	6,461,526	6,000,000	4,600,000
2	230	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 8 objekte pasuri kulturore dhe muze në Bashkinë Durrës"	Projekt	42,001,008	42,000,000	34,000,000
3	230	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 5 objekte pasuri kulturore"	Projekt	95,400,138	92,500,000	73,000,000
4	230	Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 9 objekteve institucione publike në Bashkinë Tiranë"	Projekt	29,719,504	29,422,600	29,422,600
5	230	Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 12 objekteve në Bashkinë Tiranë, Krujë, Lezhë, Kavajë, Mirditë"	Projekt	23,918,408	23,700,000	23,700,000
6	230	Hartimi i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 Zonat e Reja të Zhvillimit	Raport Vëzhgimi	8,010,911	7,983,500	7,983,500
7	230	Kryerja dhe Hartimi i Raporteve të Sondazheve Arkeologjike në 2 Zonat e Reja të Zhvillimit	Raport Sondazhe arkeologjike	17,593,824	17,468,700	17,468,700
8	230	Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 Zonat e Reja të Zhvillimit	Monitorime	13,521,750	-	-
TOTALI				236,627,069	219,074,800	190,174,800

Tab. 7 - Grafiku mbi zbatimin dhe realizimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020:



Në mbështetje të Ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe në zbatim të VKM-së nr. 213, datë 11.03.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, në pikën 3 të të cilit citohet: **“Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara, pas përfundimit të procedurave në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës”**, është kërkuar që fondet në nivel projekti, në vlerën prej **45,784,422 lekë**, të cilat kanë rezultuar të pashpenzuara në mbyllje të vitit 2020 të transferohen për vitin buxhetor 2021.

Bazuar në Termat e Referencës për 5 Kontratat e Shërbimit, të hartuara nga IKTK-ja dorëzimi i projektit u konceptua në katër Detyra (dorëzime):



Nga ana e operatorëve për secilën kontratë janë dorëzuar të 4 fazat. IKTK-ja ngriti grupin e punës për ndjekjen e procedurave deri në miratim të projekteve dhe marrjen në dorëzim të tyre.

Faza 3 dhe Faza 4 kanë marrë miratimin në KKTKM në muajin dhjetor 2020 (referoju Shtojcës 2 për vendimet e KKTKM).

Tab. 8 - Tabela e projekteve të miratuara nga Programi i Rindërtimit

Nr.	Objekti	Bashkia
1	Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras	Kurbin
2	Kisha e Manastirit të Rubikut	Mirditë
3	Ish Arqipeshkëvia e Durrësit në Delbnisht	Kurbin
4	Hamami në oborrin e Shkollës “16 Shtatori”	Durrës
5	Muzeu Arkeologjik	Durrës
6	Banesa e “A. Moisiu”-Muzeu Etnografik	Durrës
7	Amfiteatri	Durrës
8	Kalaja e Ishmit dhe banesa pranë mureve të kalasë	Durrës
9	Porto Romano	Durrës
10	Kalaja e Rodonit dhe Kisha e Shna Ndout në Kepin e Rodonit	Durrës
11	Ura e Kurcajt në përroin e Zerzës	Krujë
12	Kalaja e Bashtovës	Rrogozhinë
13	Kalaja e Lezhës - Park arkeologjik	Lezhë
14	Kalaja e Krujës (Kulla e Sahatit dhe muret e fortifikimit)	Krujë
15	Godina e “Vettingut” (Ish Lidhja e Shkrimtarëve), Kodi (II-085)	Tiranë
16	Qendra Kulturore për Zhvillimin e Fëmijëve (ish -Rekuizita)	Tiranë
17	Arkiva Teknike e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	Tiranë
18	Akademia Kombëtare e Shkencave, Kodi (II-044)	Tiranë
19	Godina e Ish të përndjekurve politikë, Kodi (II-049)	Tiranë
20	Arkiva Qendrore Shtetërore e Filmit	Tiranë
21	Biblioteka Kombëtare "Fondi"	Tiranë
22	Teatri i Kukullave, Kodi (I-16)	Tiranë
23	Godina e Ish Kinostudios	Tiranë

24	Muzeu Etnografik	Krujë
25	Banesa e Mlikajve, Muzeu Etnografik	Lezhë
26	Banesa e "Arkaxhijve" - Muzeu Etnografik Kavajë	Kavajë
27	Galeria Kombëtare e Arteve	Tiranë
28	Biblioteka Kombëtare	Tiranë
29	Muzeu Historik Kombëtar, Kodi (II-084)	Tiranë
30	Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"	Krujë
31	Muzeu Kombëtar i Përgjimeve sekrete "Shtëpia me gjethe", Kodi (II-084)	Tiranë
32	Banesa e Preng Lleshit, Mashtërkore	Mirditë
33	Godina ku kishte selinë "Organizata Bashkimi", Kodi (I-13)	Tiranë
34	Banesa e Ahmet Çunit, Murrizë	Tiranë
35	Banesë Kolektive 2-kat, Rr.Tefta Tashko, Kodi (II-199)	Tiranë

2. Projekte me Partnerin Cultural Heritage without Borders (CHwB)

IKTK-ja është duke bashkëpunuar me partnerin CHwB, në kuadër të programit Fondi i Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore për zbatimin e ndërhyrjeve konservuese/restauruese të fortifikimeve në Krujë, Durrës, dhe Prezë, të cilat u dëmtuan nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

Në vijim të gjendjes emergjente të shkaktuar si pasojë e tërmetit dhe dëmtimeve të objekteve që pasuan lëkundjet sizmike, IKTK-ja realizoi menjëherë inspektime në objektet më të dëmtuara, si dhe hartoi projektet e stabilizimit emergjent për Kullën C në Kalanë e Durrësit, Kullën e Sahatit Prezë, Kullën e Sahatit Krujë, Teqen e Dollmës Krujë, Muret perimetrale të kalasë së Prezës dhe Krujës. IKTK-ja në bashkëpunim me DRTK Tiranë morrën masat për realizimin e rievimit me dron në të tre kalatë e sipërpërmendura, material i cili shërbeu për **hartimin e projekteve të ndërhyrjeve emergjente** nga IKTK-ja. CHwB në bashkëpunim me IKTK-në hartoi projektin për stabilizim emergjent në kalanë e Durrësit (Kulla C). Projektet për stabilizimin emergjent janë shqyrtuar dhe miratuar në KKTKM si më poshtë:

Projekt "Ndërhyrje emergjente për stabilizimin e Kullës së Sahatit dhe Rotonda Nr.2, Kalaja Prezë", hartuar nga IKTK miratuar me Vendim Nr.13, datë 07.01.2020.

Miratim i masave paraprake për detajimin e ndërhyrjeve në objektin "Kulla C", Durrës, pas tërmetit në nëntor 2019, bashkëpunim i CHwB-së me IKTK, miratuar me Vendim Nr.15, datë 07.01.2020.

Projekt "Kulla e Sahatit në Kalanë e Krujës", (faza e parë, punime emergjente), hartuar nga IKTK, miratuar me Vendim Nr. 12, datë 07.01.2020.

Projekt "Ndërhyrje emergjente pajantimi i Teqesë së Dollmës", Krujë, hartuar nga IKTK miratuar me Vendim Nr.14, dt. 07.01.2020.

Nga ana e MK-së dhe IKTK-së janë marrë masa për angazhimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në vlerësimin e qëndrueshmërisë së terrenit shkëmbor poshtë Kullës së Sahatit të Krujës që paraqet

rrezikshmëri për shkepÛtje të masivit dhe është **hartuar raporti gjeologjik për kalanë e Krujës** nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Me mbështetjen financiare të Fondit të Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore parashikohet të realizohet konsolidimi strukturor dhe restaurimi i plotë i objekteve të klasifikuara si objektet më të dëmtuara nga fatkeqësia, fond i cili do të menaxhohet nga CHwB dhe do të monitorohet nga IKTK-ja. Ndërkohë për punimet për stabilizim emergjent në përputhje me projektet e hartuara nga IKTK-ja dhe CHwB, është aprovuar mbështetje financiare nga Prince Claus Fund.

Nga ky fond është realizuar gjatë vitit 2020 stabilizimi emergjent i Teqes së Dollmës, Krujë dhe Kullës C Durrës, nën mbikëqyrjen e IKTK-së.

Tab. 9 - Tabela me statusin aktual të projekteve në bashkëpunim me CHwB

KONSERVIM		DONATOR	STATUSI
Kulla C - Durrës			
D1	Faza 1 - Stabilizim Emergjent	SWEDEN	Përfunduar
D2	Faza 2 - Hartimi i projektit të konservimit	SWEDEN	Proces
D3	Faza 3 - Zbatimi i ndërhyrjeve konservuese	US EMBASSY	Për 2021
Teqja e Dollmës - Krujë			
KT1	Faza 1 - Stabilizim Emergjent	PRINCE CLAUS	Përfunduar
KT2	Faza 2 - Hartimi i projektit të konservimit	PRINCE CLAUS/CHWB	Përfunduar
KT3	Faza 3 - Zbatimi i ndërhyrjeve konservuese	US EMBASSY	Për 2021
Kulla e Sahatit - Krujë			
KC0	Faza paraprake - Stabilizim i shkëmbit	TBD / GoA	Në proces
KC1	Faza 1 - Stabilizim Emergjent	TBD / GoA	Në proces prokurimi
KC2	Faza 2 - Hartimi i projektit të konservimit	SWEDEN	Për 2021
KC3	Faza 3 - Zbatimi i ndërhyrjeve konservuese	US EMBASSY	Për 2021
Kulla dhe Muri Fortifikues - Prezë			
P1	Faza 1 - Stabilizim Emergjent	PRINCE CLAUS	Në proces prokurimi
P2	Faza 2 - Hartimi i projektit të konservimit	SWEDEN	Për 2021
P3	Faza 3 - Zbatimi i ndërhyrjeve konservuese	US EMBASSY	Për 2021

3. Projekte me Fonde të BE-së nëpërmjet instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit IPA ku IKTK merr pjesë në cilësinë e Partnerit në Projekte

📁 Projekti **3D-IMP-ACT** “*Virtual reality and 3D experiences to IMProve territorial Attractiveness, Cultural heritage smart management and Touristic development*” në kuadër të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi,

Periudha e zbatimit: prill 2018 – dhjetor 2020.

Gjatë vitit 2020, i cili ishte viti përmbyllës i projektit 3D-IMP-ACT, nga ana e IKTK-së është ndjekur mbarëvajtja e projektit dhe është punuar për realizimin e prokurimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në objektivat e projektit si më poshtë:

Prokurime të realizuara:	Shërbim Konsulence Ekspert Financiar	Eksperti financiar kontraktohet për realizimin e procedurave të prokurimit në bazë të kushteve PRAG.
	Shërbim Konsulence për realizimin e rikonstruksionit hipotetik 3D të Kalasë së Bashtovës dhe turit virtual	Kalaja e Bashtovës është një nga monumentet e përzgjedhur si raste studimore në kuadër të projektit 3D-IMP-ACT. Shërbimi i konsulencës përfshin dhe pjesëmarrjen e 3 specialistëve nga IKTK, me qëllim marrjen e njohurive bazë mbi realizimin e produktit.
	Prokurimi i Pajisjeve për krijimin e laboratorit për përdorimin e teknologjive 3D në kuadër të projektit 3D-IMP-ACT	Laboratori është një nga produktet kryesore të projektit. Pajisjet konsistojnë në Aparat Fotografik Nikon D850, AGISOFT Metashape 1.6.5, Tablet, Dron DJI Mavic 2, Workstation, Hard disk. Për funksionimin e laboratorit u realizua dhe prokurimi i aksesorëve (çantë për dronin, set me karikues baterie, bateri, helika, çantë për aparatin dhe bateri, karta memorie (3), shkop zgjatues për aparatin fotografik)
Produkte:	Materiale promocionale të komunikimit digjital	Video Promovuese – Monumenti i Agonotetëve – me konceptim, hartim dhe realizim Klodjana Gjata, Era Bushi, Renald Meta, Marsela Plyku Demaj
	Katalog “Apolonia përmes Artit dhe Teknologjisë”.	Katalogu ka për qëllim prezantimin e vizitorëve me koleksionin e muzeut arkeologjik Apoloni dhe produktet e realizuara në kuadër të projektit 3D-IMP-ACT. Produktet konsistojnë në 6 objekte të printuara si kopje 3D të objekteve origjinale, të cilat janë pjesë e koleksionit të MHK-së.
	Fletëpalosje mbi parkun arkeologjik Apoloni	Fletëpalosja përmban informacion hartografik mbi itineraret kryesore për vizitorët në Apoloni si dhe informacion mbi monumentet kryesore. Fletëpalosja shërben dhe për promovimin e projektin 3D-IMP-ACT.
	Rikonstruksioni hipotetik 3D i Kalasë së Bashtovës dhe tur virtual.	Paraqitja 3D e Kalasë së Bashtovës krijon një inventar digjital të saktë i cili është gjithashtu një ndihmë e madhe për rindërtimin hipotetik 3D të këtij monumenti. Përdorimi i rikonstruksionit hipotetik 3D të këtij objekti, si mjet edukimi, do të rrisë ndërgjegjësimin e të gjitha moshave për rëndësinë e trashëgimisë kulturore kombëtare. Do të ndihmojë për zhvillimin e një qasjeje edukimi efikase dhe do të kontribuojë drejtpërdrejt në prezantimin dhe interpretimin e pasurisë kulturore. Synimi kryesor është që Kalaja e Bashtovës të bëhet e prekshme për vizitorët dhe për turistët, të cilët dëshirojnë ta vizitojnë atë. Imazhet e prodhuara nga ky projekt do të jenë pjesë e programeve të promovimit dhe ndërgjegjësimit të IKTK-së në të ardhmen.
	Laborator në ambientet e IKTK-së për teknologjitë digjitale.	Laboratori u ngrit në ambientet e IKTK-së dhe do të shërbejë për punën teknike të stafit mbi dokumentimin dhe rilevimin fotogrametrik të objekteve të trashëgimisë kulturore.

<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">Aktivitetet:</p>	<p>Aktivitet promovues “Preke Trashëgiminë” në datën 29 shtator 2020.</p>	<p>Aktivitet 1-ditor me stafin teknik dhe nxënës nga shkolla nëntëvjeçare e Pojanit, me pjesëmarrje prej rreth 40 personash, organizuar nga IKTK me kontributin e UPT-së dhe ZAKPA Apoloni.</p> <p>Aktiviteti synoi promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjive digjitale në funksion të edukimit cilësor të moshave të reja dhe ndërgjegjësimit të komunitetit. Aktiviteti përfshiu organizimin e një workshop-i me përfaqësues të komunitetit në ambientet e Parkut Arkeologjik Apoloni. Workshop-et me përfaqësues të komunitetit janë pjesë e aktiviteteve të parashikuara në projekt, konkretisht në paketën e punës WP 3.1. Me anë të këtij aktiviteti synohet paraqitja dhe promovimi i produkteve të projektit 3D-IMP-ACT, të cilat do të përfshijnë produkte 3D të riprodhuara nga objekte muzeale të Parkut dhe Muzeut Historik Kombëtar (MHK),</p> <p>Objekte të përzgjedhura në koleksionin e MHK-së (objekte të zbuluara në Apoloni), u skanuan nga një grup i Departamentit të Inxhinierisë Mekanike, UPT (partner në projektin 3D-IMP-ACT) dhe do të printohen në modele në shkallë 3D. Produktet e printuara në modele 3D në shkallë të objekteve origjinale u ekspozuan në stendën e prodhuar në kuadër të këtij aktiviteti dhe do të qëndrojnë në ambientet e Muzeut Apoloni. Produktet i dedikohen aksesit ndaj trashëgimisë kulturore për personat me aftësi të kufizuara në shikim (nëpërmjet prekjes) dhe printimit në alfabetin brail të teksteve shpjeguese. Gjithashtu produktet do t'i shërbejnë dhe publikut të gjerë përmes promovimit të objekteve të zbuluara në Apoloni, por që origjinali i të cilave ndodhet i ekspozuar në MHK.</p> <p>Produkte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6 objekte të skanuara dhe të printuara si kopje 3D në shkallë – UPT, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i prodhim menaxhimit. - Përshkrime në alfabetin brail për 6 objektet e skanuara dhe përshkrime në alfabetin brail për 23 vitrinat e Muzeut arkeologjik të Apolonisë. - Materiale promovuese me logon e projektit 3D-IMP-ACT (çanta, bluza). - Stendë ekspozimi. - Pjesëmarrje në konferencën finale të projektit nga ana e stafit të IKTK-së – 18 dhjetor 2020.
--	---	---

📁 Projekti **3C** “*Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative industries*”, në kuadër të programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020

Periudha e zbatimit: 2019 – 2022

Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka ndjekur procedurat për kalimin e parafinancimit të parë të projektit në llogarinë e dedikuar në bankën e nivelit të dytë. Duke qenë se IKTK-ja ka hasur vështirësi në sigurimin e fondeve të nevojshme, të cilat u bënë efektive vetëm në muajin dhjetor 2020, nuk ka arritur të realizojë procedurat e prokurimit të parashikuara në projekt për këtë vit. IKTK-ja nëpërmjet stafit të caktuar për mbarëvajtjen e projektit ka vijuar me realizimin e objektivave të projektit, duke realizuar procesin e identifikimit të sipërmarrjeve të industrive krijuese të cilat lidhen me trashëgiminë kulturore materiale. Produkti i realizuar është një databazë me emrat dhe kontaktet e siguruar të këtyre sipërmarrjeve. Produkti është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe NGO-ve të cilat kanë patur më parë bashkëpunime me këto sipërmarrje. Gjatë vitit 2020 stafi i IKTK-së gjithashtu është angazhuar me modifikimin e projektit me kërkesë të partnerit lider.

Objektivi i përgjithshëm i projektit, është të kontribuojë në një bashkëpunim më të mirë të zonës për shpërndarjen e produkteve inovative kulturore dhe krijuese përmes Mobilitetit Rajonal të Arteve dhe programit të vizitave dhe platformës së një rrjeti të përbashkët ndërkufitar. Rëndësia qëndron në krijimin e një sinergjie midis këtyre sektorëve dhe fillimin e një platforme të qëndrueshme për bashkëpunim, shkëmbimin e njohurive, informacionit, planeve dhe veprimeve të përbashkëta, në mënyrë që të ndajmë potencialin krijues në të gjithë rajonin.

Projekti prezanton aktivitete të ndryshme, të cilat arrijnë objektivat që kontribuojnë plotësisht në objektivat specifike të Programit. Këto objektiva specifike përfshijnë:

- Vendosja e platformave dhe rrjeteve të bashkëpunimit ndërkufitar në industrinë kulturore dhe krijuese në mënyrë që të zhvillojnë së bashku produktet dhe shërbimet e trashëgimisë kulturore të zonës së synuar.
- Rritja e një niveli dhe cilësia e një mbështetje inovative jo-financiare për ndërmarrjet që merren me kulturën dhe sektorin krijues, përmes Mobilitetit Rajonal të Arteve dhe programit të vizitave

Qëllimi kryesor i projektit është "Rivitalizimi dhe Rikualifikimi i Territorit të Ish-Kinostudios" Shqipëria e Re ", Tiranë, me qëllim:

- Promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të kësaj zone;
- Rritjen e numrit të vizitorëve në park që gjenerojnë të ardhura për parkun;
- Edukimi i të rinjve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit përmes kulturës.

📁 Projekti **Mo.Na** - "*Monuments in Nature: A Creative Co-existence*", në kuadër të programit Interreg Balkan Mediterranean 2014-2020

Periudha e zbatimit: mars 2019 – tetor 2021.

Gjatë vitit 2020, nga ana e IKTK-së është ndjekur mbarëvajtja e projektit dhe është punuar për realizimin e prokurimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në objektivat e projektit si më poshtë:

Prokurime:	<p>Shërbim Konsulence për: (1) Studim për ndikimin e ujërave në rrënoja dhe mozaikë. (2) Raport analizat bio-kimike të ujërave dhe Studim për praninë e ujërave nëntokësorë të ëmbla. Shërbim Konsulence për hartim terma reference për ekspertizën.</p>	<p>Produkte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studim mbi efektin që ujërat dhe drenazhi kanë mbi rrënojat arkeologjike, Butrint. - Studim mbi prezencën e ujërave nëntokësorë dhe Raport analizash bio-kimike të ujërave.
	<p>Komunikim digjital – Materiale promovionale</p>	<p>Produkte:</p> <p>Video promovuese mbi aktivitetin “Rrugëtimi fantastik i Junia Rufinës”.</p>
	<p>Investim</p>	<p>Realizim i Punimeve të restaurimit në Nymfeum, Butrint.</p>
	<p>Materiale promovionale të publikuara</p>	<p>Broshura mbi koleksionin e Muzeut Arkeologjik Butrint. Broshura ka për qëllim të promovojë objektet kryesore të koleksionit të Muzeut Arkeologjik Butrint. Broshura do të shërbejë për vizitorët e shumtë në Butrint për njohjen me vlerat kulturore të Butrintit dhe njëkohësisht për njohjen dhe promovimin e projektit Mo.Na.</p> <p>Broshura mbi portat e Butrintit. Broshura ka për qëllim të ofrojë një itinerar unik të qytetit antik të Butrintit pasuri botërore, nëpërmjet njohjes së portave hyrëse të qytetit. Historiku dhe veçantitë e portave hyrëse në Butrint, materiali hartografik si dhe materiali fotografik ilustrues e plotësojnë broshurën.</p> <p>Fletëpalosje mbi vlerat natyrore dhe kulturore të Butrintit.</p>

Rrëfime/histori - Story telling	<p>Realizim i aktivitetit “Rrugëtimi Fantastik i Junia Rufinës” – 4 tetor 2020, Butrint.</p>	<p>Aktiviteti synon rrëfimin e historisë së Butrintit dhe vlerave natyrore kulturore të sitit nëpërmjet argëtimit dhe lojërave në funksion të edukimit cilësor të moshave të reja dhe ndërgjegjësimit të komunitetit. Aktiviteti përfshin organizimin e një dite në Butrintin antik, ku do të paraqiten me anë të lojërave me role dhe artbërjes: mjeshtëritë, stili i jetesës si dhe vlerat natyrore dhe kulturore të Butrintit. Në bashkëpunim me Zyrën e administrimit koordinimit të Butrintit dhe nën koordinimin e IKTK-së u angazhua stafi i Butrintit, artizanë të ndryshëm lokalë në organizimin e lojës me role. Loja me role u realizua nëpërmjet personazhit të Junia Rufinës si banore e Butrintit në antikitet. Kostumet e roleve u mundësuan nëpërmjet bashkëpunimit me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit (TKOB).</p> <p>Historia ka në qendër të saj një grup adoleshentësh, të cilët improvizojnë në lojën e tyre një itinerar fantastik, duke u zhvendosur në kohë, në periudha të largëta të historisë njerëzore, për të kuptuar më mirë historinë dhe aspekte të jetës të moshatarëve të tyre. Si rrjedhojë, Butrinti përfaqëson për ta një muze në natyrë, që reflekton më qartë pamjen e një qyteti të lashtë, duke trashëguar monumente të shumta dhe pasuri të shumta natyrore, me të cilat të rinjtë janë njohur në bankat e shkollës dhe të cilat kanë ngacmuar vazhdimisht fantazinë e tyre. Protagonisti kryesor i këtij itinerari pagëzohet me emrin e një individi real që ka jetuar në qytetin e Butrintit, me emrin e Junia Rufinës, një vajzë e re nga shtesa e lartë e popullsisë, e cila në Butrint ka lënë gjurmët e saj, nëpërmjet ndërtimit të një vepre hidrike (pus), duke përjetësuar në këtë mënyrë emrin e saj që në shek. II m. Kr. Pikërisht këtu e ka zanafillën rrugëtimi fantastik në qytetin e Butrintit, i cili rijetëzohet dhe rrëfëhet nga Junia Rufina.</p>
Aktivitete	<p>3 Workshope /Takime teknike me partnerë.</p>	<p>Takimet me partnerë janë realizuar online në datat 27 shkurt, 9 korrik, 2 tetor 2020.</p>
Konferenca	<p>2 takime të Këshillit Shkencor të Simpoziumit Ndërkombëtar të projektit Mo.Na</p>	<p>Simpoziumi final parashikohet të zhvillohet në korrik 2021 në Athinë. IKTK administron Modulin e tretë të simpoziumit, i cili fokusohet mbi risqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu në sitet me vlera natyrore dhe kulturore.</p>

4. Projekte të ndjekura në partneritet me TIKa

Si pjesë e misionit të saj IKTK-ja ushtron aktivitetin e saj edhe nëpërmjet fondeve nga donatorë në partneritet me to. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2010, *IKTK-ja ka vijuar punën duke koordinuar dhe mbikëqyrur punimet në objektet religjioze në partneritet dhe financim të TIKa-s.*

- **Objekti: “Restaurimi i Xhamisë së Et’hem Beut , Tiranë**

Fillimi i punimeve: 23/04/2018

Afati i Kontratës bazë: 600 ditë kalendarike

Përfundimi i punimeve: Mendohet shtyrja e punimeve por nuk jepet data e përfundimit

Përshkrimi i ndërhyrjeve: Punimet konsistojnë në restaurimin e çatisë, tamburit dhe kupolës, konsolidimin e themeleve, muraturës, pastrimin dhe fugatimin e muraturës së gurit, hidroizolimim e themeleve, drenazhimin, hidroizolimim në pjesën me prezencë lagështie, restaurimin e punimeve të drurit, restaurimin e pikturës murale etj.

Faza në të cilën ndodhen punimet: Realizuar rreth 85% të punimeve

- **Objekti “Restaurimi i Xhamisë së Pazarit, Gjirokastër**

Fillimi i punimeve: 22/05/2018

Afati i Kontratës bazë: 360 ditë kalendarike

Përfundimi i punimeve: punimet kanë përfunduar.

Përshkrimi i ndërhyrjeve: Punimet konsistojnë në restaurimin e çatisë, tamburit dhe kupolës, konsolidimin e themeleve, muraturës, pastrimin dhe fugatimin e muraturës së gurit, vendosjen e tirantave metalike sipas modelit origjinal, çmontimin e veshjes së mureve me pllaka majolike, çmontimin e shtresës së dyshemesë me pllaka mermeri, restaurim, plotësimin e shtresave me pllaka guri, vënien në funksion të sistemit të drenazhit të brendshëm, hidroizolimim në pjesën me prezencë lagështie, restaurimin e pikturës murale etj.

Punime faktike: Realizuar 100% sipas projektit të miratuar.

- **Objekti: “Restaurimi i Xhamisë së Beqarëve, Berat**

Fillimi i punimeve: 28/05/2018

Afati i Kontratës bazë: 360 ditë kalendarike

Përfundimi i punimeve: Punimet janë shtyrë disa herë dhe deri sot nga TIKa nuk kemi njoftim zyrtar për datën e përfundimit të punimeve.

Përshkrimi i ndërhyrjeve: Punimet konsistojnë në restaurimin e çatisë, konsolidimin e themeleve, muraturës, pastrimin dhe fugatimin e muraturës së gurit, hidroizolimim e themeleve, drenazhimin, restaurimin e punimeve të drurit, restaurimin e pikturës murale etj.

Punime faktike: Realizuar rreth 95 % të punimeve.

- **Objekti: “Restaurimi i Xhamisë Mbret dhe Teqesë së Helvetive, Berat**

Fillimi i punimeve: 28/05/2018

Afati i Kontratës: 450 ditë kalendarike

Përfundimi i punimeve: Punimet janë shtyrë disa herë dhe deri më sot nga TIKA nuk ka njoftim zyrtar për datën e përfundimit të punimeve.

Përshkrimi i ndërhyrjeve: Punimet konsistojnë në restaurimin e çatisë, konsolidimin e themeleve, muraturës, pastrimin dhe fugatimin e muraturës së gurit, hidroizolimimin e themeleve, drenazhimin, restaurimin e dyshemesë së drurit, restaurimin e dymurës, restaurimin e dritareve, restaurimin e punimeve të drurit, restaurimin e pikturës murale etj.

Punime faktike: Realizuar rreth 85% e punimeve sipas projektit të miratuar.

5. Projekte me Partnerin Kisha Orthodoxe Autoqefale e Shqipërisë (KOASH)

Gjatë vitit 2020, KOASH ka investuar në dy kisha orthodoxe pasuri kulturore:

▪ Restaurimi i Kishës së « Shën Nikollës », Porto Palermo, Himarë

Projekti i restaurimit të Kishës së Shën Nikollës në Porto Palermo u miratua me Vendim të KKR-së Nr. 173, datë 28.05.2019, me vlerë investimi **4.115.423 lekë**.

Ndërhyrjet e realizuara në objekt janë:

- Rikonstrukcion i plotë i çatisë, mbulimi i saj me tjegulla vendi;
- Realizmi i përfundimit të konstruksionit ekzistues nëpërmjet përfundimit të qemerëve të mbulesës;
- Injektione dhe fugatime në muraturë;
- Plotësimi i të gjithë elementëve që i japin formën dekorative të katër fasadave, të cilat ishin dëmtuar pjesërisht;
- Sistimim i jashtëm me pllaka guri dhe një kunetë për largimin e ujërave të shiut;
- Restaurim i dymurës dhe dritareve të drurit në të gjithë objektin;
- Riparimi i suvasë së brendshme të mureve dhe tavanit.

▪ Restaurimi « Kisha e Shën Mërisë » në Zvërnec

Projekti i restaurimit të Kishës së Shën Mërisë në Zvërnec u hartua nga IMK (sot IKTK) dhe u miratuar me Vendim të KKR-së Nr. 266, datë 31.05.2018. Vlera e investimit për restaurimin e Kishës së Shën Mërisë ka vlerën **3.500.000 lekë**.

Ndërhyrjet kanë konsistuar në:

- Qeramosje çatie me tjegulla vendi;
- Çmontim pllaka qeramike tek hajati dhe shtrim me pllaka guri;
- Restaurim i shtresës me pllaka guri (naosi);
- Restaurim dymurës/dritare druri;
- Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim) 50%;
- Pastrim i shtresës së gurit nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë me pompë me presion (idropulitrice);
- Restaurim karrike druri të palëvizshme;
- Lmyerje e gjithë sipërfaqes së muraturës dhe kolonave me solucionin "Etil Silicat".

6. Projekte në kuadër të programit “Itinerari kulturor- Gjurmët fishtiane”

Gjatë vitit 2020 janë **realizuar punimet restauruese** të: "Banesa ku ka banuar vitet e para të jetës At Gjergj Fishta" monument kulture i kategorisë së dytë, në përputhje me projektin e miratuar dhe me kontratën e sponsorizimi (Kontrate nr. 2221/1 dt.26.05.2020) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Shoqërisë “4A-M” sh.p.k. Ky projekt është **miratuar** me vendim KKR Nr. 303, dt.18.09.2019 dhe është hartuar nga specialistët e IKTK-së. Investimi është kryer me mbikëqyrje të IKTK-së dhe DRTK Shkodër. Më datë 23.10.2020 janë inauguruar punimet e restaurimit nga Kryeministri i Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Kryetari i Bashkisë Lezhë.

Nga ana e IKTK-së në bashkëpunim me AKPT-në janë **hartuar** Detyrat e projektimit për: Hartimin e Projektit të Sinjalistikës informuese “Itinerari kulturor - Gjurmët fishtiane” dhe Hartimin e Projektit të ndërtimit të Memorialit në vendin e banesës ku ka lindur At Gjergj Fishta. Këto detyra (ToR’s) janë miratuar me vendim nr. 150, dt. 29.05.2020.

7. Hartim projektesh restaurimi nga IKTK

Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka hartuar projekte restaurimi të cilat janë shqyrtuar në Këshill Teknik dhe KKTKM, nga të cilat janë miratuar **39** projekte restaurimi.

36 janë Vendime të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) dhe 3 Vendime të Këshillit Teknik.

NR.	PROJEKTE RESTAURIMI HARTUAR NGA IKTK	NR. I VENDIMIT	INSTITUCIONI
1	Projekt – Propozim për ndryshim të projektit të këmbanarës së Manastirit të Shën Kollit, në fshatin Mesopotam, Bashkia Finiq, Sarandë.	Nr.7, dt.07.01.2020	IKTK
2	Projekt “Kulla e Sahatit në Kalanë e Krujës”, (faza e parë, punime emergjente)	Nr.12, dt.07.01.2020	IKTK
3	Projekt “Ndërhyrje emergjente për stabilizimin e Kullës së Sahatit dhe Rotonda Nr. 2, Kalaja Prezë”	Nr.13, dt.07.01.2020	IKTK
4	Projekt “Ndërhyrje emergjente pajantimi i Teqesë së Dollmës”, Krujë	Nr.14, dt.07.01.2020	IKTK
5	Miratim i masave paraprake për detajimin e ndërhyrjeve në objektin "Kulla C", Durrës, pas tërmetit në nëntor 2019	Nr.15, dt.07.01.2020	IKTK + CHwB
6	Projekt “Masat mbrojtëse pas tërmetit datë 26.11.2019, në Muzeun Historik Kombëtar”	Nr.16, dt.07.01.2020	IKTK
7	Projekt “Ndërtim skelë mbrojtëse dhe punime të emergjencës në Galerinë Kombëtare të Arteve”	Nr.17, dt.07.01.2020	IKTK
8	Projekt “Restaurim banesa e Avni Rustemit, Libohovë, (punime emergjente, faza e parë)	Nr.18, dt.07.01.2020	IKTK
9	Projekt “Ndërhyrje emergjente dhe restauruese në objektin: "Muzeu Kombëtar i Përgjimeve, Shtëpia me Gjethe", pas tërmetit në nëntor 2019	Nr.20, dt.15.01.2020	IKTK
10	Projekt "Restaurimi i Korpusit Qendror të Ansambllit që përbën Ish Kinostudion (Albafilm Studio), sot M.K	Nr.30, dt.22.01.2020	IKTK
11	Projekt “Ndërhyrje rifiniture në objektin "Ish Lidhja e Shkrimtarëve", në Rr.Kavajës, Tiranë	Nr.31, dt.22.01.2020	IKTK
12	Preventivi i rishikuar i projektit me objekt "Ndriçimi i kishës së Shën Kollit, Voskopojë	Nr.32, dt.22.01.2020	IKTK

NR.	PROJEKTE RESTAURIMI HARTUAR NGA IKTK	NR. I VENDIMIT	INSTITUCIONI
13	Miratim i projektit të rishikuar "Kisha e Shën Nikollës" Vuno	Nr.68, dt.19.02.2020	IKTK
14	Projekt "Restaurimi i kishës së Shpërfytyrimit dhe pikturës murale" në fshatin Herbel, Dibër	Nr.69, dt.19.02.2020	IKTK
15	Projekt "Restaurimi kisha e Shën Sotirit (Sveti Spas) dhe pikturës murale, në fshatin Kërçisht, Dibër	Nr.70, dt.19.02.2020	IKTK
16	Miratim i llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore sipas listës bashkëlidhur.	Nr.75, dt.19.02.2020	IKTK
17	Projekt i rishikuar "Restaurimi i murit perëndimor të kalasë së Tiranës, (fasada dhe pjesa e brendshme)"	Nr.119, dt. 14.04.2020	IKTK
18	Projekt i rishikuar "Restaurimi dhe konsolidimi i një segmenti muri të dëmtuar nga tërmeti brenda Kalasë së Tiranës"	Nr.120, dt. 14.04.2020	IKTK
19	Projekt "Restaurimi i dyerve në fasadën jugore të Kishës së Manastirit të Shën Kollit, Mesoptam, hartuar nga specialistët e IKTK-së, me konsulence të Prof. Pirro Thomo dhe A.Meksi.	Nr.145, dt.29.05.2020	IKTK
20	Miratim i shtesës së projektit të miratuar "Ndërhyrje emergjente dhe restauruese në Muzeun Kombëtar të përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", Tiranë (II-065)	Nr.148, dt.29.05.2020	IKTK
21	Projekt "Ndërhyrje në ambientet e brendshme të ish-Kinostudios, Ministria e Kulturës"	Nr.149, dt.29.05.2020	IKTK
22	Miratimi i relacionit mbi verifikimin në terren dhe konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për gjetjet arkeologjike rastësore (Terma Romake) në njësinë Administrative Rrasë, Bashkia Belsh, raportuar nga Bashkia Belsh dhe realizuar nga specialistët e IKTK-së	Nr.204, dt.02.07.2020	IKTK
23	Miratimin e relacionit mbi verifikimin në terren dhe konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për gjetjet arkeologjike rastësore "Struktura muresh dhe fragmente tjegullash të një terme të periudhës romake" në fshatin Zgjanë, Lushnjë, realizuar nga specialistët e IKTK-së në bashkëpunim me specialistët e Muzeut Historik të Lushnjës	Nr.205, dt.02.07.2020	IKTK
24	Projekt mirëmbajtje "Qyteti antik i Persqopit, Bastioni i madh jugor"	K.Teknik Nr. 19, dt.16.07.2020	IKTK
25	Projekt mirëmbajtje "Ndërhyrje rifiniture "Godina e Kryesisë së Kuvendit" (Zyrat e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisionerit Publik)	K.Teknik Nr. 20, dt.16.07.2020	IKTK
26	Projekt restaurimi dhe preventivi i rishikuar "Kisha e profetit Shën Ilias, fshati Stegopull, Gjirokastër	Nr.210, dt 21.07.2020	IKTK
27	Projekt "Propozim për rishikimin e trajtimit të fasadës së objektit B.3 pjesë e projektit "Rehabilitimi i Bulevardit Zogu I-rë", kërkesë e mbikqyrësit të punimeve, specialist i IKTK-së	Nr.214, dt.21.07.2020	IKTK
28	Projekt "Propozim për rishikimin e trajtimit të fasadës së objektit B.12 pjesë e projektit "Rehabilitimi i Bulevardit Zogu I-rë", kërkesë e	Nr.215, dt.21.07.2020	IKTK

NR.	PROJEKTE RESTAURIMI HARTUAR NGA IKTK	NR. I VENDIMIT	INSTITUCIONI
	mbikqyrësit të punimeve, specialist i IKTK-së.		
29	Projekt-ide "Aneksi i Bibliotekës Kombëtare" me projektues iRI në bashkëpunim me specialistët e IKTK-së dhe Aplikues B.K	Nr.217, dt.21.07.2020	IKTK
30	Projekt restaurimi dhe preventiv i rishikuar i "Nimfeut pranë Bazilikës së Madhe", Butrint, Sarandë", miratuar në KKR me Vendim Nr.136 datë 15.6.2016	Nr.254, dt.30.07.2020	IKTK
31	Miratim i relacionit mbi verifikimin në terren në kuadër të gjetjeve rastësore në zonën e Spitalës të qytetit të Durrësit", realizuar nga DSHA-IKTK	Nr.279, dt.17.08.2020	IKTK
32	Miratim i projektit "Restaurim "Banesa e Muharrem Hoxhës", në fshatin Rranxë, Krujë"	Nr.301, dt.21.08.2020	IKTK
33	Projekti "Punime pastrimi dhe konsolidimi në muret fortifikuese të Kalasë së Tepelenës"	Nr.346, dt.24.09.2020	IKTK
34	Projekt "Restaurimi arkitektonik ish Muzeu Popullor, Shkodër" (Kulla e Inglizit, me aplikues IKTK)	Nr.466, dt.03.12.2020	IKTK
35	Miratim i relacionit për një varr antik nr.16, të dhunuar në nekropolin VL të Parkut Arkeologjik Amantia, hartuar nga specialistët e DRTK Vlorë dhe DSHA.	Nr.57, dt.19.02.2020	IKTK + DRTK Vlorë
36	Projekti i mirëmbajtjes "Ndërrhyrje konservuese në mozaikët e Tiranës", hartuar nga specialistët e IKTK-së dhe DRTK-së Tiranë	K.Teknik Nr. 17, dt.26.06.2020	IKTK + DRTK Tiranë
37	Miratimin e relacionit të gërmimit arkeologjik, dokumentimi dhe rimbulli i varrit pranë Ploçë – Amanonicë, shtesë pike e vendimit Nr. 58, datë 19.02.2020, hartuar nga specialistët e DRTK Vlorë dhe DSHA.	Nr.203, dt 02.07.2020	IKTK + DRTK Vlorë
38	Projekti "Konservim dhe restaurim i pjesëshëm i i tavanit me dekoracione murale në ish muzeun popullor (Kulla e Inglizit), Shkodër", hartuar nga DRTK Shkodër dhe IKTK.	Nr.209, dt.21.07.2020	IKTK + DRTK Shkodër
39	Miratim i relacionit mbi verifikimin në terren për varrin antik të zbuluar në mënyrë rastësore gjatë punimeve bujqësore në fshatin Turan të Tepelenës realizuar nga specialistët e DSHA-IKTK dhe sektori Tepelenë	Nr.380, dt.06.11.2020	IKTK + DRTK Gjirokastër

TOTALI - PROJEKTE RESTAURIMI HARTUAR NGA IKTK - 39

Gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar dhe hartuar projekte restaurimi edhe nga institucione të trashëgimisë kulturore me të cilat IKTK-ja bashkëpunon dhe koordinon punën e saj. Projekte të hartuara nga Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe nga "ZAKPA Apoloni dhe Bylis" dhe të miratuara janë 45, nga të cilat 20 projekte të miratuara me Këshill Teknik. Më poshtë paraqitet në grafik raporti i 84 projekteve të restaurimit në total të hartuara nga IKTK-ja dhe institucionet e trashëgimisë kulturore, si dhe natyra e projekteve (projekte restaurimi, mirëmbajtje, ndërhyrje emergjente dhe raporte gërmim shpëtimi).




Fig. 1. Projekte restaurimi të hartuara nga Institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore.




Fig. 2. Llojet e projekteve të hartuara nga Institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu gjatë vitit 2020, IKTK-ja ka hartuar projekte të cilat janë ende në proces ose presin miratimin në KKTKM:

- Restaurimi i pikturës murale në kishën e Shën Thanasit në Voskopojë, Korçë (e përfunduar në pritje për miratim).
- Restaurimi i pikturës murale në kishën Shën Triadha në Kardhikaq, Delvinë (në proces).
- Restaurimi i pikturës murale dhe ikonostasi në kishën shpellë Shën Maria në Kostar, Delvinë (në proces).

- Ikonostasi i kishës në manastirin e Shën Prodhromit Voskopojë, Korçë (në proces).
- Restaurimi i pikturës murale në kishën Shën Dhimitri, Kërçisht, Dibër (në proces).
- Hartim projekti për përmbajtjen dhe dizajnin e Tabelave Informuese në shqip dhe anglisht për monumentet e Parkut Arkeologjik Bylis (e përfunduar në pritje për miratim).
- Asistencë për përmbajtjen e tabelave informuese për monumentet në DRTK – Korçë, Berat, Vlorë, Tiranë, Gjirokastrë.
- Hartim projekti: “Ikonostasi, amboni dhe fronti peshkopal i kishës së Shën Marisë”, Bënjë (në proces).
- Hartim projekti për “mozaikun pranë urës së Bahçallëkut”, pranë depos së Kalasë së Shkodrës (në proces).
- Hartim projekti për ndërhyrje konservuese restauruese pranë depos së ujit Berat, Kala (në proces).
- Hartim projekti dhe ndërhyrje konservuese/restauruese në mozaikun e “Qylymit” ndodhur në ambientet e jashtme të Muzeut Historik Kombëtar (në proces).

8. Ndërhyrje konservuese – restauruese të realizuara në laboratorin e IKTK-së dhe në terren

- Ndërhyrje konservuese - restauruese në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar në Dyert e bukura me autor Dico Zografi, pjesë e Pavijonit të Artit Mesjetar në MHK.
- Restaurimi i pikturës murale “Nisja për në betejë” me autor Fatmir Haxhiun, pjesë e pavijonit të mesjetës në MHK.
- Ndërhyrje konservuese restauruese në fragmentet e pikturës murale të zbuluara gjatë hapjes së dyerve në murin jugor të kishës së manastirit të Shën Kollit në Mesopotam, Sarandë, Fondet IPA.
- Vazhdimi i punës për restaurimin e fragmenteve të dëmtuara të pikturës murale të Teqesë së Dollmës në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit në IKTK.
- Ndërhyrje konservuese - restauruese në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit IKTK për trajtimin e fragmenteve të hequra të pikturës murale nga kisha e Shën Todrit Kadipashaj.
- Ndërhyrje konservuese - restauruese në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit IKTK në ikonat: “Vajtimi i mbivarrshëm” dhe “Pagëzimi në këmbë”, pjesë e fondit të ikonave në MHK.
- Hapja e mozaikut e banesës me peristil Sektori G në Apoloni (për ekspozim).
- Hapja e fragmentit me mozaik në Bazilikën e Madhe në Butrint (për ekspozim).
- Monitorim të punimeve në mbulesën e mozaikut të Tiranës. Atelieja e Restaurimit 2020.
- Hapja e mozaikëve në qytetin e Durrësit.
- Ndërhyrje konservuese - restauruese në ambientet e MHK në objektin prej guri (piktogram) i marrë nga fshati Xhuxhë, Mirditë dhe përgatitja e tij për ekspozim.

9. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të konservimit dhe restaurimit të ndjekura nga IKTK-ja

Me gjithë vështirësitë e pandemisë globale të shkaktuara nga Covid-19, gjatë vitit 2020 IKTK-ja është përpjekur maksimalisht të ketë nën kontroll situatën me zbatimet e punimeve të restaurimit duke i mbikëqyruar dhe kolauduar punimet e tyre. Më poshtë në formë tabelare objektet e trashëgimisë kulturore të mbikëqyruara dhe kolauduara nga IKTK-ja.

NR.	TITULLI I PROJEKTIT	INVESTITORI	INSTITUCIONI MBIKËQYRËS /KOLAUDUES	STATUSI
1	“Rikualifikimi urban në fshatin e Vunoit, Bashkia Himarë”	FSHZH	Mbikëqyrje – IKTK & DRTK Vlorë	Përfunduar
2	“Rikualifikimi urban në fshatin Dhërmi, Bashkia Himarë”	FSHZH	Mbikëqyrje – IKTK & DRKK Vlorë	Përfunduar
3	“Nimfeut pranë Bazilikës së Madhe”, Butrint, Sarandë”, miratuar në KKR me Vendim Nr.136 datë 15.6.2016, hartuar nga specialistët e IKTK-së	IPA në kuadër të Projekti Mo.Na + Buxheti i Shtetit	Mbikëqyrje – IKTK	Përfunduar
4	“Projekt restaurimi dhe preventivi i rishikuar "Kisha e profetit Shën Ilias, fshati Stegopull, Gjirokastër, hartuar nga specialistët e IKTK-së	Buxheti i Shtetit	Mbikëqyrje – DRTK Gjirokastër, Kolaudim IKTK	Përfunduar
5	“Pajantimi i përkohshëm i strukturës, Kulla C - Projekti i rehabilitimit, faza I”, kërkesë e CHwB	CHwB me fondet e Ambasadës Suedeze (SIDA).	Mbikëqyrje IKTK	Përfunduar
6	“Kisha e Shën e Premtes” Valësh, Elbasan, hartuar nga specialistët e IKTK-së.	Buxheti i Shtetit	Mbikëqyrje IKTK Kolaudim IKTK	Përfunduar
7	“Rehabilitimi i fasadave të pallatit të kryqëzimi i Rrugës së Dibrës me Unazën e Vogël”	Bashkia Tiranë	Mbikëqyrje IKTK	Në proces
8	“Rehabilitimi i rrjetit Ujësjetës në Gjirokastër”	Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër	Mbikëqyrje IKTK	Në proces
9	“Restaurimi i kishës së Shën Venerandës, Pllanë, Lezhë”, hartuar nga specialistët e IKTK-së	Kisha Katolike	Mbikëqyrje IKTK DRTK Shkodër	Përfunduar
10	“Fondi i Bibliotekës Kombëtare”, hartuar nga IRI	Buxheti i Shtetit	Mbikëqyrje IKTK DRTK Tiranë	Në proces
11	“Ndërhyrje pjesore për pasojat pas tërmetit në objektin Muzeu Historik Kombëtar”	Buxheti i Shtetit	Mbikëqyrje IKTK	Përfunduar
12	“Restaurimi i Xhamisë së Et’hem Beut”, Tiranë.	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, TIKA	Mbikëqyrja dhe kolaudimi – Bashkëpunim TIKA - IKTK	Në proces
13	“Restaurimi i Xhamisë së Pazarit”, Gjirokastër.	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, TIKA	Mbikëqyrja dhe kolaudimi – Bashkëpunim TIKA- IKTK & DRKK Gjirokastër	Në proces
14	“Restaurimi i Xhamisë së Beqarit”, Berat.	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, TIKA	Mbikëqyrja dhe kolaudimi – Bashkëpunim TIKA- IKTK & DRKK Berat	Në proces
15	“Restaurimi i Xhamisë Mbret”, Berat.	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, TIKA	Mbikëqyrja dhe kolaudimi – Bashkëpunim TIKA- IKTK & DRKK Berat	Në proces

16	“Restaurimi i Teqesë së Helvetive”, Berat.	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, TIKA	Mbikëqyrje dhe kolaudim – Bashkëpunim TIKA - IKTK & DRKK Berat	Në proces
17	Titulli i projektit: "Restaurim i ish-hotel Dajtit".	Banka e Shqipërisë	Mbikëqyrje dhe kolaudim – IKTK	Në proces
18	“Rikonstruksioni i Akademisë së Arteve”	Universiteti i Arteve	Mbikëqyrje–IKTK kolaudim – IKTK	Përfunduar
19	“Rikualifikimi i Sistemeve të jashtme të Fakultetit Histori Filologji dhe Gjuhëve të Huaja”	Universiteti i Tiranës	Mbikëqyrje–IKTK	Përfunduar
20	“Rehabilitimi i Bulevardit Zogu i Parë”	Bashkia Tiranë	Mbikëqyrje–IKTK	Në proces
21	“Rehabilitimi i godinës së Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike”	UPT	Mbikëqyrje–IKTK	Në proces
22	“Rehabilitimi i godinës së Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike”	UPT	Mbikëqyrje–IKTK	Përfunduar
23	“Ndërhyrje konsoliduese në kambanaren e Manastirit dhe restaurimi i kishës në Manastirin e Shën Kollit Mesopotam, Sarandë”	DRTK Vlorë	Mbikëqyrje–IKTK& DRTK Vlorë	Përfunduar
24	“Lyerja e fasadës së Godinës së Kryesisë së Kuvendit dhe godinës së Seancave Plenare”	Kuvendi i Shqipërisë	Mbikëqyrje–IKTK	Përfunduar
25	“Restaurimi i godinës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë”	Prefektura Tiranë	Mbikëqyrje–Kolaudim IKTK	Përfunduar
26	“Restaurimi i Kroit me Bende në Çetën e Mesme” (Pjesor)	CHwB	Mbikëqyrje–IKTK	Përfunduar
27	Restaurim i pjesës së Muzeu Kombëtar Shtëpia me Gjethe	Shoqëria e sigurimit ATLANTIK	Mbikëqyrje IKTK	Përfunduar
28	Restaurimi "Banesa Sotiraq Kureta, Berat"	Donacion privat	Mbikëqyrje IKTK	Përfunduar
29	Njësia e Digjitalizimit	AADF	Mbikëqyrje– AADF dhe IKTK	Përfunduar
30	Restaurimi i Fasadasë së objektit Teatrit të Operës dhe Baletit	Buxheti i Shtetit (pjesërisht nga bankë e nivelit të dytë)	Mbikëqyrje IKTK	Përfunduar
31	Fasada e Banesës së Ismail Kadaresë, Tiranë	Bashkia Tiranë	Mbikëqyrje IKTK	Përfunduar
32	Restaurimi i Banesës ku jetoi vitet e para Fishta, Fishtë, Lezhë	Donacion privat	Mbikëqyrje IKTK dhe DRTK Shkodër	Përfunduar

**PROJEKTE RESTAURIMI TË MBIKQYRURA DHE KOLAUDUARA NGA IKTK
TOTALI - 32**

10. Hulumente arkeologjike

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 nga DSHA- IKTK është zhvilluar aktiviteti si më poshtë:

Nr.	a. NDJEKJE E GJETJEVE RASTËSORE NË TERRITOR	NR. I VENDIMIT	INSTITUCIONI
1	Verifikim në terren për gjetjen rastësore (stelë) në qytetin e Durrësit.	Njoftim	DSHA-IKTK
2	Verifikim në terren në fshatin Vanaj, Fier, për gjetje arkeologjike (objekt pranë kishës së Shën Kollit, Vanaj).	Njoftim	DSHA-IKTK
3	Verifikim në terren pas konstatimit të tre kolonave në zonën e Spitallës Durrës.	Njoftim	DSHA-IKTK
4	Verifikim në terren lidhur me gjetjen rastësore pranë fshatit Podgorie, pranë vendit me toponimin “Kopaçe”, midis Burrës dhe Kishnikut, në territorin e Bashkisë së Maliqit.	Njoftim	DSHA-IKTK- DRTK Korçë
5	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike rastësore në territor gjatë punimeve bujqësore, në fshatin Turan të Tepelenës në bashkëpunim me DRTK - Gjirokastrë.	Njoftim	DSHA-IKTK- DRTK Gjirokastrë.
6	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike në territorin e fshatit Zezë të Fushë Krujës, sipas njoftimit të z. Renald Meta nr. 1022 Prot., datë 01.06.2020.	Njoftim	DSHA-IKTK
7	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike në fshatin Bovillë të Tiranës sipas njoftimit të z. Renald Meta nr. 1187 Prot., datë 22.06.2020.	Njoftim	DSHA-IKTK
8	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike rastësore në fshatin Strëmbeç” të Përmetit, sipas njoftimit të z. Renald Meta.	Njoftim	DSHA-IKTK
9	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike, në kuadër të njoftimit të DRTK – Vlorë (fragmente të shumta qeramike të periudhës së Antikitetit të Vonë, Mesjetare dhe Otomane, si dhe një bazament kolone antike), të zbuluara gjatë punimeve për projektin: “Restaurimi i Kishës së Shën Nikollës në Porto Palermo, Himarë”.	Njoftim/KKR nr. 173 datë 28.05.2019	DSHA- IKTK/DRTK Vlorë
10	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike bazuar në njoftimin nga specialisti i Muzeut Historik të Lushnjes për gjetje arkeologjike (struktura dhe fragmente tjegullash, ndoshta gjurmë të një terme të periudhës Romake), të zbuluara gjatë inspektimit të terrenit në “Kodër Zgjanë” të Lushnjës.	Njoftim	DSHA-IKTK
11	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike rastësore pranë fshatit Gjorm, Vlorë, në kuadër të projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, segmenti “Selenicë – Kuç – Qeparo”, subjekti FSHZH, sipas	Njoftim	DSHA- IKTK/DRTK Vlorë

raporteve periodike të dërguara nga DRKK – Vlorë.

12	Verifikim në terren lidhur me gjetjen arkeologjike rastësore (Terma Romake) në Njësinë Administrative Rrasë, Bashkia Belsh. Raportuar nga Bashkia Belsh.	Njoftim	DSHA-IKTK
----	--	---------	-----------

TOTALI - NDJEKJE E GJETJEVE RASTËSORE NË TERRITOR - 12

Nr.	b. GËRMIME ARKEOLOGJIKE SHPËTIMI KRYER NGA DSHA NË BASHKËPUNIM ME DRTK	NR. I VENDIMIT	INSTITUCIONI
1	Gërmim arkeologjik shpëtimi dhe dokumentimi i varrit buzë rrugës Ploçë-Amonicë në hyrje të Parkut Arkeologjik të Amantias, Vlorë, në bashkëpunim me DRTK Vlorë	KKTKM nr. 57, datë 19.02.2020.	DSHA-IKTK/DRTK Vlorë
2	Gërmim arkeologjik i varrit nr. 16 pranë portës me hark në Parkun Arkeologjik të Amantias, në bashkëpunim me DRTK- Vlorë.	KKTKM Nr. 203, datë 02.07.2020	DSHA-IKTK/DRTK Vlorë
3	Gërmim arkeologjik në “Varrezën Tumulare të Himarës”, Himarë, në bashkëpunim me DRTK- Vlorë.	KKA Nr. 154, datë 06.06.2019	DSHA-IKTK/DRTK Vlorë

TOTALI - GËRMIME ARKEOLOGJIKE - 3

Nr.	c. NDJEKJE E AKT-MARRËVESHJEVE TRE PALËSHE NË KUADËR TË MONITORIMIT ARKEOLOGJIK	NR. I VENDIMIT	INVESTITORI
1	"Godinë industriale për përpunimin, miksimin dhe paketimin e frutave me 1-2 dhe 3 kate, Vorë". Kontratë nr. 1830/2 Prot., datë 10.09.2020.	KKTKM Nr. 89, datë 05.03.2020	"CAPITAL RESOURCES" sh.p.k
2	Rehabilitimi i rrugës së Dëshmorëve nga kryqëzimi "Pranvera" deri tek kryqëzimi me rrugën "Mujo Ulqinaku", zonë arkeologjike B, Durrës. Kontratë nr. 985/3 Prot., datë 28.05.2020.	KKTKM Nr. 113, datë 14.04.2020	"ARIFAJ" Sh.p.k
3	Projekt i posaçëm i zëvendësimit të fshatit Kodër Zgjupe-Strukturë banimi 4, 5 dhe 6 katëshe, Gramsh. Kontratë nr. 1345 Prot., datë 28.10.2019.	KKA Nr. 197, datë 29.08.2019	"Devoll Hydropower" sh.a
4	HEC "BORIE LURË" 1, Dibër. Kontratë nr. 1893/2, datë 17.09.2020.	KKA Nr. 4, datë 18.01.2018	"AGETA" sh.p.k
5	Banesë individuale, "Rikonstruksion objekti dhe shtesë volumi në rrugën "Isuf Molla", zonë arkeologjike "B" Durrës, z. Besim Roçi. Kontratë nr. 1789/2, datë 16.09.2020.	KKTKM Nr. 250, datë 29.07.2020	Besim Roçi
6	"Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të Rajonit të Vlorës, Sherishtë". Kontratë nr. 1625/1, datë 11.08.2020.	KKA Nr. 217, datë 17.10.2018	Bashkia Vlorë
7	"Rezidencë banimi dhe hotel 5-6 katësh, në lagjen nr. 1, rruga "Anastas Durrësaku", në zonën arkeologjike B, Durrës".	KKA Nr. 277, datë 19.12.2018	"Rei" sh.p.k

8	“Agroturizëm Bote Farms” në Finiq. Kontratë nr. 2115/2, datë 20.10.2020.	KKTKM Nr. 357, datë 15.10.2020	“Bote Farms” sh.p.k
9	“Objekt banimi 4 katësh dhe 1 kat parkimi dhe pishinë, Himarë”. Kontratë nr. 2219/2, datë 10.11.2020.	KKTKM Nr. 353, datë 12.10.2020	"Bega 07" sh.p.k
10	“Objekt industrial, magazinim, zyra dhe ambiente teknike 1 – 2 kate” - Bashkia Fier. Kontratë nr.1229/1, datë 23.09.2019.	KKA Nr. 175, datë 31.07.2019	"Yura Corporation Albania" Sh.p.k
11	“Rikonstuksion i rrugëve të Kalasë së Ali Pashës dhe vazhdimi i shëtitores përgjatë rrugëve të Kalasë, loti II”. Kontratë nr.780/2, datë 29.04.2020.	KKTKM Nr. 51, datë 19.02.2020	"2 T" Sh.p.k

TOTALI - NDJEKJE E AKT-MARRËVESHJEVE TREPALËSHE - MONITORIM ARKEOLOGJIK- 11

Nr.	d. VËZHGIME ARKEOLOGJIKE REALIZUAR NGA DSHA-IKTK	NR. I VENDIMIT	INVESTITORI
1	Vëzhgim arkeologjik në kuadër të projektit të OSHEE sh.a - “Linja 110 kV me dy qarqe, NSt. Bushat – NSt. Velipojë”, Velipojë.	-	“OSHEE” sh.a
2	Vëzhgim arkeologjik në kuadër të projektit të OSHEE sh.a - “Rrjeti Shpërndarës 20 kV nga Nënstacioni 110/20 kV Fieri i Ri-Fiderat 10 deri 12 dhe Nënstacioni 110/20 kV Fieri.	-	“OSHEE” sh.a
3	Vëzhgim arkeologjik në kuadër të projektit të OSHEE sh.a -“Ndërtimi i rrjetit të ri elektrik 20 kV në Fushë – Krujë, Fideri F4 dhe Fideri 2”, Fushë-Krujë.	-	“OSHEE” sh.a

TOTALI - VËZHGIME ARKEOLOGJIKE REALIZUAR NGA DSHA-IKTK- 3

11. Baza e të dhënave dhe përditësimi mbi pasuritë kulturore

a) Përditësimi i Listës Zyrtare të Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore për vitin 2020

Më poshtë të dhënat e përditësuara:

Nr.	Shpallje Monument Kulture Kategoria e I-rë dhe e II-të (Deklarim i Interesit Kulturor)	Nr. i Vendimit KKTKM	Vendndodhja
1.	Miratimi i deklarimit pasuri kulturore e objektit “Banesa ku ka jetuar Maks Velo, Rruga “Hoxha Tahsim”, Nr. 57/2”, Tiranë	Vendim (Qarkullues) Nr. 130, datë 08.05.2020	Tiranë
2.	Miratim në parim i propozimit për shpallje pasuri kulturore të objektit “Tyrbet pranë Teqes së Shtufit”, Gjirokastër.	Nr.206, dt.02.07.2020	Gjirokastër
Totali - Deklarim Pasuri Kulturore - 2			

Nr.	Propozim për heqje statusi Monument Kulture Kategoria e I-rë dhe e II-të (Mungesë e Interesit Kulturor)	Nr. i Vendimit KKTKM	Vendndodhja
1.	Miratim i propozimit të Znj. Edlira Demiraj për mungesën e interesit kulturor për MK, kategori II-të, për objektin "Banesë tip vile 2 kate II-149, në lagjen 7, Rr."Mihal Duri", Tiranë 8380, relacion i hartuar nga F.Saliu	Nr.521, dt.22.12.2020	Tiranë
Totali - Mungesë interesi kulturor - 1			

Nr.	Saktësim/ndryshim emërtimi	Nr. i Vendimit KKTKM	Vendndodhja
1.	Miratim i ndryshimit të emërtimit të objektit MK "Shtëpia e Muzeumit Popullor", në "Kulla e Inglizit", propozimi i DRTK Shkodër.	Nr.76, dt. 19.02.2020	Shkodër
Totali - Saktësim/ndryshim emërtimi - 1			

Nr.	Propozime për zona arkeologjike / parqe arkeologjike	Nr. i Vendimit KKTKM	Vendndodhja
1.	Miratim në parim për shpallje "Parku Arkeologjik i Durrësit", propozim i IKTK-së, DRTK dhe IA	Nr.77, dt.19.02.2020	Durrës
Totali - propozime për zona/parqe arkeologjike - 1			

Nr.	Propozime për shpallje Qendra Historike	Nr. i Vendimit KKTKM	Vendndodhja
1.	Miratim i propozimit për shpalljen: "Qendra Historike e qytetit të Shkodrës dhe Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës Mbrojtëse të saj", në përputhje me Ligjin Nr.27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" dhe rishikim i Vendimit të KKR-së Nr. 471, datë 13.11.2018	Nr.281, dt.17.08.2020	Shkodër
2.	Miratim i propozimit për shpalljen e "Qendrës Historike të fshatit Kaninë dhe Planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj dhe të zonës mbrojtëse të saj", e rishikuar në përputhje me Ligjin Nr.27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"	Nr.282, dt.17.08.2020	Kaninë
Totali - propozime për shpallje Qendra Historike - 2			

Shtojca 1: Lista Zyrtare e Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore në territorin e Shqipërisë e përditësuar me të dhënat për vitin 2020.

Tabela Përmbledhëse

Lista zyrtare e Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore 2020

Qarku	Bashkia	Monumente Kulture kategoria I-rë	Monumente Kulture kategoria II-të	Monumente Kulture Total	Zona Mbrojtëse e Monumentit	Zonifikime të pasurive kulturore në grup
Berat	Berat	94	357	451	5	3
	Ura Vajguore	6	-	6	2	
	Kuçovë	2	-	2	-	
	Skrapar	17	-	17	1	
	Poliçan	8	-	8	3	
Berat Total		127	357	484	11	3
Dibër	Dibër	18	2	20	1	
	Bulqizë	16	-	16	-	
	Mat	7	-	7	-	
	Klos	21	-	21	1	
Dibër Total		62	2	64	3	0
Durrës	Durrës	28	1	29	4	2
	Shijak	-	-	-	-	
	Krujë	29	-	29	2	2
Durrës Total		57	1	58	6	4
Elbasan	Elbasan	62	17	79	6	2
	Cërrik	5	-	5	-	-
	Belsh	3	-	3	-	-
	Peqin	7	-	7	1	-
	Gramsh	14	-	14	1	-
	Librazhd	18	-	18	-	-
	Prrenjas	7	-	7	-	-
Elbasan Total		116	17	133	8	2
Fier	Fier	22	-	22	1	2
	Patos	1	-	1	1	
	Roskovec	0	-	-	-	
	Lushnje	9	-	9	2	
	Divjakë	4	-	4	-	
	Mallakastër	9	-	9	3	1
Fier Total		45	0	45	7	3
Gjirokastrë	Gjirokastrë	105	324	429	5	3
	Libohovë	20	1	21	6	-
	Tepelenë	15	6	21	7	-
	Memaliaj	2	-	2	-	-
	Përmet	26	-	26	5	2
	Këlcyrë	7	-	7	1	-
	Dropull	40	-	40	4	-
Gjirokastrë Total		215	331	546	28	5
Korçë	Korçë	78	1	79	16	2

	Maliq	18	-	18	-	-
	Pustec	9	-	9	5	-
	Kolonjë	23	-	23	4	1
	Devoll	13	-	13	1	1
	Pogradec	29	-	29	5	2
	Korçë Total	170	1	171	31	6
Kukës	Kukës	10	-	10	1	-
	Has	11	-	11	-	-
	Tropojë	18	-	18	1	-
	Kukës Total	39	0	39	2	0
Lezhë	Lezhë	16	1	17	4	2
	Mirditë	9	2	11	3	-
	Kurbin	5	1	6	1	-
	Lezhë Total	30	4	34	8	2
Shkodër	Shkodër	117	11	128	4	5
	Malësi e Madhe	8	-	8	3	-
	Vau-Dejës	12	1	13	1	2
	Pukë	3	-	3	-	-
	Fushë-Arrëz	4	1	5	-	-
	Shkodër Total	144	13	157	8	7
Tiranë	Tiranë	38	205	243	13	3
	Kamëz	-	-	-	-	-
	Vorë	2	-	2	1	-
	Kavajë	9	5	14	1	-
	Rrogozhinë	2	-	2	2	-
	Tiranë Total	51	210	261	17	3
Vlorë	Vlorë	52	-	52	5	2
	Selenicë	23	2	25	3	1
	Himarë	44	-	44	8	4
	Sarandë	16	-	16	4	4
	Konispol	22	-	22	4	-
	Finiq	43	-	43	7	2
	Delvinë	20	-	20	1	-
	Vlorë Total	220	2	222	32	13
	TOTALI	1276	938	2214	153	46

b) Platforma digjitale WebGIS

Puna për administrimin e platformës digjitale WebGIS për trashëgiminë kulturore jep mundësinë që vlerat e trashëgimisë kulturore të jenë në një arkivë online, apo për të krijuar një hartë digjitale të trashëgimisë kulturore në vend, si dhe implementimin e një sistemi i cili krijon mjetet për digjitalizimin dhe administrimin e informacionit gjeografik të pasurive kulturore.

Në mbështetje të informacionit të siguruar nga veprimtaria e IKTK-së nga institucionet e specializuara dhe nga subjektet e licencuara në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, hartohet, përditësohet dhe publikohet platforma digjitale në WebGIS për trashëgiminë kulturore në Republikën e Shqipërisë.

Në faqen web të IKTK-së mund të aksesohen dy platforma digjitale WebGIS:

- **WebGIS Monumentet**

Platforma digjitale e monumenteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore mund të aksesohet nëpërmjet linkut: <http://iktk.gov.al/Pages/Default.aspx>

Ndarja e tyre është bërë sipas tipologjisë së pasurive kulturore që mbrohen, të grupuara në 5 kategori:



Që nga krijimi i tij, në mbështetje të detyrave funksionale, sektori ka realizuar:

- Ndjekjen dhe funksionimin e sistemit unik kombëtar të hedhjes së informacionit të pasurive kulturore dhe zonifikimeve, mbështetur në teknologjinë GIS, në bashkëpunim të ngushtë me:
 - DMK;
 - Institucionet shtetërore.
- Koordinimin e punës me sektorët e DMK për ngarkimin në sistemin WebGIS të materialeve të kësaj drejtorie, zonifikimet dhe deklaratimet e reja të pasurive kulturore, me koordinata të sakta, si dhe dokumentacioneve të tjera të nevojshme për përmirësimin dhe përditësimin e kësaj platforme në mënyrë të vazhduar;
- Komunikimin dhe koordinimin e punës me AKSHI-n dhe operatorin ekonomik të kontraktuar për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit WebGIS, duke mundësuar aksesin e shpejtë dhe pa probleme nga përdoruesit e sistemit WebGIS brenda 24-orëve nga paraqitja e problemit;
- Rishikimin e koordinatave të reja të zonifikimeve të qendrave historike sipas Ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” për sistemin K.RR.GJ.SH në bashkëpunim me ASIG.
- IKTK-ja, si autoriteti publik përgjegjës, në bashkëpunim me ASIG ka hartuar dokumentin “Standardet Shtetërore për Specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri. Tema: “Zonat e Mbrojtura”, miratuar me VKM nr. 891, datë 18.11.2020.
- Bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Mjedisore për identifikimin e zonave, përditësimin e zonifikimeve dhe saktësimin e mbivendosjeve të mundshme.
- Krijimi i hartave sipas programeve të iniciuara nga institucionet shtetërore (harta e bregdetit, rrugët e besimit, 100 fshatrat etj.).
- Përcaktimi i largësisë/distancës nga pasuritë kulturore dhe zonifikimet e tyre për projektet e infrastrukturës (hec-e, rrugë kombëtare, investimet strategjike).

Të dhëna raportuese:

Në arkivin teknik të IKTK-së, në arkivin e shtetit, si dhe pas shpalljeve të reja të bëra gjatë viteve të fundit është hartuar lista e përditësuar e monumenteve. Aktualisht në platformën WebGIS monumentet janë të publikuara monumente sipas të dhënave si më poshtë:

Tab. 10 - Mirëmbajtja e platformës WebGIS

Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare		Të publikuara në web	
BERAT	Qarku Berat	454	
GJIROKASTËR	Qarku Gjirokastrë	163	
SHKODËR	Qarku Kukës	35	214
	Qarku Lezhë	34	
	Qarku Shkodër	145	
TIRANË	Qarku Durrës	50	333
	Qarku Dibër	67	
	Qarku Fier	42	
	Qarku Tiranë	174	
KORÇË	Qarku Korçë	171	278
	Qarku Elbasan	107	
VLORË	Qarku Vlorë	222	
TOTALI		1664	
QENDRA HISTORIKE		2	
PARQE ARKEOLOGJIKE		9	

▪ WebGIS Arkeologjia


Sistemi WebGIS është i përbërë nga serveri virtual i cili është i hostuar pranë AKSHI-t dhe është i regjistruar si databazë shtetërore në vitin 2015. Databaza është krijuar më dhjetor 2015 me përfundimin e aplikimit të EëbGIS në ASHA. Informacioni i saj përditësohet në varësi të veprimtarisë arkeologjike në terren. Që nga krijimi i tij, është realizuar:

- Ndjekja dhe funksionimi i sistemit unik kombëtar të hedhjes së informacionit të shërbimeve arkeologjike në terren, mbështetur në teknologjinë GPS dhe GIS në bashkëpunim të ngushtë me (i)DSHA, (ii)institucionet shtetërore(iii) subjektet publike e private të specializuara në fushën e arkeologjisë, që janë përdorues e zhvillues të platformës digjitale WebGIS, duke respektuar afatet ligjore respektive të çdo shërbimi;
- Bashkëpunimi me strukturat zbatuese të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme në IKTK, për hedhjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit teknik të aplikimeve në sistemin WebGIS, mbështetur në procedurat e rregullores së sistemit, afateve dhe kritereve të pranimit të tij;
- Koordinimi i punës me sektorët e DSHA për ngarkimin në sistemin WebGIS të materialeve të kësaj drejtorie dhe dokumentacioneve të tjera të nevojshme për përmirësimin dhe përditësimin e kësaj platforme, sipas procedurave të kërkesës dhe afateve respektive;
- Hartimi dhe raportimi i kontrollit të listës së dokumentave të detyrueshme që duhen ngarkuar në sistemin WebGIS nga përdoruesit me kredenciale të institucioneve shtetërore të specializuara/individë apo shoqëri të licencuara në fushën e arkeologjisë, për vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor, sondazh/gërmim arkeologjik dhe gjetje arkeologjike sipërfaqësore, sipas afate të përcaktuara në Rregulloren e IKTK.
- Komunikimi dhe koordinimi i punës me AKSHI-n dhe operatorin ekonomik të kontraktuar për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit WebGIS, duke mundësuar aksesin e shpejtë dhe pa probleme të përdoruesve të sistemit WebGIS brenda 24-orëve nga paraqitja e problemit.

Të dhëna raportuese:

Në sistemin WebGIS, gjatë vitit 2020 janë regjistruar nga aplikuesit gjithsej **89 projekte zhvillimi**. Krahasuar me vitin 2019, evidentohet se ka një rritje me 7% të projekteve të regjistruara nga aplikuesit. Në mënyrë tabelare e grafike, evidentohen më poshtë edhe subjektet aplikuese sipas numrit të tyre:

Nr.	Emërtimi i Subjekteve arkeologjike	Numri i projekteve të regjistruara 2020
1	Neritan Ceka	1
2	K.A.E.XH	1
3	Lorenc Bejko	2
4	Luan Përzhitë	4
5	Lida Miraj	4
6	Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik	5
7	Skënder Muçaj	7
8	Instituti i Arkeologjisë	8
9	Taulant Rama	14
10	Ols Lafe	18
11	Iris Pojani	25
TOTALI		89



📁 **Hulumtime arkeologjike**, nga ndjekjet e gjetjeve rastësore në territor, janë hedhur në sistemin WebGIS nga DSHA:

(i) Gjetjet arkeologjike rastësore pranë fshatit Gjorm, Vlorë, në kuadër të projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, segmenti “Selenicë-Kuç-Qeparo”, subjekti FSHZH, sipas raporteve periodike të dërguara nga DRTK Vlorë.

📁 **Vëzhgime arkeologjike** janë realizuar dhe hedhur në sistemin WebGIS nga DSHA:


(i) Vëzhgim arkeologjik në kuadër të projektit të OSHEE sh.a -“Linja 110 kV me dy qarqe, NSt.Bushat-NSt. Velipojë”, Velipojë;

(ii) Vëzhgim arkeologjik në kuadër të projektit të OSHEE sh.a -“Rrjeti Shpërndarës 20 kV nga Nënstacioni 110/20 kV Fieri Ri fiderat 10 deri 12 dhe Nënstacioni 110/20 kV Fieri;

(iii) Vëzhgim arkeologjik në kuadër të projektit të OSHEE sh.a-“Ndërtimi i rrjetit të ri elektrik 20 kV në Fushë-Krujë, Fideri F4 dhe Fideri 2”, Fushë-Krujë.

Nga të dhënat e eksportuara nga sistemi WebGIS, duke analizuar numrin e projekteve të aplikuar dhe shërbimet e hedhura në sistem, që nga krijimi i tij në vitin 2015 deri në fund të viti 2020, të dhënat në formë tabelare e grafike paraqiten si më poshtë vijon:

NR.	VITI SHËRBIME	NUMRI TOTAL I APLIKIMEVE NË WebGIS	RAPORTE VËZHGIMI PËR PROJEKTE	GËRMIME SHPËTIMI / SONDAZHE
1	2015	59	59	0
2	2016	47	40	3
3	2017	158	147	11
4	2018	238	235	3
5	2019	83	81	2
6	2020	89	87	2




Gjithashtu, nga të dhënat e eksportuara nga sistemi WebGIS, në se do analizojmë numrin e projekteve të aplikuara dhe statusin e tyre si:

- (i) projekte në proces përpunimi;
- (ii) projekte të aprovuara.

Që nga krijimi i tij në vitin 2015 dhe deri në fund të viti 2020, të dhënat në formë tabelare e grafike paraqiten si më poshtë vijon:

NR.	VITI STATUSI	NUMRI TOTAL I APLIKIMEVE NË WebGIS	PROJEKTE TË APROVUARA	PROJEKTE NË PËRPUNIM
1	2015	59	59	0
2	2016	47	40	4
3	2017	158	120	38
4	2018	238	133	105
5	2019	83	37	46
6	2020	89	1	88



Që nga muaji shtator 2020 e në vijim, me kalimin e shërbimeve të IKTK-së në sistemin on-line të aplikimit në portalin e-albania, vijon puna me shqyrtimin e aplikimeve në këtë sistem dhe verifikimin e regjistrimit të projekteve dhe dokumentacionit të shërbimeve arkeologjike në platformën WebGIS, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në:

- (i) VKM nr.133, datë 7.3.2018 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore për sistemin e WebGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren të ASHA";
- (ii) Regulloren nr.01, datë 13.10.2016 "Për përcaktimin e rregullave, për kryerjen e ndryshimeve dhe aksesimin në bazën e të dhënave shtetërore për sistemin WebGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren të ASHA";
- (iii) "Manual përdorimi nga ASHA/personi përgjegjës i institucionit";
- (iv) "Manual përdorimi për rolin e editorit (subjektit arkeologjik)".

V. KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE (KKTKM)

Pranë IKTK-së funksionon sekretaria teknike e KKTKM-së, e cila administron materialin i cili shqyrtohet në KKTKM. Pranë sekretarisë teknike gjatë vitit 2020 janë depozituar gjithsej 1398 praktika. Sekretaria teknike gjithashtu organizon mbledhjet e KKTKM-së, i cili është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Në kuadër të mbledhjeve të organizuara për Këshillin Teknik dhe KKTKM, sektorët e IKTK-së përgatisin relacionet përmbledhëse për çdo aplikim të depozituar. Për vitin 2020 janë shqyrtuar 570 prezantime, nga të cilat 543 janë Vendime të KKTKM-së dhe 27 Vendime të Këshillit Teknik si më poshtë:

Tab. 11 - Tabela përmbledhëse e aktivitetit të KKTKM-së gjatë vitit 2020

Nr.	Aktiviteti KKTKM	
1	Projekte Restaurimi hartuar nga IKTK	39
2	Projekte Restaurimi hartuar nga DRTK	45
3	Projekte Restaurimi në Monumente ose në Zonat e Mbrojtura hartuar nga OJF dhe të Tretë.	122
4	Projekte Restaurimi të Hartuar nga Privat të Licencuar	24
5	Projekte Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi në Qendër Historike ose Zona të Mbrojtura.	26
6	Projekte Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi në Zonë Arkeologjike "A" dhe "B"	8
7	Projekte Infrastrukturore	86
8	Rregullore të Miratuara ose Terma Reference	9
9	Deklarim i Interesit Kulturor	2
10	Mungesë e Interesit Kulturor	1
11	Mosmiratim Projektesh	15
12	Shtyrje Vendimmarrje	83
13	Leje ndertimi	10
13	Zonë e Mbrojtur e Monumentit	-
14	Saktësim i Njollës së Monumentit	-
15	Propozime për Zona Arkeologjike/ Parqe Arkeologjike	1
16	Propozime për Shpallje Qendre Historike	2
17	Vendimmarrje mbi Licencat në Restaurim Personal/ Shoqëri	4
18	Kërkesat e Legalizimeve	42
19	Saktësim/ Ndryshim Emërtim	1
20	Shpallje në Mbrojtje Paraprake	-
21	Projekte Shkencore	29
22	Miratim i Planeve të Përgjithshme Vendore	21
TOTALI		570


Bashkëlidhur këtij raporti gjeni të detajuar Shtojca 2 – Projektet e miratuara dhe aktiviteti i KKTKM-së.

VI. SHËRBIMET TË OFRUARA NGA IKTK-ja

1. Shërbime online

Portali unik qeveritar shumëfunktional **e-albania.al** administrohet dhe zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shërben si një portë nëpërmjet së cilës çdo person i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbime elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.153, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020”, si dhe Urdhrit të Ministrit të Kulturës Nr. 729, datë 18.12.2019 “Për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 153, datë 25.11.2019”, *IKTK-ja nga muaji shtator 2020 ofron 3 shërbime në platformën e-Albania:*



2. Sporteli Unik i IKTK-së

Sporteli unik është pika hyrëse për shqyrtimin e të gjitha kërkesave/aplikimeve për licencim, leje plane, projekte nga platforma e-Albania, qoftë në pasuri kulturore apo dhe për zhvillimet transformuese në territor. Sporteli unik regjistron kërkesat e aplikuesve, hap dosjen për çdo kërkesë, verifikon përmbushjen e kriterëve për dokumentacionin që duhet të shoqërojë kërkesën/aplikimin dhe dorëzon dosjen te përgjegjësi i Sekretarisë Teknike.

Sporteli Unik është pjesë përbërëse e strukturës administrative pranë IKTK-së të miratuar me Urdhrin Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e Rregullores për veprimtarinë e KKTKM, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sporteli Unik të saj", Neni 8. Ndërsa me Urdhrin Nr. 1620, datë 10.08.2020 “Për administrimin, funksionimin dhe përdorimin e platformes e-Leje, përcaktohet grupi i punës (personi përgjegës dhe nënpunësi i sportelit unik).

Aplikim për Leje për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale:

Shërbimi elektronik "*Aplikim për Leje për Ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale - PKM*" ofron mundësinë e aplikimit online për pajisje me leje për llojet e mëposhtme:

- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Monument Kulture i Kategorisë së I-rë;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Monument Kulture i Kategorisë së II-të;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit Qendër Historike;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit Ansambël Historik Urban;

- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit Park Arkeologjik;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit Zonë me Potencial Arkeologjik;
- Aplikim për Leje për ndërhyrje në PKM: Brenda kufirit Zonë Arkeologjike “B”.


Aplikim për Leje për Zhvillimet transformuese në territor

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 134 dhe V.K.M. nr. 208, datë 10.04.2019 “Përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, projektet, në rastet e zhvillimeve të mëdha, si: *rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private*, përpara marrjes së lejes përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, investitori duhet të marrë miratimin për projektin nga KKTKM, sipas legjislacionit në fuqi.

Kategoritë e projekteve zhvillimore transformuese:

- centralet prodhuese të energjisë;
- impiantet e prodhimit dhe të përpunimit të gazit, naftës e bitumeve, naftës-jellësit dhe gazsjellësit, depot e naftës, gazit dhe derivateve të naftës;
- impiantet e trajtimit dhe strukturat e depozitimit të mbetjeve, të ngurta dhe të lëngshme;
- aeroportet, portet;
- korpuset universitare, komplekset spitalore, sportive, zbavitjeje, stadiume, etj;
- qendra të reja banimi, komplekse rezidenciale, resorte dhe fshatra turistike tradicionale;
- muzetë dhe teatrot kombëtarë;
- minierat, kriporet, karrierat, pika nxjerrjeje dhe shfrytëzimi inertesh;
- strukturat dhe infrastrukturat ushtarake sipas legjislacionit të posaçëm;
- varrezat e Dëshmorëve të Atdheut;
- strukturat dhe qendrat e prodhimit e të përpunimit të industrisë metalurgjike, farmaceutike, kimike, armëve, lëndëve plasëse apo teknologjisë së lartë;
- qendrat apo institucionet në të cilat kryhen veprimtari, përfshirë kërkimore dhe eksperimentale në fusha të industrisë kimike, fizikës bërthamore dhe të tjera;
- rrjeti apo sisteme të infrastrukturave kombëtare;
- strukturat dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave;
- pikat e furnizimit me karburant;
- investimet strategjike.

Në sportelin unik gjatë vitit 2020 janë paraqitur në total **157** aplikime për Leje për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale dhe Leje për Zhvillimet transformuese në territor.




📁 Vërtetim nëse prona/at e individëve apo subjekteve kanë ose jo status pasuri kulturore materiale

Nëpërmjet shërbimit “Vërtetim nëse prona/at e individëve apo subjekteve kanë ose jo status pasuri kulturore materiale” mund të bëhet aplikimi në e-albania.al për vërtetim për pronat e individëve apo subjekteve, nëse kanë apo jo status pasuri kulturore materiale. Ky shërbim ofrohet bazuar në Ligjin Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"; Ligjin Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"; Ligjin Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar; Urdhrin Nr. 128, datë 24.01.2017, "Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të IMK-së".

Për të aksesuar këtë shërbim aplikanti duhet të ngarkojë:

- Planvendosjen e pasurisë kulturore;
- Dokument tjetër që mbështet këtë aplikim (certifikatë pronësie, hartë treguese, etj.).

Që prej muajit shtator 2020, (kur ky shërbim u bë aktiv), ky shërbim i është ofruar **14** aplikantëve.




3. Sistemi e-Lejet

Gjithashtu, në zbatim pikës 6, të VKM Nr. 430, datë 11.07.2018 “Për Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje), institucionet që japin mendim në sistemin e-Leje, por pa u kufizuar janë:

- Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,
- Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Në zbatim të VKM Nr. 364, datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, institucionet e ASHA dhe IMK u bashkuan, dhe institucioni mendimdhënës në sistemin E-leje tashmë është IKTK-ja.

Gjatë vitit 2020, IKTK-ja ka dhënë mendim për **1086** aplikime për Leje Zhvillimi, Ndërtimi, Infrastruktura, etj.



4. Protokollin e IKTK-së


Gjatë vitit 2020 në protokollin e IKTK-së janë depozituar gjithsej **2693** praktika.

5. Arkiva e IKTK-së

Pranë sektorit të Arkivit Teknik, gjatë vitit 2020 kanë marrë shërbim rreth **100** aplikime. Aplikimet janë kërkuar nga Institucionet e Trashëgimisë Kulturore, studentët e Masterit në Restaurim pranë FAU-t, studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe subjekte të ndryshme. Krahas këtij numri, dokumentacioni arkivor i është vënë në shërbim edhe specialistëve të IKTK-së.

Pranë sektorit janë arkivuar rreth **150** dosje të reja të cilat i janë nënshtruar regjistrimit elektronik. Projektet e restaurimit janë skanuar me qëllim ruajtjen e tyre fizike si “hard copy” por edhe në format digjital.

Gjithashtu, janë arkivuar dhe regjistruar dhe rreth **13** dosje supervizime/ kolaudime.



6. Biblioteka e IKTK-së

Biblioteka e IKTK-së gjatë vitit 2020 garantoj pandërprerje shërbimin bibliografik – bibliotekar. Veprimtaria e Bibliotekës vijoi punën normalisht edhe online, duke respektuar masat antiCovid-19, jo vetëm për Stafin e IKTK –së, por edhe për një numër të shumë studentësh të degës së Arkitekturës, Trashëgimisë Kulturore, Inxhinierisë, Arkeologjisë të Univesitetit Shtetëror apo të universiteteve private. Numri i këtyre frekuentuesve gjatë vitit 2020 shënoi rritje.

Biblioteka e IKTK-së vijoi mbajtjen aktive të lidhjeve e të bashkëpunimit me bibliotekat analoge në Shqipëri, me qëllim shkëmbimin e literaturës dhe pasurimin e fondit. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, Biblioteka e IKTK-së ka pasuruar fondet e saj me literaturë cilësore në dobi të punës kërkimore të stafit të IKTK-së.

Bashkëpunimi i Bibliotekës së IKTK-së me Bibliotekën Kombëtare vijon të mbetet efektiv në gjetjen e materialeve të vjetra arkivore që i shërbejnë IKTK-së, e që ruhen në atë bibliotekë.

Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave, Bibliotekën e Akademisë së Shkencave dhe me Shtëpinë e Librit Akademik ka qenë tepër aktiv dhe i dobishëm në shërbim të shkëmbimit të literaturës si dhe të informacionit të nevojshëm që lidhet me kërkimin e literaturës.

Fondi i Bibliotekës edhe për vitin 2020 vijoi të pasurohet, bazuar në hyrjet e reja të titujve të siguruar me anë të shkëmbimit bibliotekar si edhe të donacioneve apo blerjeve.

VII. PROGRAME PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE PROFESIONALE

1. Trajnime për forcimin e kapaciteteve realizuar nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore (QRKREJ)

 *Atelie Restaurimi 2020 në konservimin e Mozaikut të Tiranës*

Gjatë vitit 2020, IKTK-ja nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim të Evropës Juglindore, Sektorit të Artit dhe Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me DRTK Tiranë realizoi në datat 15 shtator – 15 tetor 2020, “*Atelienë e Restaurimit 2020 në konservimin e mozaikëve me rast studimor Mozaikun e Tiranës*”.

Projekti, duke u kushtëzuar nga situata globale e krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19, u realizua në respekt të masave antiCovid duke u bërë e mundur përfshirja vetëm e 6 (gjashtë) pjesëmarrësve përkatësisht nga DRTK Tiranë, DRTK Berat, DRTK Shkodër dhe Muzeu Historik Kombëtar.

6

- Pjesëmarrës në “*Atelienë e Restaurimit 2020 në Mozaikun e Tiranës*”, të certifikuar.

Atelieja e Restaurimit konsistoi në realizimin e *punimeve konservuese* të mirëmbajtjes në Mozaikun e Tiranës, bazuar në projektin e hartuar nga IKTK-ja dhe DRTK Tiranë dhe të miratuar në KKTKM me Vendim Nr. 17, datë 25.06.2020. Realizimi i punimeve u ndërthur me një program *sesionesh teorike* mbi historikun, fazat e ndërhyrjes si dhe teknikat e materialet e konservimit të përdorura. Atelieja e Restaurimit përfshihet në Modulin: “*Teknika dhe metodologji konservimi*”.

Projekti u ndërmor, në përputhje me nevojën e identifikuar për përcaktimin nga ana e IKTK-së së kritereve shkencore për ruajtjen dhe konservimin e gjinisë së mozaikëve, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në këtë fushë. Projekti është ideuar në përputhje me misionin e IKTK-së mbi ruajtjen, konservimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale si dhe në përputhje me aktivitetin e QRKREJ-së në *forcimin e kapaciteteve profesionale* në fushën e trashëgimisë kulturore nën koordinimin e UNESCO-s.

Punimet konservuese në Mozaikun e Tiranës u financuan nëpërmjet fondit të mirëmbajtjes së DRTK Tiranë. Ekspertiza për drejtimin e punimeve dhe hartimin e materialit teorik, praktik të leksioneve, organizimi i kursit dhe logjistika u mundësua nga stafi i IKTK-së. Grupi i punës u ngrit me Urdhër të Drejtorit të përgjithshëm të IKTK-së Nr. 1640, datë 10.08.2020. Pjesëmarrja e specialistëve nga DRTK Shkodër dhe DRTK Berat u mundësua nga vetë DRKT-të. Nga ana e MK-së në kuadër të këtij projekti u ofrua mbështetje financiare për infrastrukturën e nevojshme “platformë online” dhe pajisje për ruajtjen e materialit audio-viziv.

Ceremonitë e çeljes dhe të përmbylljes së Ateliesë së Restaurimit 2020 u zhvilluan me praninë e Ministrisë të Kulturës dhe 6 pjesëmarrësit morën Certifikatë pjesëmarrjeje të firmosur nga Ministria e Kulturës dhe Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së.

IKTK-ja planifikon që duke përdorur materialin audio-viziv të regjistruar gjatë Ateliesë së Restaurimit 2020, gjatë vitit 2021 të realizohet Faza II e këtij projekti që përfshin realizimin e një Kursi Trajnimi Online për audiencë ndërkombëtare në përputhje me veprimtarinë e QRKREJ.

2. Pjesëmarrja e stafit të IKTK-së në programe për forcimin e kapaciteteve profesionale (Konferenca, Trajnime, Takime)

📁 Konferenca përmbyllëse e projektit 3D-IMP-ACT

Konferenca përmbyllëse e projektit 3D-IMP-ACT u zhvillua online në datën 18 dhjetor 2020 dhe përfshinte pjesëmarrës nga të tre vendet partnere: Itali, Shqipëri dhe Mal i Zi. Përfaqësues nga stafi i IKTK-së (Marsela Plyku DEMAJ, Klodjana GJATA) morën pjesë në këtë konferencë me kumtesën me titull “3D-IMP-ACT experience of the National Institute for Cultural Heritage - Results and benefits”.

Kumtesa konsistoi në paraqitjen e një pasqyre të përmbledhur të sfidave me të cilat është përballur IKTK-ja gjatë periudhës së zbatimit të projektit si dhe të rezultateve të arritura.

📁 Konferenca Vjetore Ndërkombëtare e 21-të, “Arkeologjia dhe Përfitimet Publike: t’a çojmë debatin përpara”

Drejtorja e Shërbimit Arkeologjik mori pjesë në takimin vjetor të “Këshillit Europian të Arkeologjisë” (EAC, European Archaeological Council), në Konferencën Vjetore Ndërkombëtare të 21-të, me temë: “Arkeologjia dhe Përfitimet Publike: t’a çojmë debatin përpara”, zhvilluar në Pragë, Republika Çeke.

Qëllimi i mbajtjes së fjalës në takimin e organizuar nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, pranë Muzeut Kombëtar të Pragës, ishte prezantimi i shembujve konkretë, për shembull TAP-i dhe i siteve të trashëgimisë arkeologjike, si dhe krijimi i mundësive të shkëmbimit të eksperiencave bazuar në temën e Konferencës.

Në kuadër të “Konferencës Vjetore Ndërkombëtare” të 21-të u mbajtën 24 prezantime, në 2 sesione të pjesëmarrësve nga vende të ndryshme të Europës, sipas tematikave bazë të konferencës.

IKTK - DSH, u përfaqësua me një prezantim në këtë takim, në sesionin nr. 2 – me titull: “A mund të ofrojnë disa aspekte të arkeologjisë përfitime publike? Sfidat si mund t’a bëjmë?”.

Objektivi kryesor, nisur dhe nga tematika e sesionit, ishte prezantimi i shembujve lidhur me rëndësinë që ka pjesëmarrja e publikut në objektet e trashëgimisë kulturore, duke e implementuar kështu edhe faktorin turizëm. Ndikimet pozitive dhe negative të turizmit në sitet arkeologjike, lidhja e natyrshme dhe përfshirja e komunitetit lokal, mënyrat e transportit dhe aksesimit në site. Si t’a bëjmë arkeologjinë më të aksesueshme dhe t’i japim rëndësinë e duhur nga pikëpamja e vlerësimit, menaxhimit dhe marketimit.

📁 Takimi i Komitetit të Menaxhimit të Liqenit të Ohrit

Në takimin e Komitetit të Menaxhimit të Liqenit të Ohrit, i cili u organizua në Ohër, Maqedonia e Veriut, më datën 17.01.2020, morrën pjesë znj. Arta Dollani, Drejtor i Përgjithshëm për IKTK-në, dhe znj. Marsela Demaj, Përgjegjëse e Sektorit të QRKREJ.

📁 Takimi për “Planin e Menaxhimit të Butrintit”

Në takimin për “Planin e Menaxhimit të Butrintit” me Qendrën e Trashëgimisë Botërore, i cili u organizua në Paris, Francë, më datën 24.01.2020, morri pjesë znj. Arta Dollani, Drejtor i Përgjithshëm për IKTK-në, e caktuar si pjesë e Delegacionit Shqiptar.

📁 *Takimi në Asamblenë e Rrjetit të Kujtesës Evropiane.*

Në takimin e Asamblesë së Rrjetit të Kujtesës Evropiane, i cili u organizua në Varshavë, në periudhën 04 – 07 Shkurt 2020, morri pjesë e znj. Arta Dollani, Drejtor i Përgjithshëm për IKTK-në.

📁 Simpozium Ndërkombëtar në kuadër të projektit Mo.Na me temë: *Monumentet në Natyrë* (Monuments in Nature)

Në kuadër të projektit Mo.Na, do të organizohet në korrik 2021, në Athinë, një simpozium ndërkombëtar me temë: Monumentet në Natyrë (Monuments in Nature). Simpoziumi do të organizohet nga Qendra Evropiane për Monumentet Bizantine dhe Postbizantine, Selanik në cilësinë e partnerit drejtues të projektit në bashkëpunim me të gjithë partnerët, pjesë e të cilëve është dhe IKTK-ja.

Nga ana e stafit të IKTK-së ka filluar puna për përgatitjen e tre kumtesave përkatësisht:

- *Exploring history, architecture and art in Albania through a religious itinerary*, Fourth Session, Tourism as the “third parameter”, Natural and Cultural Tourism, New Trends; autor *Era Bushi* (në proces).
- *Natural and anthropogenic threats assessment of cultural heritage sites*, Third Session, The interaction between Cultural Heritage and Environment and the effect of Climate Change on monuments; autor *Joli Mitrojorgji* (në proces).
- *Rapid Damage Assessment in earthquake damaged heritage buildings – Case study of november 26th earthquake in Albania*, Third Session, the interaction between Cultural Heritage and Environment and the effect of Climate Change on monuments; *Klodjana Gjata, Marsela Plyku Demaj* (në proces).

VIII. BOTIME DHE PROMOVIME

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga:


- Ligji Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- Statutit të IKTK-së miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës me Nr. 342, datë 22.09.2020;
- Rregullores “Për miratimin e Rregullores dhe Funksionimin e Brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës me Nr. 344, datë 22.09.2020;

lindi nevoja për rikonceptimin e Redaksisë për vitin 2020, si për botimin periodik dhe shkencor të “Revistës Monumentet” ashtu dhe për botime të tjera, albume, guida etj. Redaksia e re është gjithëpërfshirëse dhe mbulon çdo fushë të aktivitetit të IKTK-së.

1. Revista “Monumentet”, organ shkencor i IKTK-së

Gjatë vitit 2020 u botua numri i radhës i revistës periodike “Monumentet”, përkatësisht numri 59.

Bashkëpunëtorët e revistës, të gjithë profesionistë në fushat që mbulojnë, trajtuan edhe në këtë numër problematika të ndryshme të menaxhimit të pasurive kulturore në qytetet e ndryshme të Shqipërisë, evidentuan raste specifike të restaurimit hap pas hapi në objekte të veçanta pasuri kulturore, si dhe dhanë sugjerimet e tyre në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik, mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, turizmit, kulturës dhe muzeve.



Në numrin 59 të revistës "Monumentet", janë gjithsej 10 artikuj dhe 2 recenca, nga të cilat 4 artikuj dhe 1 recencë (në total 5), janë shkruar nga stafi i IKTK-së:

- *Arta Dollani*, artikull: “55-vjetori i themelimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”.
- Prof. Dr. Pirro Thomo, Ark. Rest. Arben Spaho, Ing. Rest. Alfred Çoma, artikull: “Restaurimi i Kishës së Shën Marisë në Peshkëpinë e Sipërme, Gjirokastër”.
- *Gentian Vokopola*, artikull: “Restaurimi i disa ikonave”.
- *Renald Meta*, artikull: “Objektet e punuara në stelat funerare të periudhës klasike dhe helenistike të Apolonisë dhe Epidamn-Dyrrahut”.

- *Era Xhaferaj*, recensë: Dritan Çoku, Genci Samimi, *Kishat e Kalasë së Beratit. Arkeologji – Histori – Arkitekturë – Restaurim, Botimet “Pegi”*, Berat, 2019.

2 artikuj janë nga stafi i DRTK-ve, (Eduart Shehaj, Dritan Çoku), 1 artikull nga institucione në varësi të MK (Dr. Dorian Koçi), artikujt e tjerë janë shkruar nga bashkëpunëtorë shkencorë të revistës si Prof. Dr. Aleksandër Meksi, Prof. As. Dr. Frederik Stamati, Prof. Dr. Armand Vokshi dhe Sokol Çunga historian, punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

2. Promovim, komunikim

Informimi i vazhduar i publikut është pjesë e rëndësishme e strategjisë së komunikimit të IKTK-së. Në funksion të rritjes së transparencës dhe informimit, në Institucionin tonë, përgjatë vitit 2020, janë përdorur një sërë mjetesh të komunikimit, të tilla si: *rrjetet sociale, website, emisione televizive, botime si broshura dhe fletëpalosje, janë organizuar aktivitete, video promovuese* etj. Nëpërmjet kësaj veprimtarie është arritur një ndërveprim i suksesshëm me publikun, nga i cili janë marrë mendime dhe sugjerime, vërejtje apo ide produktive, në dobi të punës në trashëgimisë kulturore.

▪ *Rrjete sociale:*

Përgjatë periudhës shkurt – dhjetor 2020, në rrjetin social Facebook, IKTK-ja ka pasqyruar në mënyrë të rregullt informacione që lidhen me aktivitetin e saj, ka promovuar fuqishëm trashëgiminë kulturore, ka shprehur opinione apo ka evidentuar veprimtarinë e kryer nga bashkëpunëtorët e IKTK-së dhe më gjerë etj.

Gjatë vitit 2020 faqja e rrjetit social Facebook ka arritur mbi 11.000 ndjekës, nga të cilët reth 3869 janë ndjekës të rregullt të kësaj faqeje. Vihet re një rritje e numrit të ndjekësve në mënyrë të vazhduar.



- **Faqe Web e IKTK-së**

Në vijim të ristrukturimit të IKTK-së në dhjetor të 2019, pas VKM Nr. 364, datë 29.5.2019 “Për Funksonimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar procedurat për ristrukturimin e logos dhe faqes zyrtare web të institucionit, proces i cili është në vijim.

- **Broshura dhe fletëpalosje**

Broshura:

3

“Apolonia përmes Artit dhe Teknologjisë” (shqip, anglisht).

“Butrinti përmes historisë” mbi koleksionin e Muzeut Arkeologjik Butrint (shqip, anglisht).

“Portat Monumentale të Butrintit” (shqip, anglisht).

Fletëpalosje:

2

mbi Parkun Arkeologjik Apoloni (shqip, anglisht, italisht, fërnngjisht).

mbi vlerat natyrore dhe kulturore të Butrintit (shqip, anglisht).

Broshurat dhe fletëpalosjet janë konceptuar dhe hartuar nga stafi i IKTK-së në bashkëpunim me Parkun Kombëtar të Apolonisë, Parkun Kombëtar të Butrintit dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Vlorë, në kuadër të projekteve 3D-IMP-ACT dhe Mo.Na.

Për më tepër informacion referoju Kapitulli IV – pika 3.

- **Aktivitete**

2

Aktivitet promovues “Preke Trashëgiminë” - 29 shtator 2020, Parku Arkeologjik Apoloni.

Realizim i aktivitetit “Rrugëtimi Fantastik i Junia Rufinës” – 4 tetor 2020, Butrint.

Aktivitetet janë konceptuar dhe realizuar nga stafi i IKTK-së në bashkëpunim me Parkun Kombëtar të Apolonisë, Parkun Kombëtar të Butrintit, në kuadër të projekteve 3D-IMP-ACT dhe Mo.Na.

Për më tepër informacion referoju Kapitulli IV – pika 3.

- **Video promovuese**

Gjatë vitit 2020, IKTK-ja është munduar të jetë në kontakt online me publikun edhe duke promovuar monumente të trashëgimisë kulturore, punë të realizuara gjatë vitit por edhe më herët, trajnime të realizuara nga QRKREJ, aktivitete të realizuara etj., nëpërmjet dhe videove promovuese. Pjesa më e madhe e këtyre videove janë realizuar nga vetë stafi i IKTK-së dhe janë promovuar në rrjetet sociale dhe faqen website të IKTK-së. Janë rreth **27** të tilla.

Tab. 12 - Video promovuese të realizuara nga IKTK-ja

Nr.	Titulli i Videos promovuese	Postuar më:
1	Tirana 100Vjet Kryeqytet – prezantim në shkollën Hasan Prishtina #EdukimiPërmesKulturës	Mars 2020
2	Restaurim i plotë i kishës së Ristozit, Mborje, Korçë	Prill 2020
3	Restaurimi dhe mobilimi i dyqanit të z. Ndrëçim Guni - Pazari i Krujës	Prill 2020
4	Dita Botërore e Artit -15 Prill 2020	Prill 2020
5	Restaurimi dhe mobilimi i dyqanit të znj. Vjollca Haxhiu - Pazari i Krujës	Maj 2020
6	Kurs Trajnimi Rajonal mbi konservimin e objekteve qeramike zhvilluar nga QRKREJ, 17-29 Nëntor 2014.	Qershor 2020
7	Atelieja e Restaurimit 2019 mbi Konservimin e pikturës murale në kishën e Shën Kostandinit dhe Helenës në Berat 2400-vjeçar	Qershor 2020
8	Monumenti i Agonotetëve!	Qershor 2020
9	Rikonstruksioni i Njësisë Kombëtare për Digjitalizimin e Trashëgimisë Kulturore	Korrik 2020
10	Së shpejti #PrekeTrashëgiminë...	Shtator 2020
11	Printim 3D -"Preke Trashëgiminë"	Shtator 2020
12	Së shpejti...Rrugëtimi Fantastik i Junia Rufinës...	Shtator 2020
13	Nis punën Atelieja e Restaurimit 2020 - Konservimi i Mozaikut të Tiranës	Shtator 2020
14	Vijon puna e Ateliesë së Restaurimit në Mozaikun e Tiranës	Shtator 2020
15	Aktiviteti #PrekeTrashëgiminë i mbajtur në Parkun Arkeologjik të Apolonisë, 29 shtator 2020	Tetor 2020
16	Si të realizojmë një mozaik!	Tetor 2020
17	Aktiviteti: Rrugëtimi fantastik i Junia Rufinës, 4 tetor 2020	Tetor 2020
18	Përdorimi i teknikave digjitale në trashëgiminë kulturore – mozaiku i Baptisterit të Butrintit	Tetor 2020
19	Fortifikimi i Paleokastrës	Nëntor 2020
20	Nis puna për restaurimin e Kishës së Shën Ilias, në fshatin Stegopull, Gjirokastrë	Nëntor 2020
21	Kalaja e Porto Palermos	Nëntor 2020
22	Kisha e Shën Ndoit, në Kepin e Rodonit	Nëntor 2020
23	Banesa me 2 peristile, Parku Arkeologjik Finiq	Nëntor 2020
24	Kalaja e Borshit	Nëntor 2020
25	Kalatë e Shqipërisë	Dhjetor 2020
26	Parku Arkeologjik i Amantias	Dhjetor 2020
27	Përfundon restaurimi i Kishës së Shën Ilias në fshatin Stegopull, Gjirokastrë	Dhjetor 2020

IX. BUXHETI I IKTK-së

IKTK-ja është pjesë e Programit të Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë (08220), të Ministrisë së Kulturës.

Programi financiar 2020, ka për qëllim ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet konservimit, restaurimit dhe rehabilitimit të objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale.

Realizimi dhe monitorimi i shpenzimeve të tij, për vitin 2020 është bazuar në zbatim të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) kreu 8, neni “Monitorimet” dhe Udhëzimit Nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”.

Viti 2020 u shenjua nga dy ngjarje të rëndësishme për Shqipërinë dhe për mbarë botën, tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19. Vlerësimi i dëmeve që shkaktoi tërmeti dhe i nevojave të objekteve të dëmtuara të trashëgimisë kulturore ka qenë një nga prioritetet kryesore të punës së IKTK-së gjatë vitit 2020.

Përdorimi i mjeteve dhe platformave online për vijimin e punës ka përbërë sfidë, por që gjithsesi është përfaqësuar lehtësisht nga stafi i IKTK-së.

Niveli i realizimit të buxhetit për IKTK-në në periudhën janar – dhjetor 2020 në vlerë totale është **271.353.764** lekë. Në tregues analitik, niveli i realizimit paraqitet në formë grafike dhe tabelare si mëposhtë:




Fig. 3. Plani – Fakti sipas zërave të artikujve të çelura për IKTK-në, për vitin 2020




Fig. 4. Të dhënat Buxhetore Plan-Fakt për vitin 2020

Kap.	Kodi Projekt	Përshkrimi	Artikulli	Plan Vjetor	Struktura Plani në %	Fakti Progresiv 2020	Fakti /Plani në %
01	91202AA	Paga	600	43,316,433	13%	42,226,478	97%
01	91202AA	Sigurimet	601	7,204,865	2%	7,005,887	97%
01	91202AA	Shpenzime Operative	602	20,120,000	6%	14,247,327	71%
01	91202AF	Projekti 3D-IMP-ACT	604	2,000,000	1%	1,929,361	96%
01	91202AE	Projekti "Mo.Na"	604	2,000,000	1%	1,999,440	100%
01	91202AA	Anëtarshime	605	175,216	0%	175,216	100%
01	91202AA	Ndihmë	606	80,000	0%	80,000	100%
01	19AD701	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 4 objekte kulti pasuri kulturore"	230	6,461,526	2%	4,600,000	71%
01	19AD702	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 8 objekte pasuri kulturore dhe muze në Bashkinë Durrës"	230	42,001,008	13%	34,000,000	81%
01	19AD703	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 5 objekte pasuri kulturore"	230	95,400,138	29%	73,000,000	77%
01	19AD704	Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 9 objekteve institucione publike në Bashkinë Tiranë"	230	29,719,504	9%	29,422,600	99%
01	19AD705	Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 12	230	23,918,408	7%	23,700,000	99%

		objekteve në Bashkinë Tiranë, Krujë, Lezhë, Kavajë, Mirditë"						
01	19AD801	Hartimi i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 Zonat e Reja të Zhvillimit	230	8,010,911	2%	7,983,500	100%	
01	19AD802	Kryerja dhe Hartimi i Raporteve të Sondazheve Arkeologjike në 2 Zonat e Reja të Zhvillimit	230	17,593,824	5%	17,468,700	99%	
01	19AD803	Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 Zonat e Reja të Zhvillimit	230	13,521,750	4%	-	0%	
01	18CF309	Projekti "Mo.Na", "Punime konservimi Nimfeu, Butrint"	231	1,484,316	0%	1,484,280	100%	
01	18AE214	Restaurimi i kishës së Shën e Premtes, Valsh", Faza II, Elbasan	231	3,881,000	1%	3,874,024	100%	
01	18AE217	Restaurim i kishës së Shën Ilias Stegopull, Gjirokastër	231	7,759,380	2%	7,759,131	100%	
02	18CF308	Projekti 3D-IMP- ACT TVSH Pajisje	231	400,000	0%	397,820	99%	
Totali				325,048,279	100%	271,353,764	83%	

X. PLANIFIKIM PËR VITIN 2021

1. Hartim i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 27/2018, si dhe shqyrtim i projekt-akteve të ardhura për mendim nëpërmjet platformës e-akte në bashkëpunim me MK dhe të tjerë.
2. Përafrimi i legjislacionit të Trashëgimisë Kulturore me *acquis* të BE-së.
3. Marrëveshje bashkëpunimi me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
4. Gjurmimi, studimi, kontrolli i gjendjes së konservimit të pasurive të trashëgimisë kulturore.
5. Verifikimi i interesit kulturor nga stafi i IKTK-së në vijim të kërkesave nga institucione publike, qytetarë etj.
6. Hartim i projekteve të konservimit dhe restaurimit për pasuritë kulturore të dëmtuara, sipas listës së hartuar nga raportimet e Drejtorive Rajonale, për objekte të rrezikuara plotësisht dhe/apo pjesërisht.
7. Hartim i projekteve të restaurimit në kuadër të ndërhyrjeve në një paketë veprash inxhinierike (ura), në territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. Hartim i projekteve të konservimit dhe restaurimit në vepra të artit:
 - Hartim i projektit të restaurimit të pikturës murale në kishën Shën Triadha në Kardhikaq, Delvinë;
 - Hartim i projektit të restaurimit të pikturës murale dhe ikonostasit në kishën shpellë të Shën Mërisë, Kostar, Delvinë;
 - Hartim i projektit të restaurimit të ikonostasit të kishës në manastirin e Shën Prodhromit Voskopojë, Korçë;
 - Hartim i projektit të restaurimit të pikturës murale në kishën Shën Dhimitri, Kërçisht, Dibër;
 - Hartim i projektit të restaurimit: “Ikonostasi, amboni dhe froni peshkopal i kishës së Shën Marisë”, Bënjë;
 - Hartim i projektit të restaurimit: “Mozaiku pranë urës së Bahçallëkut”, pranë depos së Kalasë së Shkodrës;
 - Hartim projekti për ndërhyrje konservuese restauruese pranë depos së ujit Kala, Berat;
 - Hartim projekti dhe ndërhyrje konservuese/restauruese në mozaikun e “Qylymit”, ndodhur në ambientet e jashtme të Muzeut Historik Kombëtar.
9. Ndërhyrje restauruese në laboratorin e IKTK-së dhe në terren në veprat e artit si: piktura murale, mozaikë, tavane drusorë, ikonostasë, etj.
10. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve konservuese/restauruese për objekte me status “pasuri kulturore”, që do të financohen gjatë vitit 2021.
11. Verifikim në terren sipas sinjalizimeve për gjetje rastësore gjatë gërmimeve apo punimeve të ndryshme, hartimi i raportit përkatës dhe miratimi në KKTKM.
12. Realizimi i raporteve të vëzhgimit arkeologjik sipas kërkesave.
13. Realizimi i sondazheve, gërmimeve arkeologjike/dokumentim i gërmimit, hartimi i projektit dhe miratimet përkatëse në KKTKM.
14. Monitorimi i punimeve të gërmimit arkeologjik/sondazheve, etj.
15. Konsulencë dhe koordinim i hartimit të projektit për “Planin e Menaxhimit të integruar të Parkut Arkeologjik Durrës”.
16. Konsulencë dhe koordinim i hartimit të projektit për “TID Durrës”.
17. Konsulencë dhe koordinim i hartimit të projektit për “PdyV Durrës”.

18. Konsulencë dhe koordinim i hartimit të detyrës së projektimit (ToR's) për “Kalanë e Borshit”.
19. Studim për menaxhimin dhe rijetëzimin e disa qendrave historike si: Bënjë, Rehovë, Qeparo fshat etj., si dhe rishikimi i rregulloreve të tyre.
20. Koordinim me UNOPS-in në kuadër të programit EU4CULTURE, për zbatimin e projekteve të restaurimit sipas listës së objekteve të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.
21. Koordinim me CHwB në kuadër të programit të Fondit të Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore, për vijimin e zbatimit të projekteve të objekteve Kulla C – Durrës, Teqja e Dollmës – Krujë, Kulla e Sahatit – Krujë, Kulla dhe muri fortifikues – Prezë.
22. Konsulencë për vijimësinë e projektit “Rikualifikimi Urban i Qendrave Historike dhe Ansambleve Urbane” në kuadër të programit PZHIUT.
23. Koordinim me AKPT-në, në kuadër të programit “Itinerari Kulturor - Gjurmët Fishtiane”, për hartimin e projekteve të sinjalistikës informuese dhe ndërtimin e memorialit të Gjergj Fishtës.
24. Vijim i zbatimit të projektit Mo.Na, Programi Interreg - Ballkan Med (periudha 5 dhe 6) ku IKTK-ja merr pjesë në cilësinë e partnerit.
25. Vijim i zbatimit të projektit 3C – në kuadër të Programit IPA CBC It-Al-Me, Tematike (periudha 5 dhe 6) ku IKTK-ja merr pjesë në cilësinë e partnerit.
26. Koordinimi me “*Italian Agency for Development Cooperation – Tirana’s Office (AICS)*”, në kuadër të programit “*IPA II 2018 Action Programme for Albania - EU Economic Development – Tourism – led local economic development with focus on cultural heritage*”, për ndjekjen e procedurave mbi hartimin e planit të menaxhimit dhe projektit të restaurimit të Parkut Arkeologjik Bylis.
27. Zbatim i Asistencës Ndërkombëtare ref: 2932 - Development of Integrated Management Plan of Gjirokastra and Berat, në bazë të Kontratës lidhur midis IKTK-së dhe Qendrës së Trashëgimisë Botërore në 18 Dhjetor 2020. Periudha e parashikuar e zbatimit është janar – dhjetor 2021.
28. Zbatimi i projektit për digjitalizimin e Arkivës teknike të IKTK-së, projekt i financuar nga Qeveria Zviceriane nëpërmjet Zyrës së UNESCO-s në Venecia.
29. Ndjekja e përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në lidhje me sitet me status pasuri botërore në Shqipëri.
30. Mbikëqyrja dhe koordinimi i punës së studentëve të masterit të restaurimit për realizimin e temave të diplomave me qëllim hartimin e projekteve të mirëfillta sipas listës së objekteve të përcaktuara nga IKTK-ja, si dhe mbikëqyrja e praktikës profesionale të masterit të restaurimit.
31. Vijimi i zbatimit të programit “Edukimi mbi dhe përmes kulturës”.
32. Vazhdimi i procesit për saktësimin dhe përditësimin e kartelave të pasurive kulturore në bashkëpunim me DRTK-të dhe ZAKPA-t.
33. Mbarëvajtja dhe përditësimi sipas nevojës i faqeve të webGIS-it, përkatësisht webGIS monumentet dhe webGIS arkeologjia.
34. Dhënie/marrje kërkesa për informacion ndaj autoriteteve të ndryshme mbi nevojat për financim për projekte të hartuara dhe të miratuara ose në proces hartimi/miratimi në KKTKM, të cilat kanë nevojë për financim.
35. Administrimi i materialeve dhe praktikave që do të shqyrtohen në KKTKM, pranë sekretarisë teknike dhe organizimi i mbledhjeve të Këshillit Teknik dhe KKTKM.

36. Administrimi dhe ndjeka e procedurave për aplikimet online për ndërhyrjet në pasuri kulturore, leje zhvillimore transformuese, aplikime për pajisje me licencë në fushën e trashëgimisë kulturore (e-Leje).
37. Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve për aplikimet e ardhura në sistemin e-Leje si institucion i tretë për dhënie mendimi, përkatësisht për projektet që shqyrtohen në KKT (të ardhura nga AZHT), nga pushteti vendor etj.
38. Shqyrtimi kërkesave për verifikimin e statusit të objekteve, nëse kanë status “pasuri kulturore” ose jo.
39. Relacionet përmbledhëse (hartimi i mendimit të sektorëve) për çdo aplikim të depozituar pranë IKTK-së. Prezantime në kuadër të mbledhjeve të organizuara për Këshillin Teknik dhe KKTKM-së.
40. Shërbim i Arkivit Teknik të IKTK-së (kërkesa nga Institucionet e Trashëgimisë dhe të tjerë), menaxhimi i kërkesave online.
41. Shërbim Biblioteka (kërkesa nga Institucionet e Trashëgimisë dhe të tjerë), menaxhimi i kërkesave online.
42. Botimi i revistës “Monumentet”, nr. 60 dhe botime të ndryshme mbi aktivitetet e IKTK-së.
43. Përfaqësim në konferenca dhe simpoziume të ndryshme të përfaqësuesve të IKTK-së.
44. Përditësim i të dhënave të faqes zyrtare web të IKTK-së.
45. Plani strategjik i komunikimit i parashikuar për vitin 2021 nga IKTK-ja ka për qëllim promovimin e punës, njohjen e publikut me trashëgiminë kulturore, evidentimin dhe sensibilizimin e publikut në lidhje me të gjitha çështjet të cilat prekin trashëgiminë kulturore. Mjetet e komunikimit që do të përdoren janë: web-site, rrjetet sociale facebook dhe instagram, mediat audiovizive dhe të shkruara, broshura, publikime, ngjarjet publike, organizim aktivitetesh/takimesh etj.

XI. PROBLEME ADMINISTRATIVO-JURIDIKE TË HASURA GJATË ADMINISTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2020

Viti 2020 u shenjua nga dy ngjarje të rëndësishme për Shqipërinë dhe për mbarë botën. Ky vit nisi pas tërmetit shkatërrues që goditi Shqipërinë në datën 26 nëntor 2019 dhe duke filluar nga muaji mars e në vijim deri në fund të vitit, jeta në Shqipëri, ashtu si dhe në gjithë botën u shoqërua nga pandemia globale e shkaktuar nga virusi Covid 19.

Vlerësimi i dëmeve që shkaktoi tërmeti dhe nevoja për rimëkëmbje të trashëgimisë kulturore ka qenë një nga prioritetet kryesore të punës së IKTK-së gjatë vitit 2020. Puna institucionale gjatë këtij viti është zhvilluar në përputhje me masat ligjore kundër përhapjes së pandemisë, duke përfshirë pjesërisht periudhën e karantinës totale si dhe punën me rotacion në zyrë, duke bërë të pashmangshme punën në kushte online.

Mungesat në aktet ligjore në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, ka penguar vijimësinë normale të zhvillimit të punës së institucionit sipas funksionit të tij si p.sh.:

- mungesa e V.K.M për procedurën e deklarimit të interesit kulturor;
- mungesa V.K.M për konkurimin publik;
- mungesa e bazës ligjore për tarifat përkatëse për aplikimet e projekteve, për licencat, për monitorimin arkeologjik, për hartim projekti, mbikëqyrje, kolaudim etj.;

Mungesa e fondeve për:

- Realizimin e projekteve të hartuara, të cilat janë marrë parasysh dhe janë paraqitur si kërkesa shtesë gjatë hartimit të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2021 – 2023;
- Pasuritë kulturore të cilat rrezikohen nga kushte të jashtme atmosferike;
- Financime të projekteve për forcimin e kapaciteteve njerëzore në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Financime të projekteve IPA sipas kontratave të lidhura.

Nevoja për rritjen e burimeve njerëzore dhe rishikim të strukturës së institucionit për shkak të rritjes së kërkesave dhe fushës së shtrirjes së veprimtarisë së institutit, në rang kombëtar.

Nevoja për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Nevojat për financime në fushën TIK për institucionin tonë janë të domosdoshme, pasi situata aktuale paraqet vështirësi gjatë zbatimit të detyrave institucionale.

Shtojca 1: Lista Zyrtare e Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore në territorin e Shqipërisë e përditësuar me të dhënat për vitin 2020.

Shtojca 2 – Projektet e miratuara dhe aktiviteti i KTKM-së.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arta Dollani